



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË**

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
(Auditim Financiar)**

“Ministria e Financave dhe Ekonomisë” (MFE)

Shtator, 2023



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI (Auditim Financiar)

“Ministria e Financave dhe Ekonomisë”

<u>Nr.</u>	<u>Përmbajtja</u>	<u>Faqe</u>
I	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	3-7
II	KONKLZIONI I AUDITIMIT	8-10
III	HYRJA	11-15
	1. Objektivat dhe qëllimi.....	
	2. Identifikimi i çështjes.....	
	3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	
	4. Përgjegjësitë e audituesve.....	
	5. Kriteret e vlerësimit.....	
	6. Standardet e auditimit.....	
IV	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	16-107
V	GJETJET SIPAS DREJTIMEVE TE ANGAZHIMIT	110-126
VII	ANEKSE	126-127



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1. Informacioni i përgjithshëm

Kontabiliteti në sektorin publik mbështetet në këto parime bazë:

- Pasqyrat financiare sigurojnë transparencën përmes të dhënave të plota dhe paraqesin, me vërtetësi, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje. Ato përgatiten bazuar në një kontabilitet ushtrimor dhe në vijueshmërinë e veprimtarisë së njësisë së qeverisjes së përgjithshme, për një të ardhme të parashikueshme.
- Të dhënat që përmbajnë pasqyrat financiare duhet të jenë të kuptueshme për përdoruesit, të cilët kanë njohuri të mjaftueshme për veprimtaritë ekonomike të njësisë së qeverisjes së përgjithshme dhe për kontabilitetin.
- Të dhënat për elementet dhe për shumat që ndikojnë në vendimmarrjet ekonomike të përdoruesve paraqiten veçmas në pasqyrat financiare.
- Kompensimi ndërmjet një elementi të aktivitetit të bilancit dhe një elementi të detyrimeve, si dhe ndërmjet një të ardhure dhe një shpenzimi është i ndaluar, përveç rastit kur parashikohet ose autorizohet nga një standard kontabël.
- Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet trajtohen në përputhje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare.
- Pasqyrat financiare duhet t'u japin mundësi përdoruesve që të bëjnë krahasime ndërmjet ushtrimeve të ndryshme kontabël ose njësisë të qeverisjes së përgjithshme të ndryshme.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë është përgjegjës për krijimin e sistemit të kontabilitetit të detyrueshëm për të gjithë njësitë e qeverisjes së përgjithshme si dhe harton standardet e kontabilitetit dhe raportimit në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuar aktet nënligjore dhe metodologjinë në fushën e Kontabilitetit Publik.

2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:

- *Objekt i këtij auditimi është:* Vlerësimi nëse kuadri ligjor në fuqi në fushën e kontabilitetit publik është i plotë dhe i zbatueshëm, se përputhet me IPSAS; nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara nga IB (institucionet buxhetore) dhe ML (ministrinë e linjës administrative) janë në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi kontabilitetin dhe raportim financiar. Në përfundim të këtij angazhimi auditimi sigurdhënie, ***do të jepet përgjigje pyetjes: nëse janë hartuar pasqyrat financiare të konsoliduara për sektorin publik në Shqipëri për periudhën objekt auditimi 2021 dhe 2022.***

- *Qëllimi i auditimit:* Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, *nëpërmjet shprehjes së një opinionit/konkluzioni (sipas rastit) nga ana jonë nëse pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.*

- *Fushëveprimi i auditimit:* Vlerësimi i zbatimit të kuadrit të kontabilitetit dhe raportimit financiar në sektorin publik, me qëllim dhënien e opinionit/ konkluzionit, shtrirë sipas drejtimeve të programit të auditimit. Janë audituar me zgjedhje dhe në mënyrë të njëpasnjëshme dokumentacionet dhe të dhënat në lidhje me subjektin/ subjektet që kanë për periudhën 01.01.2021-31.12.2022, ku janë mbuluar me auditim fondet e buxhetit të shtetit, si dhe janë audituar me përzgjedhje dosjet sipas programit për periudhën objekt auditimi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

1.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH me nr. **360/4, datë 13.04.2023** në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë Tiranë, nga data 20.4.2023 – 14.07.2023, për periudhën nga 01.01.2021 deri në 31.12.2022, ushtroi auditimin në këtë institucion “Mbi auditimin financiar mbi bazë sistemi”, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore, në fushë e kontabilitetit dhe raportimit financiar publik, zbatimin e teknikave dhe parimeve në mbajtjen e evidencës kontabile dhe respektimin e kriterëve për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore individuale e të konsoliduara nga organet e qeverisjes qëndrore e vendore dhe nga ana e MFE, etj.

1.2. Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi.

GJE TJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	REFERENC A ME RPA	RËNDË SIA	REKOMANDIMI
I.	<p>Për periudhën objekt auditimit, kuadri unifikuës dhe baza rregullatore e sistemit të kontabilitetit të detyrueshëm më institucionet e sektorit publik, (të qeverisjes qëndrore, vendore dhe fondeve speciale), përfaqësohet nga një akt nënligjor teknik, siç është Udhëzimi i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.3.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.5, datë 21.2.2022, i cili konsiderohet si një nivel i ulët në hierarkinë e dispozitave ligjore. Në këtë kontekst, nuk është shënuar ndonjë progres në fushën e legjislacionit të kontabilitetit të sektorit publik, meqenëse deri në mesin e vitit 2018, veprimtaria e kontabilitetit publik në sektorin buxhetor rregullohej nga një ligj i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, (specifikisht Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”).</p> <p><i>Sa më sipër, nuk janë përmbushur:</i></p> <ul style="list-style-type: none">detyrimet e Kreut 5.4, (Produkti 5.4.2), të Strategjisë së MFP 2019-2022, mbi përfundimin e akteve ligjore në përputhje me IPSAS dhe planin e miratuar të veprimit strategjik të vendit, që përcakton si afat përfundimtar nxjerrjen e akteve ligjore Tremujorin e Katërt të vitit 2022. <p>kërkesat e Nenit 61 “Standardet dhe procedurat e kontabilitetit”, Kreu VII “Kontabiliteti i sistemit buxhetor”, të Ligjit nr.9936, dt. 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar.</p>	Më hollësisht trajtuar në Raportin e Auditimit	L	Të merren masat nga Ministri i Financave, si autoriteti shtetëror përgjegjës për krijimin, organizimin dhe funksionimin e sistemit të kontabilitetit të detyrueshëm për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, që të hartohet ligji mbi kontabilitetin dhe raportimin financiar në sektorin publik, në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuar.
II.	<p>Udhëzimi i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.5, datë 21.2.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, nga data e miratimit të tij, (21 Shkurt 2022), deri në datën e mbajtjes së raportit të auditimit, nuk është publikuar në Fletoren Zyrtare, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003¹.</p>	Më hollësisht trajtuar në Raportin e Auditimit	L	Nga ana e MFE të merren masat për unifikimin e Udhëzimit “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë dhe botimin e tij në fletoren zyrtare, në funksion dhe shërbim të kontabilitetëve të sektorit publik.

¹ -Udhëzimi nr. 5, i datës 21.02.2022, i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë mund të akeshohet nëpërmjet linkut të mëposhtëm në faqen zyrtare në internet të kësaj ministrie: (<https://financa.gov.al/akte-ligjore-dhe-nenligjore-ne-fushen-e-kontabilitetit-publik/>)



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

III.	Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nuk janë zbatuar detyrimet e paragrafit nr. 23 dhe 24 të UMFE nr.5 datë 21.2.2022, ku është parashikuar që “Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.37/2020 “Per monitorimin dhe publikimin e stokut të Detyrimeve të Prapambetura të qeverisjes së përgjithshme” si dhe çdo akt tjetër nënligjor që i referohet detyrimeve të prapambetura, të rishikohen në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi.”	Më hollësisht trajtuar në Raportin e Auditimit	L	Nga ana e Ministrise se Financave dhe Ekonomisë të merren masat për përmirësimin e kuadrit nënligjor në fuqi, nëpërmjet rishikimit, plotësimit dhe harmonizimit të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.37/2020, datë 6.10.2020, “Për monitorimin dhe publikimin e stokut të Detyrimeve të Prapambetura të qeverisjes së përgjithshme” si dhe çdo akti tjetër nënligjor që i referohet detyrimeve të prapambetura, në përputhje me përcaktimet e udhëzimit të Ministrise se Financave dhe Ekonomisë nr.5 datë 21.2.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrir të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, si dhe bashkërendojë e harmonizojë këto akte nënligjore me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor.
IV.	Nga shqyrtimi i zbatimit të kërkesave të Planit të Veprimt, që shoqëron Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike 2019-2022, miratuar me VKM nr. 824, datë 18.12.2019, rezulton se <u>progresi i bërë në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar është i moderuar dhe nuk është i sinkronizuar dhe i përputhur me angazhimet dhe afatet e vendosura nga Këshilli i Ministrave në dokumentin e Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike 2019-2022</u> , lidhur me implementimin e fazave të zbatimit të Kontabilitetit të Sektorit Publik mbi bazën e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS-International Public Sector Accounting Standards), pasi: <u>Nuk janë realizuar deri në datën e mbajtjes së këtij Raporti, ndryshimet e nevojshme ligjore për të mundësuar heqjen e pengesave për fillimin e zbatimit të metodologjisë së re kontabël dhe përgatitjen e pasqyrave financiare bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik.</u>	Më hollësisht trajtuar në Raportin e Auditimit	L	Nga ana e MFE të merren masat për përmirësimin e kuadrit nënligjor në fuqi, (duke mbajtur parasysh miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin dhe Rivlerësimin e Aktiveve Afatgjata Materiale e Jomateriale të Sektorit Publik), të përfundojë procesi i hartimit të regjistrit të konsoliduar të aktiveve të sektorit publik si dhe të zbatohet metodologjia e vlerësimit dhe inventarizimit të asetëve në të gjithë njësitë e qeverisjes qendrore dhe përfundimin e regjistrimit i inventarit të plotë të aktiveve publike dhe procesin e migrimit të të dhënave nga institucionet buxhetore me akses të drejtpërdrejtë në SIFQ.
V.	1.a. Për periudhën objekt auditimit, rezulton se <u>69 institucioneve buxhetore të analizuar</u> , kanë shfaqur <u>probleme të shkeljes së afateve në lidhje me ngarkimin në SIFQ të pasqyrave individuale dhe dorëzimin e pasqyrave fizike individuale</u> , e më konkretisht: ✓ Për vitin 2021, evidentohet se <u>28 njësi shpenzuese / institucione buxhetore, nga 1016 institucione të qeverisjes së përgjithshme gjithsej</u> (të qeverisjes qendrore, të vetëqeverisjes vendore, të fondeve speciale, të zbatimit të projekteve dhe marrëveshjeve, etj., të regjistruara nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit), ose afro 3 % e tyre, <u>nuk kanë dorëzuar ose kanë dorëzuar me vonesë pasqyrat financiare individuale të institucioneve buxhetore pranë Degës së Thesarit</u> , me tejkallim dhe shkelje të afateve ligjore të miratuara nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet e dala në zbatim të tij. ✓ Për vitin 2022, <u>41 njësi shpenzuese/ institucione buxhetore, nga 1046 institucione gjithsej</u> (të qeverisjes së përgjithshme, të vetëqeverisjes vendore, të fondeve speciale, të zbatimit të projekteve dhe marrëveshjeve, etj., të regjistruara nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit), ose rreth 4 % e tyre, <u>nuk kanë dorëzuar ose kanë dorëzuar me vonesë pasqyrat financiare individuale të institucioneve buxhetore pranë Degës së Thesarit</u> , me tejkallim dhe shkelje të afateve ligjor të miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, sa vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet e dala në zbatim të tij. 1.b. Bazuar në informacionet e administruara nga	Më hollësisht trajtuar në Raportin e Auditimit	L	1.1. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit të merren masat për të administruar sipas afateve ligjore të miratuara, pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore, individuale dhe përmbledhëse nga të gjithë institucionet e sektorit publik. 1.2. Për të gjitha rastet e mosrespektimit të këtyre afateve nga ana e institucioneve përgjegjëse, të zbatohen nga Nëpunësi i Parë Autorizues sanksionet e parashikuara ligjore, si kundrejtë titullarëve të institucioneve shtetërore, ashtu edhe ndaj nëpunësve autorizues e zbatues përkatës, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

	<p>DPTH, rezulton se, nuk janë depozituar <i>Pasqyrat Financiare të Konsoliduara</i> (PFK) nga institucionet buxhetore dhe ekstrabuxhetore, si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none">✓ Për vitin 2021, nga 72 njësi të qeverisjes së përgjithshme, nga 138 gjithsej që sipas MFE që kanë detyrimin për hatimin dhe depozitimin e PFK-ve, ose nga 53 % institucioneve nuk kanë përmbushur këtë detyrim, ku peshën kryesore në këtë parregullsi e zënë institucionet e vetëqeverisjes vendore. Analizuar sipas strukturës së referuar, këto institucione detajohen si mëposhtë vijon:<ul style="list-style-type: none">▪ 2 ministri, 3 Këshilla të Qarqeve▪ 51 bashkitë▪ 17 institucione qendrore.✓ Për vitin 2022, nga 97 njësi të qeverisjes së përgjithshme, ose nga 70.3 % e institucioneve që kanë detyrimin për hatimin dhe depozitimin e PFK-ve, që sipas strukturës së referuar më lartë detajohen si mëposhtë vijon:<ul style="list-style-type: none">- 5 ministri;- 8 Këshilla të Qarqeve, 56 bashkitë;- 28 institucione qendrore dhe të tjera. <p>1.c. Nuk rezulton që të gjithë Njësitë e Zbatimit të Projekteve (NJZP) për v.2021 dhe 2022 të kenë depozituar pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore pranë DPTH së MFE-së si dhe, nuk janë përfshirë Pasqyrat Financiare të NJZP-ve, si pjesë e pasqyrave financiare të konsoliduara të njësive publike qendrore, në kundërshtim me përcaktimet e Paragrafit nr. 20, shkronja “c”, e UMF nr. 5, datë 21.2.2022.</p>			
VI.	<p><i>Nuk kanë gjetur zbatim detyrimet ligjore për konsolidim e pasqyrave financiare nga njësitë publike e sektorit publik, në nivel të qeverisjes së përgjithshme, po ashtu edhe në nivel qëndror dhe vendor, etj., në kundërshtim me përcaktimet e:</i></p> <ul style="list-style-type: none">• Paragrafit nr.20 dhe 23, të UMFE nr.5, datë 21.2.2022, që ka përcaktuar se: “Konsolidimi i Pasqyrave Financiare Vjetore deri në nivelin e Qeverisjes së Përgjithshme kryhet nëpërmjet grupimit të informacionit (duke bërë eliminimet dhe mënjnuar dublimet) dhe duke kaluar nivelet e mëposhtme:<ul style="list-style-type: none"><i>a)</i> Konsolidimi i pasqyrave financiare në <i>nivel njësie publike qendrore</i>, duke përfshirë informacionin financiar të organit qendror të njësisë (aparati), të gjitha njësitë e varësisë/njësi shpenzuese dhe pasqyrat financiare të kompanive nën kontroll ose pronësi të njësisë publike qendrore;<i>b)</i> Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivel njësie publike të <i>vetëqeverisjes vendore</i>, duke përfshirë informacionin financiar të organit qendror të njësisë (aparati), të gjitha njësitë e varësisë/njësi shpenzuese dhe pasqyrat financiare të kompanive nën kontroll ose pronësi të njësisë publike vendore;<i>c)</i> <i>Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivel qeverisje qendrore përfshirë të gjitha pasqyrat financiare të konsoliduara të njësive publike qendrore (ministri, institucione të tjera qendrore, fondet speciale të krijuara prej tyre, njësitë e menaxhimit dhe zbatimit të projekteve), informacionin e llogarisë qendrore të qeverisë, të llogarive të tjera speciale si dhe informacionin për borxhin qeveritar publik.</i>	Më hollësisht trajtuar në Raportin e Auditimit	L	<p>2.1. Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe ministrive të linjës administrative të merren masat për hartimin dhe paraqitjen për informim në Këshillin e Ministrave, të pasqyrave financiare të konsoliduara, të gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë për institucionet e qeverisjes së përgjithshme të sektorit publik. Këto pasqyra të inkuadrohen në raportin vjetor të zbatimit të buxhetit të shtetit, që përgatit Ministria përgjegjëse për financat.</p> <p>2.2. Nga ana e MFE të drejtohet dhe monitorohet procesi i konsolidimit dhe rakordimit të informacionit kontabël, zbardhjes së gjendjeve/ tepricave të llogarive si dhe realizimit të procesit të eliminimit të dublikimeve, përmbledhjes dhe konsolidimit në pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore, për institucionet e sektorit publik.</p> <p>2.3. Për të gjitha rastet e mosrespektimit të këtyre rregullave dhe teknikave të miratuara nga ana e institucioneve përgjegjëse, të zbatohen nga Nëpunësi i Parë Autorizues sanksionet e parashikuara ligjore, ndaj nëpunësve autorizues dhe zbatues të institucioneve shtetërore përkatës, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

<p>VII.</p>	<p><i>Për shkëlqet ligjore, në lidhje me mos respektimin e afatit të depozitimit të Pasqyrave Financiare Individuale e Përmbledhëse/ të Konsoliduara nga ana e njësive shpenzuese/ institucioneve shtetërore buxhetore apo ekstrabuxhetore etj., nga ana e Nëpunësit të Parë Autorizues nuk janë zbatuar përgjegjësitë ligjore mbi marrjen e masave administrative.</i></p> <p>Në një numër subjektesh shtetërore, buxhetore dhe ekstrabuxhetore, (në shtatë raste të analizuara), rezultojnë problematika dhe shkelje në mënyrë të përsëritur për dy vitet radhazi 2021 dhe 2022 lidhur me zbatimin e afatit të dorëzimit të pasqyrave financiare vjetore, të tilla si, <i>Bashkia Pustec, Shërbimi Kombëtar i Rinisë, Ministria e Kulturës, Ujësjellës Kanalizime sha Durrës, Ujësjellës Kanalizime sha Shkodër, Federata Shqiptare e Aero-nautikës, Federata Shqiptare e Motoçiklizimit, etj.</i></p> <p>Sa sipër, është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nenit 71, germa "e", Kreu IX, të ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar, "kur nëpunësi autorizues dhe/ose nëpunësi zbatues i njësive të qeverisjes së përgjithshme nuk përmbushin detyrimet për mbylljen e vitit buxhetor dhe nxjerrjen e llogarive vjetore të buxhetit, në kundërshtim me nenin 62 të këtij ligji, dënohen nga nëpunësi i parë autorizues me masë administrative ose me gjobë në masën 1-3 paga mujore". • Paragrafit nr. 45, Kreu V, të Udhëzimit nr.25, datë 09.12.2021 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2021", "Për mosrespektim të kërkesave të këtij udhëzimi nga ana e nëpunësit autorizues dhe zbatues të njësive të qeverisjes së përgjithshme, Nëpunësi i Parë Autorizues zbaton penalitetet e përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar; <p>Paragrafit nr. 45, Kreu VI "Masat administrative", të Udhëzimit nr.34, datë 14.12.2022 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2022".</p>	<p>Më hollësisht trajtuar në Raportin e Auditimit</p>	<p>L</p>	<p>Të merren masat nga ana e Nëpunësit të Parë Autorizues për vënien përpara përgjegjësisë dhe zbatimit të sanksioneve e masave administrative për nëpunësit autorizues e zbatues të njësive të qeverisjes së përgjithshme, që janë përgjegjës për funksionimin e sistemit të kontabilitetit, në përputhje me ligjin e buxhetit, aktet e tjera në zbatim të tij dhe me udhëzimet e Ministrisë të Financave mbi procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare.</p>
<p>VIII.</p>	<p><i>Për periudhën objekt auditimi 2021 dhe 2022, nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të MFE, si dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit (në po këtë ministri), nuk evidentohet asnjë rast i regjistruar, ku si pasojë e konstatimit të mosrakovimeve të pasqyrave të konsoliduara vjetore të pozicionit financiar (Balanci) në nivel gupi dhe pasqyrave financiare të gjeneruara nga SIFQ, r'i jenë kthyer institucionit buxhetor (ose organit qendror të tij) me pasaktësi e parregullsi, për azhornim në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë, referuar kërkesave të paragrafit nr. 23, të Udhëzimit të MFE nr.5, datë 21.2.2022, që përcakton se:</i></p> <p>"Pasqyra e konsoliduar vjetore e pozicionit financiar (Balanci) kontrollohet me pasqyrën përmbledhëse të pozicionit financiar të gjeneruar nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë dhe në rast mosrakovimi i kthehet njësive publike qendrore (organit qendror të saj) për azhornim në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë sipas informacionit kontabël të drejtave të konstatuara që disponon njësia qendrore</p>	<p>Më hollësisht trajtuar në Raportin e Auditimit</p>	<p>L</p>	<p>4.1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, për diferencat e konstatuara dhe të paargumentuara, të marrë masat për të kryer sistemet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të manualit të klasifikimit ekonomik kontabël, me qëllim për një pasqyrim dhe paraqitje të drejtë të gjendjes së llogarive vjetore të institucionit si dhe të parandalohen gabimet materiale dhe parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare vjetore.</p> <p>4.2. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit për rastet e mosrakovimeve të pasqyrave të konsoliduara vjetore të pozicionit financiar (Balanci) në nivel gupi dhe pasqyrave financiare të gjeneruara nga SIFQ, që janë me pasaktësi e parregullsi, tua kthejnë ato institucioneve buxhetore (ose organit qendror të tij) për azhornim, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

1.3. KONKLZIONI I AUDITIMIT:

Nga auditimi i kryer nga ana e KLSH-së, mbi vlerësimin e sistemit të kontabilitetit dhe raportimit financiar në institucionet e qeverisjes së përgjithshme të sektorit publik, sipas kërkesave të legjislationit mbi buxhetin dhe kontabilitetin, kanë rezultuar mangësi dhe parregullsi, të cilat mund të konsiderohen dhe klasifikohen si sistematike, thelbësore, dhe të përsëritura nga viti në vit.

Gjetjet e këtij raporti kanë nxjerrë në pah një varg të mangësive, dobësive dhe shkeljeve, si nga institucionet e qeverisjes qendrore, ashtu edhe nga ato të vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e varësisë së tyre, përsa i përket zbatimit të parimeve dhe normave të kontabilitetit të sektorit publik. Më hollësisht, këto dobësi e anomali janë identifikuar si më poshtë vijon:

- Kuadri rregullator dhe politikat e miratuara nga MFE, të zbatueshme për njësitë shpenzuese të sektorit publik, bazohen në disa udhëzues të karakterit administrativ që adresojnë procedurën e hartimit, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare të sektorit publik. *Sa më sipër*, mungon një kuadër i plotë ligjor mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare që ti shërbejë rritjes e llogaridhënies dhe ushtrimit të autoritetit të MFE nëpërmjet sanksioneve në rast të mos zbatimit të këtyre dispozitave.
- Nuk janë hartuar e miratuar aktet e detyrueshme që synojnë të vendosin në zbatim SNKSP-të / IPSAS mbi kontabilitetin me bazë të drejtat e detyrimit e konstatuara, që është korniza rregullatore për çdo nivel qeveritar dhe është vonuar procesi i vënies në zbatim i këtyre standardeve. Zbatimi i paketës së standardeve të kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara SNKSP është një sipërmarrje e ndërlikuar, ndonese Projekti shumëfazësh për zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik shqiptar ka filluar që në v.2018 dhe shtrihet sipas dokumenteve strategjike deri në vitin 2027, periudhë kjo relativisht e gjatë.
- Strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nuk kanë hartuar pasqyrat financiare përmbledhëse, të konsoliduara për sektorin publik, për periudhën objekt auditimi 1.1.2021-31.12.2021 dhe 1.1.2022-31.12.2022. *Sa më sipër*, nuk është vepruar në përputhje me paragrafin 125, kreu V “Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore”, të Udhëzimit nr.8, datë 9.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, që shprehimisht ka përcaktuar se: “Në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, hartohen pasqyrat financiare përmbledhëse/ të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme, qendrore e vendore, brenda Qershorit të vitit pasardhës, për vitin ushtrimor të mbyllur, mbi bazën e informacionit të depozituar nga strukturat përgjegjëse të përmendura në këtë udhëzim”. Nga auditimi i kryer nga audituesit e autorizuar të KLSH-së, në lidhje me zbatimin e standardeve të raportimit financiar dhe sistemin e kontabilitetit të sektorit publik, ka rezultuar se, nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nuk janë hartuar e dorëzuar në Qeveri dhe Kuvend, Pasqyrat Financiare Përmbledhëse, të Konsoliduara as në nivel grupi (ministrie), as në nivlin e përgjithshëm për Njësitë e Sektorit Publik si për vitin buxhetor 2021, ashtu edhe për vitin 2022, duke mos u dhënë kështu mundësinë përdoruesve të interesuar, të brendshëm dhe të jashtëm të marrin informacion të saktë e të besueshëm si dhe të nxjerrin konkluzione të arsyeshme.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

- Nuk ofrohet siguri mbi saktësinë dhe cilësinë e informacionit kontabël, të përmbledhur në nivel grupi (ministri, etj), që në shumë raste ka nëshfaqur pasaktësi dhe mospërputhje. Si rrjedhim, për vitin 2021 dhe 2022, pasqyrat financiare të sektorit publik, nuk janë përfshirë në raportin vjetor të zbatimit të buxhetit të shtetit, të përgatitur nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
- Janë evidentuar mangësi në zbatimin e procedurave dhe repektimin e afateve të përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave të llogaridhënies vjetore/ bilanceve vjetore individuale nga institucionet buxhetore dhe hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduara, gjë që tregon për dobësi në zbatimin e ligjit të buxhetit dhe akteve nënligjore mbi kontabilitetin e sektorit publik. Nuk janë marrë masat rast pas rasti, mbi nxjerrjen e përgjegjësive administrative ndaj nëpunësve autorizues dhe zbatues të institucioneve buxhetore e ekstrabuxhetore, për mosdorëzimin apo dorëzimin jashtë afat ligjor të përcaktuar, të pasqyrave financiare individuale dhe të përmbledhura.
- Mungesa e rakordimit dhe e shpjegimeve në lidhje me mospërputhjet/ mosrakordimet e informacioneve dhe të dhënave të gjeneruara nga Sistemi Informativ Financiar i Qeverisë, me të dhënat e pasqyrave financiare të dorëzuara fizikisht nga ana e njësive të qeverisjes së përgjithshme.
- Në një numër rastesh, nuk sigurohet krahasueshmëria e të dhënave të Pasqyrave Financiare të Konsoliduara dhe raporteve financiare të përgatitura nga ana e organeve shtetërore për ushtrimin e mëparshëm dhe bilancin e çeljes për vitin ushtrimor; gjë që tregon për moskryerjen e kontrolleve sistematike të informacioneve që dërgojnë institucionet shtetërore në ministritë e linjës, në shkelje të parimeve dhe normave kontabël.
- Mungon regjistri i aktiveve dhe pasurive shtetërore në nivel qendror dhe për gjithë sektorin e qeverisjes së përgjithshme. Nuk ofrohet siguri e mjaftueshme se institucionet e sektorit publik kanë vendosur e zbatuar kontrole dhe monitorime të plota mbi pasuritë dhe menaxhimin e tyre në mënyrë efikase. Dobësi janë evidentuar në kryerjen e procesit të inventarizimit vjetor të asetëve dhe mungesa e vlerësimit të pasurive të institucioneve buxhetore e ekstrabuxhetore me qëllim pasqyrimin në kontabilitet të aktiveve, me vlerën e tyre të drejtë.
- Llogaritë kryesore inventariale të pasurisë, (sintetike dhe analitike), rezultojnë me pasaktësi për shumë institucione buxhetore e njësi shpenzuese të testuara, pasi mungojnë analizat e tyre. Praktika të njëjta të mosregjistrimit në kontabilitet të vlerës së “Ndërtesave” dhe mos evidentimit të gjendjeve të llogarisë “Toka, troje e terrene” konstatohen gjerësisht, si në auditimet e institucioneve në nivelin qendror, duke vazhduar edhe me ato në nivel vendor, edhe pse për vite më radhë janë dhënë rekomandime për përmirësimin e kësaj fushë, duke shënuar një përmirësim të pandjeshëm, në raport me vitet paraprake.
- Rritje të vazhdueshme të llogarive të arkëtueshmeve dhe të detyrimeve të pagueshme, shtim i stokut të detyrimeve të shtetit nga vendimet e Gjykatave të Arbitrazhit dhe GJEDNJ, nivel i lartë i shpenzimeve buxhetore nga vendimet gjyqësore / përmbartimore, me ndikim në rritjen e shpenzimeve shtesë, etj.

Bazuar sa më lartë,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

KLSH vlerëson se progresi i bërë në lidhje me hartimin e bazës ligjore dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara të shtetit është i pa mjaftueshëm kundrejtë kriterëve ligjore dhe objektivave në këtë fushë, duke patur në konsideratë dhe situatën aktuale të raportimit financiar publik, pasi normat e Kontabilitetit të Sektorit Publik Publik nuk janë të plota dhe përfaqësohen vetëm me Udhëzimin e MFE-së nr.8, datë 9.3.2018 “Mbi procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

MFE nuk ka hartuar pasqyrat financiare të konsoliduara për organet e qeverisjes së përgjithshme për vitin 2021 dhe 2022. Në këto kushte, Kontrolli i Lartë i Shtetit, e ka të pamundur dhe nuk mund të japë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të konsoliduara për njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Bazuar në rezultatet e auditimeve të kryera, KLSH e ka të pamundur të japë siguri në lidhje me të gjithë elementët e llogarive kontabël dhe pasqyrave individuale e përmbledhëse të llogaridhënies vjetore të institucioneve të qeverisjes së përgjithshme, duke përfshirë edhe asetet në pasqyrat financiare të konsoliduara të Shtetit Shqiptar, në përputhje me nenin 63, “Miratimi i raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit”, ku nënvizohet shprehimisht se, “Kontrolli i Lartë i Shtetit shqyrton dhe certifikon pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit dhe i paraqet Kuvendit një raport të plotë për zbatimin e buxhetit të vitit të mëparshëm fiskal”.



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCIVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr **360/4, datë 13.04.2023** në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë Tiranë, nga data 20.4.2023 – 14.07.2023, për periudhën nga 01.01.2021 deri në 31.12.2022, u krye Auditimi Financiar, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. Q.C, (përgjegjës grupi),
2. A. Z, anëtar
3. G.G, anëtar,
4. A.M, anëtar.

a) Titulli:

Projektraporti i Auditimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me objekt:
“Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme”.

b) Marrësi:

Ky Raport Përfundimtar i Auditimit i adresohet Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, znj.D.I.

METODOLOGJIA DHE OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

a) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Auditimi financiar synon dhënien e një vlerësimi të pavarur, që rezulton në një opinion me siguri të arsyeshme, nëse gjendja e raportuar financiare e një subjekti të audituar, rezultatet dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar. Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare do të jenë:

-Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara nga ministritë, këshillat e qarkut, institucionet e qeverisjes qendrore, pushtetit vendor, etj.

-Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; *përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.*

-Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; *ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.*

-saktësia dhe plotësia e informacionit kontabël mbi raportimin financiar dhe hartimi i pasqyrave të konsoliduara për sistemin e qeverisjes së përgjithshme

-Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si; *transaksione, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.*

b).Qëllimi i Auditimit:

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, *nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

Qëllimi i auditimit: është dhënia e konkluzioneve mbi rregullshmerine e zbatimit të kuadrit ligjor në fushën e hartimit, depozitimit dhe miratimit të pasqyrave financiare individuale nga ana e njëjësive shpenzuese si dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime².

c) Identifikimi i çështjes:

Projekt Raporti synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësiave e Ministrive dhe institucioneve të qeverisjes qëndrore, në funksion të zbatimit të procedurës dhe kritereve ligjore në fuqi, mbi kontabilitetin dhe raportimin financiar.

Në fokusin e angazhimit janë hartimi, depozitimi, miratimi dhe konsolidimi i Pasqyrave Financiare Individuale Vjetore nga ana e institucioneve buxhetore, saktësia dhe niveli i përfshirjes në konsolidim të informacionit financiar të Ministrive të treguesve dhe bilanceve të njëjësive shpenzuese/ subjekteve të varësisë, në përputhje me kërkesat e të dispozitave ligjore dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi në fushën e kontabilitetit dhe pasqyrave financiare të sektorit publik, si dhe aspektet e zbatimit të kërkesave të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin”, i ndryshuar. Aktivitetet që janë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit nr.360/4, datë 13.04.2023.

c) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Referuar kuadrit nënligjor në fuqi, Ministri i Financave dhe Ekonomisë është përgjegjës për krijimin e sistemit të kontabilitetit të detyrueshëm për të gjithë njësitë e qeverisjes së përgjithshme si dhe harton standardet e kontabilitetit dhe raportimit në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuar aktet nënligjore dhe metodologjinë në fushën e Kontabilitetit Publik.

d) Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Raporti i auditimit duhet të deklarojë që përgjegjësia e audituesit është të shprehë një opinion mbi pasqyrat financiare të konsoliduara të Sektorit Publik, nëse ato janë përgatitur, bazuar mbi auditimin, ose të japë konkluzionet që i shërbejnë përmirësimit të veprimtarisë në të ardhmen. Raporti i auditimit duhet të shprehë që auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Gjithashtu, raporti i audituesit duhet të shpjegojë që këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim që të arrijë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare të konsoliduara në nivel grupi (*institucioni qëndror/ ministrie linje etj*), nuk kanë anomali materiale. Raporti i audituesit duhet të përshkruajë një auditim duke u shprehur se: Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për marrjen e evidencës së auditimit në lidhje me shumat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare individuale dhe përmbledhëse; Procedurat e auditimit të zgjedhura janë në varësi të gjykimit të audituesit, përfshirë këtu vlerësimin e risqeve të anomaliave materiale në pasqyrat financiare, të cilat mund të vijnë si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Në vlerësimin e këtyre risqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm si dhe kuadrin e përgjithshëm të kontabilitetit dhe raportimit financiar lidhur me përgatitjen e pasqyrave financiare të subjektit/subjekteve në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme

² -Rregullorja e Procedurave të Auditimit në KLSH, miratuar nga Kryetari KLSH me Vendimin nr. 107, datë 8.9.2017, me ndryshimet.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

për rrethanat, por jo me qëllimin për të shprehur një opinion mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit. Kur pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me një kuadër të paraqitjes së drejtë, përshkrimi i auditimit në raportin e audituesit duhet t'i referohet “përgatitjes dhe paraqitjes së drejtë të pasqyrave financiare të subjektit” ose “përgatitjes së pasqyrave financiare që japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë”, që është e përshtatshme sipas rrethanave. Raporti i audituesit duhet të shprehë se audituesi beson që evidenca e auditimit e disponuar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme në funksion të qëllimit të auditimit.

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin / opinionin mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar.

e) Kriteret e vlerësimit:

Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

<i>Lloji i dokumentit:</i>	<i>Detajet e bazës ligjore dhe rregullatore</i>
Standardet e auditimit:	<ul style="list-style-type: none">- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t;- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);- Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA);- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI^t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit”;- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH.
Ligje:	<ul style="list-style-type: none">- Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;- Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.
VKM:	<ul style="list-style-type: none">- VKM nr. 50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të plan-veprimt”.
Udhëzime:	<ul style="list-style-type: none">- Udhëzimi MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar;- Udhëzimi MFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”;- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCIVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

	- Udhëzimet standard të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit
Rregullore:	- Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 197, datë 12.10.2022; - Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 63, datë 22.6.2020, të Kryetarit të KLSH-së e ndryshuar.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundur dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akt Konstatimit të mbajtur mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky Raporti i Auditimit.

- Nga ana e institucionit të KLSH është dërguar Projekt Raporti i Auditimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 360/7, date 31.07.2023 (protokoll i MFE Nr. 7019/4, date 01.08.2023).
- Nga ana e strukturave të MIE, komentet dhe objeksionet e në lidhje me PRA janë dërguar me shkresën e MFE me nr .7019/5, datë 18.8.2023, protokolluar në KLSH me nr.360/9, datë 22.8.2023, të cilët janë shqyrtuar dhe trajtuar nga grupi i auditimit dhe përfshirë në këtë raport përfundimtar të auditimit.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

vlerësimin e riskut, duke ia nënshtuar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH aplikon, e konkretisht:

$\text{Risku i Auditimit} = \text{Risku i qenësishëm} * \text{Risku i kontrollit} * \text{Risku i Zbulimit}$
--

Nisur sa më sipër, është aplikuar niveli i Riskut të Auditimit i pranuar prej 5%, i mbajtur parasysh për nivelin e procedurave analitike dhe testeve thelbësore të kryera.

Metodat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, ndërkohë që midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*)

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk evidentuan ndonjë gabim aritmetik, regjistrimi mund të jetë i gabuar, nëse evidentimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u kryen sondazhe të kontrollit fizik të magazinave, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtuar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Dega e Thesarit dhe SIFQ.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabile. Mund të përmendim nëse ka: *mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshhta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.*

7. Intervistimi

8. Raporte dhe Informacione

9. Pyetësorët për vlerësimin e e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E FINANCIVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

III. DREJTIMET E AUDITIMIT:

Në zbatim të programit të miratuar të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni dhe rezultoi si më poshtë:

- I. *Mbi metodologjinë e aplikuar në fushën e mbajtjes së kontabilitetit dhe raportimit financiar të sektorit publik. Korniza ligjore dhe aktet nënligjore në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar në sektorin publik dhe llogaridhënien e qeverisë. Sistemi i kontrollit të brendshëm në funksion të përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara nga ana e institucioneve të qeverisjes së përgjithshme dhe MFE.*

Bazuar në përcaktimet ligjore në fuqi, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përgjigjet për azhornimin e metodologjisë së kontabilitetit publik me zhvillimet bashkëkohore dhe ndjekjen e procesit të zbatimit të strategjisë së Qeverisë për implementimin e standardeve të kontabilitetit publik.

Në lidhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në dushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar, konstatohet se fushëveprimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor mbi kontabilitetin e sektorit publik është i rregulluar, në sa më poshtë vijon:

- **A.** Ligji nr. 25/2018, datë 10.5.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, ka parashikuar se ky ligj zbatohet nga: njësitë ekonomike që kanë qëllime fitimprurëse, pavarësisht nga forma e tyre juridike ose nga kërkesat e veçanta ligjore që mund të zbatohen ndaj tyre si dhe njësitë ekonomike jofitimprurëse, me përjashtim të rasteve kur pasqyrat financiare dhe kontabiliteti i tyre janë subjekt i ligjeve ose i rregullimeve të veçanta. Pika nr. 6, e Nenit 3, të po këtij ligji, përcakton se: “Njësi ekonomike”, janë personat juridikë dhe fizikë, publikë dhe privatë, me dhe pa qëllime fitimprurëse, që kryejnë veprimtari dhe kanë seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë. **Përfshihen nga ky përkufizim njësitë e qeverisjes së përgjithshme, sipas ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar**”.
- **B.** Nga ana e MFE, në mbështje të nenit 3 dhe 6, të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 6 të Ligjit nr. 10296, date 8.7.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; nenit 10 dhe 11 të Ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, (ligj ky i shfuqizuar me ligjin nr. 25, dt 10.5.2018), Ministri i Financave dhe Ekonomisë, ka nxjerrë **Udhëzimin nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”**.
Në përputhje me përcaktimet e Kreut V, Paragrafi nr. 127, të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 9.3.2018, “Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare. Efektet e këtij udhëzimi shtrihen duke filluar nga përgatitja dhe raportimi i pasqyrave financiare vjetore të vitit 2018”. Ky udhëzim është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 49, datë 11 Prill 2018.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

- **C. Udhëzimi nr.5, datë 21.2.2022** “Për disa ndrydhime në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, është iniciuar mbështetur në nenin 3 dhe 61 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor”, i ndryshuar dhe në nenin 6, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.
Në përputhje me përcaktimet e Paragrafit nr. 27 dhe 28, të Udhëzimit të MFE nr.5, datë 21.2.2022, “Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare. Efektet e këtij udhëzimi shtrihen duke filluar nga përgatitja dhe raportimi i pasqyrave financiare vjetore të vitit 2021”.

Konstatim nr.1:

Për periudhën objekt auditimit, kuadri unifikues dhe baza rregullatore e sistemit të kontabilitetit të detyrueshëm më institucionet e sektorit publik, (të qeverisjes qendrore, vendore dhe fondeve speciale), përfaqësohet nga një akt nënligjor teknik, siç është Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.3.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.5, datë 21.2.2022, i cili konsiderohet si një nivel i ulët në hierkinë e dispozitave ligjore. Në këtë kontekst, nuk është shënuar ndonjë progres në fushën e legjislacionit të kontabilitetit të sektorit publik, meqenëse deri në mesin e vitit 2018, veprimtaria e kontabilitetit publik në sektorin buxhetor rregullohej nga një ligj i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, (specifikisht Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”).

Sa më sipër, nuk janë përmbushur:

- detyrimet e Kreut 5.4, (Produkti 5.4.2), të Strategjisë së MFP 2019-2022, mbi përfundimin e akteve ligjore në përputhje me IPSAS dhe planin e miratuar të veprimit strategjik të vendit, që përcakton si afat përfundimtar nxjerrjen e akteve ligjore Tremujorin e Katërt të vitit 2022.
- kërkesat e Nenit 61 “Standardet dhe procedurat e kontabilitetit”, Kreu VII “Kontabiliteti i sistemit buxhetor”, të Ligjit nr.9936, dt. 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, që ka përcaktuar se, (cituar):

Ministri i Financave është përgjegjës për krijimin e sistemit të kontabilitetit të detyrueshëm për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuar. Ministri i Financave përcakton njësinë përkatëse të qeverisjes së përgjithshme dhe njësitë shpenzuese, të cilat janë të detyruara të mbajnë kontabilitet dhe të raportojnë sipas standardeve të përcaktuara.

Sistemi i thesarit mban kontabilitetin e shtetit dhe është pjesë e kontabilitetit publik. Ai është përgjegjës për mbajtjen e llogarive të shtetit dhe përgatitjen e raporteve periodike dhe vjetore të zbatimit të buxhetit.

Kontabiliteti dhe raportimi në sektorin publik rregullohen me ligj të veçantë dhe Ministri i Financave nxjerr udhëzim për standardet dhe procedurat e kontabilitetit, për njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Nëpunësi i parë autorizues dhe nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes së përgjithshme përgjigjen për funksionimin e sistemit të kontabilitetit, në përputhje me këtë ligj dhe aktet e tjera në zbatim të tij dhe me udhëzimet e Ministrit të Financave. Metoda e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

shpenzimeve dhe e të ardhurave, për qëllim të këtij ligji, ka të bëjë me: a) njohjen e shpenzimeve korrente dhe kapitale të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës; b) njohjen e të ardhurave tatimore, jotatimore, përfshirë edhe të ardhurat nga shitja e aktiveve, në çastin e arkëtimit të tyre.

Konstatim nr.2:

Përsa i takon fuqisë juridike të Udhëzimeve të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë në fushën e Kontabilitetit të Sektorit Publik, rezulton se:

- **Paragrafi nr.127, i Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”**, ka përcaktuar shprehimisht (*cituar*), “Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare. Efektet e këtij udhëzimi shtrihen duke filluar nga përgatitja dhe raportimi i pasqyrave financiare vjetore të vitit 2018”.

Nga shqyrtimi del se ky udhëzim është publikuar në Fletoren Zyrtare me nr. 49, datë 11 Prill 2018.

- **Paragrafët nr.27 dhe 28, të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.2.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”**, kanë përcaktuar shprehimisht (*cituar*), “Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare”. ”Efektet e këtij udhëzimi shtrihen duke filluar nga përgatitja dhe raportimi i pasqyrave financiare vjetore të vitit 2021” .

Në bazë të nenit 28, germa “ç”, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e keshillit të ministrave”, **udhëzimi**, “është akti nënligjor i Këshillit të Ministrave, i ministrit ose drejtuesit të institucionit qendror, në varësi të Kryeministrit ose të ministrit, me karakter shpjegues, që **shtjellon me hollësi të gjitha urdhërimet e ligjit ose të vendimit të Këshillit të Ministrave**”. Sipas pikës 3, të nenit 29 “Hyrja në fuqi e akteve” të po këtij ligji: “*Udhëzimet e Këshillit të Ministrave dhe të ministrit marrin fuqi juridike pas botimit në Fletoren Zyrtare*”.

Nga verifikimet e kryera nga audituesit e autorizuar të KLSH-së rezulton se, Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.5, datë 21.2.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, nga data e miratimit të udhëzimit, (21 Shkurt 2022), deri në datën e mbajtjes së këtij raporti, **nuk është publikuar në Fletoren Zyrtare. Sa sipër, është vepruar në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003³.**

- D.Në lidhje me **Standardet e Kontabilitetit Publik** në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike (MFP) 2019-2022 thuhet se: Qëllimi i standardeve është të përmirësojnë cilësinë e raportimit të përgjithshëm financiar nga institucionet e sektorit

³ -Udhëzimi nr. 5, i datës 21.02.2022, i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë mund të akeshohet nëpërmjet linkut të mëposhtëm në faqen zyrtare në internet të kësaj ministrie: (<https://financa.gov.al/akte-ligjore-dhe-nenligjore-ne-fushen-e-kontabilitetit-publik/>)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme


publik, duke çuar në vlerësime më të informuara të vendimeve të Qeverive për alokimin e burimeve, duke rritur në këtë mënyrë transparencën dhe përgjegjshmërinë.

Drejtoria e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Publik e MFE është struktura e ngarkuar me përgatitjen dhe hartimin e kuadrit të nevojshëm për kontabilitetin e sektorit publik të SNKSP-ve dhe të raportojë mbi progresin e bërë. Ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit është struktura përgjegjëse bashkërenduese dhe koordinuese, e cila, ndër të tjera ka si funksion “regjistrimin, kontrollin, kontabilizimin dhe përpunimin e informacionit të transaksioneve të qeverisjes së përgjithshme dhe mbi këtë bazë, gjenerimin e raporteve të ndryshme; përmirësimin e sistemit të shërbimeve financiare në përshtatje me ndryshimet e vazhdueshme”⁴.

Nga ana tjetër, sipas Rregullores së Organizimit dhe Funkcionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, miratuar nga Ministri i MFE me nr. 18248, datë 2.12.2020, “Misioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit (DPTH) është sigurimi dhe realizimi i shërbimeve financiare operationale për qeverisjen e përgjithshme që garanton parandueshmëri dhe gatshmëri për kryerjen e transaksioneve të pagesave; rritja e transparencës fiskale të Qeverisë nëpërmjet përmirësimit të procedurave të kontrollit parandalues dhe pas procesimit të biznesit si dhe të raportimit financiar sipas standardeve ndërkombëtare për një menaxhim me ekonomi, efikasitet, efektivitet.”

Në referencë të strukturës organike dhe organigramës së miratuar të MFE-së, Drejtoria e Operacioneve të Thesarit ka në përbërje të saj tre sektorë: Sektorin e Llogarisë së Unifikuar të Thesarit, Sektorin e Drejtimit të Likuiditetit dhe Sektorin e Raportimit Financiar dhe Kontabilitetit.

Organigrama e DPTH është e pasqyruar në vijim:



Burimi: MFE, DPTH, Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të DPTH

Në pikën nr.3, të nenit 7 të rregullores së sipërcituar të dp së thesarit, janë përcaktuar këto detyra dhe funksione të “drejtorisë së operacioneve me thesarin”:

“regjistrojnë, kontrollojnë, kontabilizojnë dhe përpunojnë informacionin mbi transaksionet e qeverisjes së përgjithshme dhe mbi këtë bazë, gjenerojnë:

⁴ - <https://financa.gov.al/drejtorene-e-operacioneve-te-thesarit/>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

- **raportet dhe pasqyrat financiare në monedhën vendase si dhe**
- **të dhënat e treguesve fiskale në përfshirje të ligjit të buxhetit faktik vjetor për miratim nga parlamenti”.**

Në vijim kësaj dispozite, janë përgjegjësitë kryesore të detajuara të sektorit të raportimit financiar dhe kontabilitetit (në përbërje të drejtorisë), që identifikohen në këtë mënyrë:

“monitoron procesin e **kontrollit, rakordimit dhe përpunimit të informacionit të transaksioneve të njëjësive** të qeverisjes së përgjithshme në sistemin informatik financiar të qeverisë nga strukturat përgjegjëse për thesarin në degë, **me qëllim hartimin e raportimeve financiare (raportimin fiskal, statistikor dhe pasqyrat financiare të konsoliduara)** si dhe kryhen procesimin e pagesave elektronike të krijuara dhe konfirmuara nga strukturat përgjegjëse për thesarin në degë.”

Konstatim nr.3:

Mungesë dhe mosplotësim kapacitetesh në drejtorinë e operacioneve të thesarit (pjesë e dpth), me specialistët e raportimit financiar dhe kontabilitetit.

Bazuar në të dhënat e vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga ana e ministrisë së financave dhe ekonomisë, rezulton se sektori i raportimit financiar dhe kontabilitetit (në doth/dpth), për periudhën e auditimit ka në strukturën e miratuar 1 përgjegjës sektori dhe 4 specialistë, që sipas përshkrimit të funksioneve dhe detyrave të tyre, përcaktohen në:

specialist për monitorimin dhe kontrollin periodik të transaksioneve të të hyrave të qeverisjes së përgjithshme në sistemin informatik financiar të qeverisë (sifq).

Specialist për monitorimin dhe kontrollin periodik të transaksioneve të të dalave të qeverisjes së përgjithshme në sistemin informatik financiar të qeverisë (sifq).

specialist i raportimit financiar dhe kontabilitetit i cili përgjigjet për menaxhimin e informacionit për raportimin komprehensiv të pozicionit financiar të qeverisjes së përgjithshme me anë të sistemit informatik financiar të qeverisë.

Specialist i raportimit financiar dhe kontabilitetit i cili përgjigjet për menaxhimin e informacionit për raportimin komprehensiv të pozicionit financiar të qeverisjes së përgjithshme me anë të sistemit informatik financiar të qeverisë.

Evidentohet se, pozicioni i specialistit të raportimit financiar dhe kontabilitetit është vakant që prej muajit maj të vitit 2022 dhe si rrjedhojë, prej më shumë se 1 vit ky sektor ka operuar me kapacitet të reduktuara, duke patur në përbërje përgjegjësin e sektorit dhe tre specialistë.

Nga ana e ministrit të financave dhe ekonomisë, procedurat në lidhje me përmbajtjen dhe publikimin e pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara të shpenzimeve dhe të ardhurave nga ana e njëjësive të qeverisjes së përgjithshme, janë rregulluar nëpërmjet miratimit të udhëzimeve vjetore, përkatësisht:

Udhëzimit nr. 25, datë 09.12.2021 ”per procedurat e mbylljes se llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2021”, dhe

Udhëzimit nr. 34, datë 14.12.2022 ”per procedurat e mbylljes se llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2022”.

Në dokumentin e **strategjisë për menaxhimin e financave publike 2019-2022, miratuar me vkm nr. 824, datë 18.12.2019**, është nënvizuar që, “është bërë progres në përmirësimin e transparencës dhe përfshirjen e publikut. Informacioni financiar për qeverisjen qendrore dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

vendore botohet në faqen e mfe-së, përfshirë në “portalin e transparencës” mbi financat vendore. U realizua një analizë hendeku për kontabilitetin, për të krahasuar kuadrin rregullator të kontabilitetit me snksp, në mënyrë që të merren marrat e e duhura për zbatimin e kontabilitetit në bazë të drejtash dhe detyrimesh të konstatuara. Gjithashtu, në dph/kbfp u krijua një funksion i posaçëm për kontabilitetin, i cili do të ketë përgjegjësinë të përditësojë metodologjinë e kontabilitetit në sektorin publik, si dhe të hartojë akte ligjore dhe nënligjore në sektorin privat. Gjatë vitit 2018, dhmfk-ja në bashkëpunim me drejtorinë e buxhetit dhe drejtorinë e thesarit hartuan dhe aprovuan udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, qëllimi i të cilit ishte përcaktimi i bazës rregullatore për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, bazuar në kuadrin rregullator të fushës. Megjithatë, kjo është një **masë tranzitore** deri në zbatimin e plotë të standardeve që janë në përputhje me snksp⁵.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit të klsh, konstatohet se, zhvillimi i kuadrin rregullator të kontabilitetit dhe atij ligjor, në fushën e kontabilitetit me bazë të drejtash e detyrimesh të konstatuara, vazhdon të mbetet prioritet në strategjinë e menaxhimit të financave publike 2019-2022 dhe në planin kombëtar të veprimit, “*me synim zbatimin gradual të kontabilitetit në bazë të drejtash e detyrimesh të konstatuara*”⁶.

Nga ana e audituesve të autorizuar u analizua status-progresi i arritur nga ana e MFE (respektivisht nga drejtoritë përgjegjëse, të lidhura me sistemin e hartimit dhe miratimit të politikave të kontabilitetit të sektorit publik dhe zbatimit të këtij kadri përsa i përket hartimit të pasqyrave financiare vjetore përmbledhëse) dhe zbatimit efektiv të këtyre standardeve nga njësitë zbatuese/ strukturat buxhetore dhe sipas komponentëve të strategjisë mfp, ku rezulton si mëposhtë vijon:

Komponenti 5.4: kontabiliteti

Objektivi: kontabiliteti është në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik (snksp)

Konteksti

Institucionet buxhetore në shqipëri përdorin një sistem të modifikuar të kontabilitetit të bazuar në vlera monetare, me disa elementë të parimit të kontabilitetit mbi bazë të drejtash e detyrimesh të konstatuara, kryesisht për aktivet fizike, arkëtimet dhe detyrimet. Qeveria synon që gradualisht të përshtasë pjesërisht ose plotësisht standardet ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik (snksp) duke mbajtur parasysh kontekstin e shqipërisë, **por nuk është specifikuar ende një datë indikative kur mund të përfundojë ky proces.**

Nga shqyrtimi i dokumentit të strategjisë, grupi i auditimit të klsh vëren se,

- ***Është realizuar një analizë e mangësive në vitin 2017,*** (e cila krahason kuadrin rregullator ekzistues me snksp dhe hedh bazat për të marrë masa të mëtejshme nën këtë komponent).
- ***Në vitin 2018, është krijuar një funksion i posaçëm për kontabilitetin, në drejtorinë e harmonizimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, në mfe,*** përgjegjës për hartimin dhe aprovimin e metodologjisë për kontabilitetin në fushën e sektorit publik si dhe për

⁵ Strategjia për menaxhimin e financave publike 2019-2022, Tiranë 2019, faqe 37

⁶ Po aty, faqe 38.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

aktet ligjore dhe nënligjore për kontabilitetin në sektorin privat. Kjo strukturë mbështet procesin e kalimit drejt kontabilitetit me bazë të drejtash e detyrimesh dhe detyrimesh të konstatuara nëpërmjet adoptimit të kuadrit rregullator, që është në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik (snksp). *Zhvillimi i kuadrit rregullator të kontabilitetit dhe atij ligjor, në fushën e kontabilitetit me bazë të drejtash e detyrimesh të konstatuara, vazhdon të mbetet prioritet në strategjinë e menaxhimit të financave publike, megjithëse në një plan kohor më të gjatë nga ai që ishte parashikuar në Strategjinë e MFP-së.*

- **Gjatë vitit 2019, është hartuar dhe miratuar *Plani Strategjik Kombëtar i Veprimit*, i cili përmban fazat dhe aktivitetet që do të realizohen për zbatimin gradual të kontabilitetit në bazë të drejtash e detyrimesh të konstatuara, duke filluar me Ministrinë e Linjës dhe agjencitë e tyre.**

Nga ana e grupit të auditimit u vlerësuan hapat mbi ecurinë e këtij procesi dhe rezultoi se:

Banka Botërore, nëpërmjet financimit nga Sekretariati Zvicerian i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO), ka mbështetur Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE) në zbatimin e reformës për zhvillimin e kontabilitetit në sektorin publik në Shqipëri, në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare, duke patur si synim kryesor *përmirësimin e vendimmarrjes, përgjegjshmërisë, transparencës dhe performancës në sektorin publik*. Kjo reformë mbështetet në qasjen e **adoptimit me disa faza (nga viti 2021 – 2027)**, sipas parashikimeve në dokumentin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit, e cila mbështetet në prioritetet e përcaktuara në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike (PFM 2019- 2022).

Realizimi i kësaj reforme ka filluar që nga viti 2018 përmes projektit “*Zhvillimi i kontabilitetit të sektorit publik në Shqipëri (IPSAS)*”, dhe rezultoi të jenë realizuar këto komponentë apo aktivitete, si më poshtë vijon:

- ***Në lidhje me bazën rregullatore për kontabilitetin dhe raportimin financiar bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS) dhe parakushtet e tjera të domosdoshme për realizimin e kësaj reforme, nga ana e MFE:***
 - a. Është përfunduar ***procesi i përkthimit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS)*** nëpërmjet programit TRADOS, është nënshkruar marrëveshja me Federatën Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC) për përfitimin e të drejtës për përkthimin e këtyre standardeve në gjuhën shqipe si dhe publikimin e tyre. Këto standarde do të shërbejnë si bazë teorike dhe referencë për kuptimin dhe interpretimin e metodologjisë së re kontabël. Standardet e përkthyer janë të publikuara në faqen e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë⁷.
 - b. Është përgatitur një ***metodologji e re e kontabilitetit*** dhe e proceseve të punës të lidhura me të. Kjo bazë e re rregullatore përbëhet nga ***dhjetë udhëzime që mbulojnë të gjitha fushat e kontabilitetit në përputhje me IPSAS si inventarët, provigjionet, aktivet afatgjata jomateriale, aktivet afatgjata materiale mbi shpenzimet si dhe mbi përfitimet sociale dhe përfitimet e punonjësve, të ardhurat, mbi konsolidimin e pasqyrave financiare si dhe mbi instrumentat financiarë si dhe nga plani i llogarive bazuar në kontabilitetin mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara (IPSAS)***. Kjo

⁷ - <https://financa.gov.al/standardet-nderkombetare-te-kontabilitetit-te-sektorit-publik-ipsas/>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

tërësi dokumentash do të mundësojë hartimin e bazës ligjore për hyrjen në fuqi të zbatimit të metodologjisë të re, e cila siç është theksuar në këtë raport nuk është finalizuar sipas afateve të miratua nga këshilli i Ministrave.

- c. Është hartuar dokumenti “**Strategjia për Reformën e Raportimit Financiar të Sektorit Publik në Republikën e Shqipërisë**”, i miratuar nga ana e Komiteti Kombëtar Drejtues të Projektit, (Steering Committee)⁸, “Zhvillimi i Kontabilitetit në Sektorin Publik”, me datën 14.10.2019, Komitet i ngritur nga Ministri përgjegjës për financat.

Bazuar në përcaktimet e Kreut 10, të këtij dokumenti strategjik, përgatitja dhe puna për adoptimin e bërjhen efektive të standardeve janë parashikuar të shtrira gjatë gjithë **periudhës 2019-2027**, sipas disa nënfazave:

- 10. faza e parë: përgatitja për adoptimin e standardeve IPSAS (2019-2027);
- 10.1.1. faza e dytë e proceseve të adoptimit të IPSAS (2021-2025);
- 10.1.2. faza e tretë e proceseve të adoptimit të IPSAS (2022-2025);
- 10.1.3. faza e katërt e proceseve të adoptimit të IPSAS (2024-2026);
- 10.1.4. faza e pestë: konsolidimi (2025-2027).

Sipas dokumentit të Strategjisë së referuar më lartë, ekzistojnë tre alternativa/ opsione për përzgjedhje:

- **Opsioni 1:** Miratimi i plotë dhe i drejtpërdrejtë i IPSAS:
Miratohet një legjislacion i ri që i referohet drejtpërdrejt të gjithë IPSAS-ve për miratim për të gjithë njësitë e sektorit publik.
- **Opsioni 2:** Miratimi i plotë, por indirekt i IPSAS:
Të gjitha IPSAS miratohen nëpërmjet GAAP në sektorin publik, të cilët janë plotësisht në përputhje me IPSAS.
- **Opsioni 3: Miratimi i pjesshëm i IPSAS-ve.**
modifikohet GAAP-i për sektorin publik kombëtar dhe/ose lëshimi i GAAP-i të ri për sektorin publik, që është në përputhje me pjesët e zgjedhura të IPSAS-ve të zgjedhura.

Referuar projektit të reformës së PFM-së, nga MFE është propozuar **miratimi i pjesshëm të IPSAS-ve (sipas opsionit nr. 3)** në të gjithë institucionet e Shqipërisë pasi njeh dhe zbut rreziqet që lidhen me reformat e PFM-së.

- d. Mbi bazën e këtij kuadri dhe plani veprimi, nga MFE ka përfunduar **procesi i pilotimit për 7 institucione**, në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare bazuar në IPSAS, më konkretisht nga: *MFE, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Kulturës, ARRSH, AKSHI si dhe Bashkia Tiranë.*
- e. Është realizuar procesi për **zhvillimet e reja të nevojshme funksionale të sistemit AGFIS / SIFQ**, me qëllim mundësimin e përmbushjes së kërkesave të metodologjisë të re, duke përfunduar rishikimin e proceseve të punës për kontabilitetin dhe raportimin financiar, vlerësimin mbi funksionalitetin e sistemit SIFQ, (të tilla si evidentimi i atyre transaksioneve financiare të cilat kryhen aktualisht nga SIFQ,

⁸ -Komiteti Kombëtar Drejtues i Projektit “Zhvillimi i Kontabilitetit në Sektorin Publik”, është ngritur me udhën e Ministrat të Financave dhe Ekonomisë nr. 219, datë 31.7.2018, i ndryshur, me përbërje zyrtarë dhe funksionarë të MFE, DPTH, KLSH-së, KKK, IKM, INSTAT, IEKA, FE/UT, FEA/UBT, etj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

transaksionet që kanë nevojë për disa shtesa në sistem si dhe transaksionet që kanë nevojë për ndryshime të avancuara në sistem).

- f. Nëpërmjet kompanisë konsulente të kontraktuar nga Banka Botërore është punuar një **raport në lidhje me njohjen fillestare, matjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve jofinanciare, një format të regjistrimit të asetëve si dhe disa procedura dhe instrumenta në lidhje me trajtimin kotnabël të provigjioneve dhe detyrimeve të kushtëzuara për MFE**, si një shembull që mund të përdoret dhe nga institucionet e tjera të sektorit publik.

Referuar sistemit të dokumentacionit të vënë në dispozicion të audituesve të autorizuar të KLSH-së, konstatohet se nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë **ende nuk është filluar e dhe konsiderohet në vonesë, zbatimi i fazës të dytë të reformës në fushën e kontabilitetit publik që bazuar në Planin e Veprimit shtrihet gjatë periudhës kohore 2021-2025, pavarësisht përpjekjeve të ndërmarra nga ana e institucionit të MFE. Kjo fazë konsiston në zbatimin e metodologjisë së re kontabël dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të qeverisë qendrore**, bazuar në kërkesat e Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit Publik.

Projekti për fazën e dytë të zbatimit të metodologjisë së re të kontabilitetit në sektorin publik, do të përfshijë:

- Realizimin e zhvillimeve dhe përmirësimeve të sistemit SIFQ** bazuar në nevojat e identifikuar të përgatitura gjatë fazës të parë të projektit, dhe do të mundësojnë përshtatjen e sistemit me metodologjinë e re kontabël, përmirësimin e konfigurimeve ekzistuese që sigurojnë rregjistrimet kontabël dhe raportimin financiar si dhe automatizimin e proceseve të hartimit të pasqyrave financiare të konsoliduara të qeverisë.
- Realizimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore** për të mundësuar heqjen e pengesave për fillimin e zbatimit të metodologjisë të re kontabël dhe përgatitjen e pasqyrave financiare bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik. Aktivitetet e këtij komponenti do të përfshijnë përgatitjen dhe mbështetjen teknike për hartimin e amendimeve ligjore si dhe të akteve nënligjore të nevojshme në bazë të metodologjisë së hartuar.
- Ofrimi i ekspertizës të nevojshme për çeljen e llogarive të reja kontabël në përputhje me metodologjinë e re bazuar në IPSAS, në kryerjen e vlerësimeve dhe të çmuarjeve kontabël si dhe në realizimin e njohjeve dhe të matjeve kontabël**, në përputhje me kërkesat e këtyre standardeve.
- Vijimi i përgatitjes teorike të kontabilistëve të sektorit publik mbi Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik.**

Produktet.

MFE-ja, gradualisht do të përafrojë pasqyrat financiare vjetore me Standardet Ndërkombëtare nëpërmjet:

- *Produkti 5.4.1:* Një plani Zbatimi për kuadrin rregullator në përputhje me SNKSP;
- *Produkti 5.4.2:* Përmirësimi i kuadrin rregullator të kontabilitetit;

Aspektet e kësaj reforme përfshijnë ndër të tjera diagnostikimin e kuadrin ligjor dhe institucional të kontabilitetit të sektorit publik dhe pilotimin e udhëzimeve të reja të kontabilitetit të bazuara në SNKSP në institucione të zgjedhura të qeverisjes qendrore dhe vendore.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

- *Produkti 5.4.3: Zgjerimi i SIFQ për të regjistruar të dhëna të kontabilitetit mbi bazë të drejtash e detyrimesh të konstatuara.*

Nga shqyrtimi i raportit “*Assessment report about the quality, completeness, methodology and accuracy of the Property, Plant & Equipmen*”⁹, del se, në pikën nr.3.2 “Sistemet e kontabilitetit në fuqi”, është nënvizuar se,

“Sipas informacionit të dhënë, Qeveria e Shqipërisë përdor si kryesor AGFIS si sistem të kontabilitetit. Megjithatë, **jo të gjitha Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme (NJQP) raportojnë nën këtë të fundit**. Ne kemi evidentuar raste ku NJQP-të përdorin sisteme të tjera të kontabilitetit si Alpha Web ose programe të tjera lokale. Disa NJQP nuk përdorin fare softuer, duke adresuar nevojat e raportimit kryesisht përmes Excel-it. Në varësi të softuerit në përdorim, disa NJQP ruajnë informacionin për PPE në AGFIS, disa në softuerin lokal dhe të tjerët në skedarët excel.”

- *Produkti 5.4.4: Zbatimi i planit për zhvillimin e kapaciteteve.*

Janë ndërmarrë masat për zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive profesionale në fushën e kontabilitetit për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe për financierët e sektorit publik. MFE në bashkëpunim me kompaninë konsulente ndërkombëtare CIPFA (“*The Chartered Institute of Public Finance and Accountancy*”), ka realizuar aktivitetin e trajnimit dhe testimit të trajnerëve për kontabilitetin dhe raportimin financiar në sektorin publik bazuar në standardet IPSAS, ku kanë marrë pjesë 28 pjesëmarrës të përzgjedhur nga MFE si dhe nga palët e interesit; është realizuar pilotimi për herë të parë i trajnimit mbi kontabilitetin në sektorin publik dhe raportimit financiar bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS), ku janë trajnuar 100 punonjës të angazhuar në fushën e kontabilitetit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe deri në dhjetor të vitit 2022 ky proces është vijuar me trajnimin edhe të 400 punonjësve të tjerë të sektorit publik, kryesisht nga njësitë qendrore dhe vendore të qarkut të Tiranës.

Komponenti 5.5: Përmirësimi i menaxhimit të aktiveve

Objektivi

Përgatitja dhe publikimi i regjistrit të plotë të aktiveve në sektorin publik, bazuar në rregullore të përmirësuara për vlerësimin dhe inventarizimin e këtyre aktiveve.

Konteksti sipas SMPF:

DPTH bën një bilanc me vlerat e aktiveve jofinanciare, por regjistri i aktiveve është i paplotë.

Rregullat ekzistuese të kontabilitetit konsiderohen të papërshtatshme dhe vendimmarrësit në MFE nuk e konsiderojnë të dobishëm këtë informacion për qëllimet e tyre.

Produktet

Kjo punë do të vijojë paralelisht me reformën për kontabilitetin me bazë të drejtash e detyrimesh të konstatuara, për përgatitjen e metodologjisë, formateve dhe udhëzuesve për regjistrimin e plotë të aktiveve, për të gjitha institucionet.

⁹ - Buimi: PwC, Assessment report about the quality, completeness, methodology and accuracy of the Property, Plant & Equipmen”, Dhjetor 2022.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

- **Produkti 5.5.1:** Përgatitja e metodologjisë dhe udhëzimeve për inventarin e plotë të aktiveve publike për qeverinë qendrore (QQ);
- **Produkti 5.5.2:** Regjistrimi i inventarit të plotë të aktiveve publike në SIFQ nga IB që kanë akses të drejtpërdrejtë në sistem;
- **Produkti 5.5.3:** Regjistrimi i plotë i aktiveve publike në eksel (për IB-të që nuk kanë akses të drejtpërdrejtë në SIFQ) .

⊕ Output-et që gjenerohen nga SIFQ:

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kërkuar informacion në lidhje me disa aspekte të përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, (individuale dhe të konsoliduara), ku u administruan këto qëndrime të MFE në lidhje me çështjet e më poshtme:

- *Kërkesës së grupit të audituesve të autorizuar të KLSH-së, nëse janë hartuar MFE pasqyra financiare të konsoliduara për vitin 2021 dhe 2022, Drejtorja e Përgjithshme e Thesarit u është përgjigjur : “Jo, sepse mungon metodologjia e konsolidimit të pasqyrave financiare”.*
- *Perveç shkresave të tërheqjes së vëmendjes, a ka kërkuar DPTH të NPA marrjen e masave disiplinore e administrative në funksion të këtij procesi? “Masat disiplinore administrative të dhëna në funksion të këtij procesi nuk janë kompetencë e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit.”*
- *Cili është përpunimi informatik që ju kryeni për pasqyrat financiare fizike dhe ato të ngarkuara në sistem? “Nuk kryhet përpunim informatik. Nuk është e përcaktuar në ligj.”*
- *Çfarë outputi gjeneroni në fund të procesit nga sistemi për pasqyrat financiare? “Nuk gjenerojmë output. Në SIFQ ekzistojnë disa raporte të dizenuara me balancat e një pjese të llogarive kontabël, por nuk janë të konsoliduara (për mungesë metodologjije konsolidimi) dhe të dhënat e pasqyrave financiare të institucioneve buxhetore, të cilat nuk janë të certifikuara nga një auditues ligjor”.*
- *A mund të kemi një pasqyrë financiare në total për qeverinë dhe të ndarë për qeveritë qendrore, lokale dhe fondet speciale? “Jo, përse kohë të dhënat e gjeneruara nga SIFQ nuk janë të sakta për arsyet e cituara më lartë”.*
- *A dërgoni tek Ministri i MFE një përmbledhëse (memo) për rezultatet e pasqyrave financiare? “Jo, sepse të dhënat e gjeneruara nga SIFQ nuk janë të sakta për arsyet e cituara më lartë”.*

Në lidhje me regjistrimin e inventarit të plotë të aktiveve në SIFQ, u auditua procesi i migrimit të të dhënave nga institucionet buxhetore me akses të drejtpërdrejtë në SIFQ, nga ku del se:

Nga auditimi del se, nga 15 institucione me akses të drejtpërdrejtë në SIFQ deri në fund të vitit 2022, vetëm 11 prej tyre kanë migruar asetet e tyre fikse në SIFQ, ndërkohë që, sipas tekstit të Strategjisë së MFP 2019-2022, aktivet publike të gjashtë institucioneve buxhetore janë hedhur në SIFQ që në vitin 2019 dhe se “ka përfunduar transferimi i aktiveve publike për qeverinë vendore”.

Deri në fund të v.2022 kanë migruar të dhënat e aktiveve në SIFQ këto institucione:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjensia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Kulturës, Bashkia Tiranë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, AKSHI.

Konstatohet se janë 4 nstitucione shtetërore, të cilat nuk i kanë migruar vlerat e asetëve fikse në SIFQ, e më konkretisht:

Ministria e Shendetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë dhe Kryeministria.

MFE u është drejtuar disa herë këtyre institucioneve me shkresa zyrtare për përgatitjen e informacionit të aktiveve të tyre fikse, por këta informacione nuk janë dërguar në MFE, kjo për shkak të mungesës së saktësisë së gjendjeve të inventarit nga ana e këtyre institucioneve shtetërore, apo mungesës së të dhënave edhe si pasojë e procesit të bashkimit të disa institucioneve.

Në lidhje me zbatimin e objektivit strategjik nr. 5.5, plani i rishikuar i veprimit ka parashikuar sa vijon:

Drejtoria e Harmonizimit të MFKK:

Output 5.4.2:

a) Përfundimi i akteve ligjore dhe Standardeve të kontabilitetit në përputhje me IPSAS dhe Planin strategjik të veprimit të vendit (T4 2020- T4 2022).

Output 5.4.4:

Zbatimi i një plani për zhvillimin e kapaciteteve.

a. Plani i zhvillimit të kapaciteteve (T1 2019 -T4 2022)

b. Zhvillimi i trajnimeve të personelit (T4 2020- T4 2022).

Output 5.5.1: Përgatitja e Metodologjise dhe Udhëzuesve për inventarizimin e plotë të asetëve publike në institucionet e Qeverisjes Qendrore (CG)

a. Inventarizimi i pasurive, zbatuar në të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore, bazuar mbi metodologjinë e miratuar (T4 2020- T4 2022)

b. Jane përgatitur e perditesuar udhëzimet për njohjen dhe vlerësimin e asetëve (T1 2020- T4 2020)

c. Ka përfunduar vlerësimi i pasurive/ asetëve (T1 2020 -T4 2022)

d. Janë përgatitur politikat e Amortizimit dhe Zhvlerësimit (në përputhje me Strategjinë për zbatimin e Standardeve të kontabilitetit sipas komponentit 5.4. (T1 2021 - T4 2021).

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit:

Output 5.4.3/a: AGFIS përmirësuar për të regjistruar të dhënat e kontabilitetit (*accrual accounting data*) Q4 2020- Q4 2022.

Output 5.5.2: Inventari i plotë i pasurive publike është regjistruar në AGFIS nga ata Institucione Buxhetore që kanë qasje të drejtpërdrejtë në këtë sistem.

a) Migrimi i të dhënave në AGFIS Thesari GD i përfunduar (Q1 2019 -Q4 2022)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

b) Numri i personelit të trajnuar mbi menaxhimin e pasurisë (Q1 2019 -Q4 2022)

Output 5.5.3: Inventari i plotë i pasurive publike është regjistruar në excels (për IB të cilat nuk kanë qasje të drejtpërdrejtë në AGFIS)

a) Bilancet e asetëve të evaluara janë gati për t'u regjistruar në Modulin *General Ledger* të AGFIS, (Q1 2022 -Q4 2022).

Nga shqyrtimi i raportit të hartuar në Dhjetor 2022 nga PwC, "Assessment report about the quality, completeness, methodology and accuracy of the Property, Plant & Equipmen",

4.1.1 Rrjedha e informacionit

Nuk ka një rrjedhë të qartë dhe të mirë përcaktuar informacioni, që do të mundësonte të dhëna të përshtatshme kapjen dhe regjistrimin nga Departamenti i Financës në një proces të nevojshëm për kontabilizimin e PPE (Prona, Impiantet dhe Pajisjet). Departamentet brenda NJQP-ve që janë përgjegjëse për llogaridhënien e PPE-ve nuk e bëjnë këtë komunikoni gjithmonë me Departamentin e Financës. Mungon komunikimi i duhur ndërmjet departamenteve në të gjithë procesin që nga prokurimi, blerja, njohja, matja dhe mosnjohja e PPE. Kjo mungesë informacioni rrit rrezikun e pasaktësisë, llogaridhënies dhe të duhurit mirëmbajtjen e PPE-ve.

4.1.3 Procedurat e parashikuara në Udhëzimin nr. 30 Udhëzimi synon të sigurojë një udhërrëfyes për të përcaktuar, dokumentuar, ruajtur, qarkullimin dhe disponimin e asetëve të administruara nga subjektet publike. Megjithatë, ka disa boshllëqe që duhen adresuar.

- Udhëzimi përpiqet të mbulojë zëra të ndryshëm të asetëve duke përfshirë të prekshme dhe aktivet jomateriale, aktivet financiare, inventarin dhe mjetet monetare, por nuk jep qartë dispozitat për çdo artikull.

- Nuk ka ndonjë metodologji të qartë për regjistrin e pasurive fikse.

- Nuk ka ndonjë model standard për regjistrin e pasurive fikse në mënyrë që të gjitha subjektet përdorni të njëjtin shabllon.

4.3.1 Sisteme të ndryshme të përdorura për Regjistrimin e aktiveve. MFE përdor (2) dy sisteme të ndryshme për mirëmbajtjen e asetëve fikse (AGFIS dhe Alpha Web) si dhe një skedar excel. Këto sisteme nuk janë të integruara dhe nuk ka asnjë procedurë për pajtim me njëri-tjetrin. Çdo rakordim duhet të kryhet me punë manuale pa asnjë zyrtar dokumentacioni që mbështet procesin.

Konkretisht:

- AGFIS është në gjendje të mbajë regjistrin e pasurive fikse. Megjithatë, disa nga NJQP-të nuk e bëjnë këtë mbështeten në të dhënat e gjeneruara nga AGFIS për llogaritjen e amortizimit. Ata përdorin sisteme të tjera ose excel.

- Në Alpha Web informacioni përshtatet me libër për çdo individ/punonjës dhe ai libër përfshin asetet që janë nën përgjegjësinë e secilit person.

- Për llogaritjen e amortizimit përdoret skedari Excel. Të gjitha këto sisteme nuk kontribuojnë në mirëmbajtjen e duhur të asetëve fikse. Në përkundrazi, ato krijojnë më shumë konfuzion dhe rrisin rrezikun e gabimeve dhe joefikasitetit.

Konstatim nr.4:

Nga shqyrtimi i zbatimit të kërkesave të Planit të Veprimit, që shoqëron Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike 2019-2022, miratuar me VKM nr. 824, datë 18.12.2019, rezulton se progresi i bërë në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar është i moderuar, por që, nuk është i sinkronizuar dhe i përputhur me angazhimet dhe afatet e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E FINANCIVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

vendosura nga Këshilli i Ministrave në dokumentin e Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike 2019-2022, lidhur me implementimin e fazave të zbatimit të Kontabilitetit të Sektorit Publik mbi bazën e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (*IPSAS-International Public Sector Accounting Standards*), pasi:

- ✓ Nuk janë realizuar deri në datën e mbajtjes së këtij Raporti, ndryshimet e nevojshme ligjore për të mundësuar heqjen e pengesave për fillimin e zbatimit të metodologjisë së re kontabël dhe përgatitjen e pasqyrave financiare bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik.
- ✓ Ndonëse Qeveria synon që gradualisht të përshtatë, pjesërisht ose plotësisht, “Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik” (SNKSP), duke mbajtur parasysh kontekstin e Shqipërisë, nga analiza e dokumentacionit të vënë në dispozicion të audituesve të autorizuar të KLSH rezulton se nuk është specifikuar një datë indikative kur mund të përfundojë ky proces.

Për periudhën objekt auditimi (1.1.2021-31.12.2022), nga na e MFE-së:

- *Është hartuar Metodologjia për Vlerësimin dhe Rivlerësimin e Aktiveve Afatgjata Materiale e Jomateriale të Sektorit Publik (asetet), e cila shërben si bazë për përgatitjen e inventarit të asetëve si për qeverisjen e përgjithshme, ashtu edhe për qeverisjen vendore, por edhe për përgatitjen e saktë të pasqyrave të konsoliduara financiare të qeverisë, por ky dokument nuk është miratuar përfundimisht, pasi nuk janë hartuar edhe aktet ligjore sipas Strategjisë, (Aktiviteti 5.4.2, me afat realizimi T4/2022);*
- *Nuk është hartuar regjistri i konsoliduar i aktiveve të sektorit publik, nuk është zbatuar vlerësimi dhe inventarizimi i asetëve në të gjithë njësitë e qeverisjes qendrore sipas metodologjisë së aprovuar (Aktiviteti 5.5.1, pikat “a” dhe “c”, me afat realizimi T4/2022);*
- *Nuk ka gjetur zbatim regjistrimi i inventarit të plotë të aktiveve publike dhe procesi i migrimit të të dhënave nga institucionet buxhetore me akses të drejtëpërdrejtë në SIFQ, (Aktiviteti 5.5.2, pika “a”, me afat realizimi T4/2022), pasi nga 15 institucione me akses të drejtëpërdrejtë në SIFQ deri në fund të vitit 2022, vetëm 11 prej tyre kanë migruar asetet e tyre fikse në SIFQ, ndërkohë që, sipas tekstit të Strategjisë së MFP 2019-2022, aktivet publike të gjashtë institucioneve buxhetore janë hedhur në SIFQ që në vitin 2019 dhe se “ka përfunduar transferimi i aktiveve publike për qeverinë vendore”.*

Sa më sipër, nuk janë përmbushur të gjithë detyrimet e Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022 dhe Planit të Veprimit, miratuar me VKM nr. 824 , datë 18.12.2019.

II. Mungesa e pasqyrave financiare të konsoliduara (përmbledhëse) për Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme të Sektorit Publik.

Nga auditimi financiar mbi bazë sistemi, i kryer në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si dhe në disa njësi të tjera shpenzuese të qeverisjes qendrore, vendore, njësi të zbatimit të projekteve dhe marrëveshjeve dhe kryqëzimit të të dhënave dhe informacioneve me disa njësi periferike apo të varësisë së tyre, kuadri nënligjor bazë mbi përgatitjen, paraqitjen dhe depozitimin për çdo vit kalendarik të mbyllur më 31 dhjetor të Pasqyrave Financiare të Llogaridhënies Vjetore, ka përcaktuar këto afate të detyrueshme për zbatim:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

- Pasqyrat financiare në nivel të Njesisë Ekonomike, hartohen brenda **31 marsit të vitit pasardhës**; (në referim të paragrafit nr.117-119 dhe 121, të UMF nr.8, datë 9.3.2018, i cili nuk ka ndryshim mbi këto afate dhe përcaktime):

117.Njësiti e qeverisjes qendrore janë të detyruara të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore individuale të ushtrimit të mbyllur **brenda muajit Mars të vitit pasardhës**. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksionit dhe pas marrjes së konfirmimit nga kjo e fundit, një kopje dërgohet në ministrinë apo institucionin qendror përkatës sipas varësisë, dhe një kopje tjetër në zyrën e statistikave të rrethit;

118. Njësiti e qeverisjes vendore janë të detyruar të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore të ushtrimit të mbyllur **brenda muajit Mars të vitit pasardhës**. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksioni, një kopje në Këshillin e Qarkut të Juridiksionit dhe një kopje në zyrën e statistikave të rrethit;

119.Njësiti e menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj detyrohen të depozitojnë pasqyrat financiare të vitit ushtrimor të mbyllur **brenda muajit Mars të vitit pasardhës**, duke dërguar një kopje pranë ministrisë apo institucionit publik që menaxhon projektin, një kopje pranë donatorit/rëve përkatës dhe një kopje e dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;

121.Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, të cilat nuk kanë në varësi institucione apo njësi shpenzuese me kontabilitet më vete, **brenda muajit Mars të vitit pasardhës** depozitojnë pasqyrat financiare të tyre, duke dërguar një kopje në degën e thesarit dhe pas konfirmimit nga kjo e fundit, një kopje e dërgojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;

- Pasqyrat Financiare të Konsoliduara në nivel të grupit (Ministri dhe institucione qendrore) hartohen brenda **30 prillit të vitit pasardhës dhe depozitohen në DPTH të MFE** (në referim të paragrafit nr.23, të UMF nr.5, datë 21.2.2022);

-Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore hartojnë përmbledhësen e konsoliduar për pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e flukseve monetare dhe shënimet shpjeguese për vitin ushtrimor të sapo mbyllur, për të gjitha institucionet apo njësitë e varësisë së tyre, **brenda muajit Prill të vitit pasardhës dhe e depozitojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë**. Pasqyra e konsoliduar vjetore e pozicionit financiar (Bilanci) kontrollon me pasqyrën përmbledhëse të pozicionit financiar të gjeneruar nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë dhe në rast mosrakovitimi i kthehet njësisë publike qendrore (organit qendror të saj) për azhurm në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë sipas informacionit kontabël të të drejtave të konstatuara që disponon njësi qendrore.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

-pasqyrat financiare të konsoliduara në nivel të grupit (Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore) hartohen brenda **30 prillit të vitit pasardhës dhe e depozitojnë në DPTH të MFE** (në referim të paragrafit nr.24, të UMF nr 5, datë 21.2.2022);

-MFE-ja nxjerr dhe dorëzon raportin e konsoliduar të buxhetit për sektorin e qeverisjes së përgjithshme për miratim pranë Këshillit të Ministrave brenda **fundit të majit të vitit pasardhës**.

Paragrafi nr. 20, i UMF nr.5, datë 21.2.2022 ka parashikuar që: Në Kapitullin IV "Përbërja, përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara", (të UMFE nr. 8, datë 9.3.2018), paragrafi 101 ndryshon si më poshtë vijon:

“Konsolidimi i Pasqyrave Financiare Vjetore deri në nivelin e Qeverisjes së Përgjithshme kryhet nëpërmjet grupimit të informacionit (*duke bërë eliminimet dhe mënjnauar dublimet*) dhe duke kaluar nivelet e mëposhtme:

d) Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivel Njësie Publike Qendrore, duke përfshirë informacionin financiar të organit qendror të njësisë (*aparati*), **të gjitha njësitë e varësisë/njësi shpenzuese dhe pasqyrat financiare të kompanive nën kontroll ose pronësi** të njësisë publike qendrore;

e) Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivel Njësie Publike të Vetëqeverisjes Vendore, duke përfshirë informacionin financiar të organit qendror të njësisë (*aparati*), **të gjitha njësitë e varësisë/njësi shpenzuese dhe pasqyrat financiare të kompanive nën kontroll ose pronësi** të njësisë publike vendore;

f) Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivel Qeverisje Qendrore përfshirë **të gjitha pasqyrat financiare të konsoliduara të njësive publike qendrore (ministri, institucione të tjera qendrore, fondet speciale të krijuara prej tyre, njësitë e menaxhimit dhe zbatimit të projekteve)**, informacionin e Ilogarisë qendrore të qeverisë, të Ilogarive të tjera speciale si dhe informacionin për borxhin qeveritar publik.

g) Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivel Qeverisje Vendore, përfshirë të **gjitha pasqyrat financiare të konsoliduara të njësive publike të vetëqeverisjes vendore (bashkitë dhe këshillat e qarqeve)**.

h) Konsolidim i pasqyrave financiare në nivel Qeverisje të Përgjithshme, përfshirë pasqyrat e konsoliduara sipas pikës c dhe d.”

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë pasqyrat financiare të një njësie ekonomike në të cilat paraqiten aktivet, detyrimet, aktivet neto/kapitali neto, të ardhurat, shpenzimet dhe flukset monetare të njësisë kontrolluese dhe të njësive të kontrolluara, si të ishin të një njësie të vetme ekonomike.

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion të gupit të auditimit të KLSH nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit e MFE, del se,

- Numri total i institucioneve të qeverisjes së përgjithshme, përfshirë dhe disa prej institucioneve extrabuxhetore për vitin 2021, është **1016 njësi/institucione publike**, nga të cilat 961 institucione buxhetore dhe 85 ekstrabuxhetore,
- Numri total i institucioneve të qeverisjes së përgjithshme, përfshirë dhe disa prej institucioneve extrabuxhetore për vitin 2022, është **1046 njësi / institucione publike**.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

- Në tabelën e mëposhtme paraqiten institucionet buxhetore, ekstrabuxhetore dhe Njësitë e Zbatimit të Projekteve që operojnë me Degët e Thesarit, të ndara respektivisht sipas degëve të thesarit.

Më hollësisht, analizuar sips degëve të thesarit, paraqitet kjo situatë e shpërndarjes së institucioneve shpenzuese buxhetore dhe ekstrabuxhetore:

Tabela nr. 1 , Institucionet Buxhetore dhe Ekstrabuxhetore në SIFQ për 2021.

Nr.	TDO	Emertimi i Deges se Thesarit	Nr Institucioneve		Njësi Ekstrabuxhetore
			Total	Institucione Buxhetore	
1	3535	Tirane	383	351	32
2	0202	Berat	34	33	1
3	0217	Kucove	8	5	3
4	0232	Skrapar	12	11	1
5	0603	Bulqize	6	5	1
6	0606	Diber	23	23	0
7	0625	Mat	11	11	0
8	0707	Durres	51	46	5
9	0716	Kruje	12	11	1
10	0808	Elbasan	43	37	6
11	0810	Gramsh	6	5	1
12	0821	Librazhd	7	7	0
13	0827	Peqin	7	6	1
14	0909	Fier	44	43	1
15	0922	Lushnje	19	16	3
16	0924	Mallakaster	7	6	1
17	1111	Gjirokaster	31	29	2
18	1128	Permet	12	10	2
19	1134	Tepelene	8	8	0
20	1505	Devoll	6	6	0
21	1514	Kolonje	8	6	2
22	1515	Korce	50	45	5
23	1529	Pogradec	14	14	0
24	1812	Has	6	5	1
25	1818	Kukes	20	20	0
26	1836	Tropoje	10	9	1
27	2019	Lac	8	7	1
28	2020	Lezhe	26	26	0
29	2026	Mirdite	9	7	2
30	3323	Malsi e Madhe	5	5	0
31	3330	Puke	9	8	1
32	3333	Shkoder	53	50	3
33	3513	Kavaje	17	15	2
34	3704	Delvine	7	6	1
35	3731	Sarande	25	23	2
36	3737	Vlore	49	46	3
Total			1046	961	85

Burimi:MFE, DPTH, DOTH



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

Tabela nr.2. Institucionet Buxhetore dhe Ekstrabuxhetore në SIFQ për 2022.

Nr.	TDO	Emertimi i Deges se Thesarit	Nr Institucioneve Total	Institucione Buxhetore	Njësi Ekstrabuxhetore
1	3535	Tirane	370	338	32
2	0202	Berat	34	33	1
3	0217	Kucove	12	9	3
4	0232	Skrapar	12	11	1
5	0603	Bulqize	6	5	1
6	0606	Diber	24	24	0
7	0625	Mat	11	11	0
8	0707	Durres	29	24	5
9	0716	Kruje	14	13	1
10	0808	Elbasan	43	37	6
11	0810	Gramsh	6	5	1
12	0821	Librazhd	7	7	0
13	0827	Peqin	5	4	1
14	0909	Fier	50	49	1
15	0922	Lushnje	19	16	3
16	0924	Mallakaster	8	7	1
17	1111	Gjirokaster	30	28	2
18	1128	Permet	12	10	2
19	1134	Tepelene	10	10	0
20	1505	Devoll	7	7	0
21	1514	Kolonje	8	6	2
22	1515	Korce	54	49	5
23	1529	Pogradec	14	14	0
24	1812	Has	6	5	1
25	1818	Kukes	21	21	0
26	1836	Tropoje	10	9	1
27	2019	Lac	8	7	1
28	2020	Lezhe	28	28	0
29	2026	Mirdite	8	6	2
30	3323	Malsi e Madh	6	6	0
31	3330	Puke	10	9	1
32	3333	Shkoder	54	51	3
33	3513	Kavaje	17	15	2
34	3704	Delvine	7	6	1
35	3731	Sarande	25	23	2
36	3737	Vlore	55	52	3
		Total	1040	955	85

Burimi:MFE, DPTH, DOTH

□ Depozitimi i Pasqyrave Financiare Individuale Vjetore (PFIV) nga ana e institucioneve shtetërore përgjegjëse:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, konstatohet se:

- **Për vitin 2021**, degët e thesarit kanë rregjistruar në SIFQ të dhënat e pasqyrave financiare për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, përfshirë dhe disa prej institucioneve ekstrabuxhetore; pra, gjithsej të dhënat për 1016 njësi.
- **Për vitin 2022**, degët e thesarit kanë rregjistruar në SIFQ të dhënat e pasqyrave financiare për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, përfshirë dhe disa prej institucioneve ekstrabuxhetore; pra, gjithsej të dhënat për 1046 njësi.

Por pavarësisht këtij fakti, rezulton një numër jo i vogël i institucioneve buxhetore të analizuar, që kanë shfaqur probleme të shkeljes së afateve në lidhje me ngarkimin në SIFQ të pasqyrave individuale dhe dorëzimin e pasqyrave fizike individuale, e më konkretisht,

- ✓ **Për vitin 2021, evidentohet se 28 njësi shpenzuese / institucione buxhetore, nga 1016 institucione të qeverisjes së përgjithshme gjithsej (të qeverisjes qendrore, të vetëqeverisjes vendore, të fondeve speciale, të zbatimit të projekteve dhe marrëveshjeve, etj., të regjistruara nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit), ose afro 3 % e tyre, nuk kanë dorëzuar ose kanë dorëzuar me vonesë pasqyrat financiare individuale të institucioneve buxhetore pranë Degëts së Thesarit, me**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

tejkalim dhe shkelje të afateve ligjor të miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, sa vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet e dala në zbatim të tij.

Tabela nr.3, Shkresat e dërguara institucioneve nga ana e DPTH për terheqje vemendje për mosdepozitim të Pasqyrave Financiare 2021

Nr.	Institucionit	Shkrese terheqje vemendje për mosdepozitim të Pasqyrave Financiare 2021, nga MFE
1.	Bashkia Pustec	Shkrese nr. 6524/1, date 13.04.2022
2.	Ujesjelles Kanalizime Korçe	Shkrese nr. 6524/1, date 13.04.2022
3.	Kombinati I Sheqerit sha Korçe	Shkrese nr. 6524/1, date 13.04.2022
4.	Ujesjelles Kanalizime sha Divjake	Shkrese nr. 6546/1, date 13.04.2022
5.	Bashkia Tropoje	Shkrese nr. 6278/1 date 13.04.2022
6.	Ujesjelles Kanalizime sha Tropoje	Shkrese nr. 6278/1 date 13.04.2022
7.	Ujesjelles Kanalizime sha Permet	Shkrese nr. 6301/1 date 13.04.2022
8.	Ujesjelles Kanalizime sha Patos	Shkrese nr. 6552/1 date 13.04.2022
9.	Klubi Futbollit Apolonia	Shkrese nr. 6552/1 date 13.04.2022
10.	Ujesjelles Kanalizime Kukes	Shkrese nr. 6123/1 date 21.04.2022
11.	Qendra Kulturore Tropoje	Shkrese nr. 6818/1 date 21.04.2022
12.	Bashkia Devoll	Shkrese nr. 6034/1 date 13.04.2022
13.	Bashkia Shkoder	Shkrese nr. 6883/1 date 20.04.2022
14.	Ujesjelles Kanalizime Shkoder	Shkrese nr. 6883/1 date 20.04.2022
15.	Bashkia Kavaje	Shkrese nr. 11060/1 date 10.06.2022
16.	Sherbimi Kombetar I Rinise	Shkrese nr. 11280 date 07.06.2022
17.	Fakulteti Mjeksise Veterinare	Shkrese nr. 11280 date 07.06.2022
18.	Qendra e Botimeve te Diaspores	Shkrese nr. 11280 date 07.06.2022
19.	Fondi Shqiptar I Zhvillimit te Diaspores	Shkrese nr. 11280 date 07.06.2022
20.	Federata Shqiptare e Motociklizmit	Shkrese nr. 11280/1 date 07.06.2022
21.	Federata Shqiptare e Radioamortizimit	Shkrese nr. 11280/1 date 07.06.2022
22.	Federata Shqiptare e Aeronautikes	Shkrese nr. 11280/1 date 07.06.2022
23.	Federata Shqiptare e Sportit Shkollor	Shkrese nr. 11280/1 date 07.06.2022
24.	Arkivi Qendror I Filmit	Shkrese nr. 11280/2 date 07.06.2022
25.	Drejtoria Rajonale e Trashegimise Kulturore	Shkrese nr. 11280/2 date 07.06.2022
26.	Ujesjelles Kanalizime Tirane	Shkrese nr. 11280/2 date 07.06.2022
27.	Qendra Sociale Streheza	Shkrese nr. 11280/2 date 07.06.2022
28.	Ujesjelles Kanalizime Durres	Shkrese nr. 8309/1 date 23.05.2022

* te gjithë institucionet buxhetore i kane dorezuar pasqyrat financiare dhe jane regjistruar ne SIFQ

*disa nga ekstrabuxhetoret nuk i kane dorezuar në SIFQ pasqyrat.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

	Ekstrabuxhetore padorëzuar akoma PF	
	Klubi Futbollit Apolonia	
	Ujesjelles Kanalizime Patos	
	Ujesjelles Kanalizime Divjake	

Burimi: DPTH, Drejtoria e Operacionev të Thesarit

Për mosdorëzim, ose depozitim jashtë afatit ligjor të pasqyrave financiare individuale, bazuar në informacionin e Degëve të Thesarit për vitin 2021, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, janë hartuar shkresat me tërheqjen e vëmendjes për 28 institucioneve buxhetore apo ekstrabuxhetore, që pas nënshkrimit nga ana e Nëpunësit të Parë Autorizues, u janë dërguar subjekteve buxhetore dhe Degëve të Thesarit.

- ✓ **Për vitin 2022, 41 njësi shpenzuese/ institucione buxhetore, nga 1046 institucione gjithsej (të qeverisjes së përgjithshme, të vetëqeverisjes vendore, të fondeve speciale, të zbatimit të projekteve dhe marrëveshjeve, etj., të regjistruara nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit), ose rreth 4 % e tyre, nuk kanë dorëzuar ose kanë dorëzuar me vonesë pasqyrat financiare individuale të institucioneve buxhetore pranë Degët të Thesarit, me tejkallim dhe shkelje të afateve ligjor të miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, sa vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet e dala në zbatim të tij.**

Tabela nr. 4, Shkresat e dërguara institucioneve nga ana e DPTH për tërheqje vëmendje për mosdepozitim të Pasqyrave Financiare 2022

Nr.	Institucioni	Statusi		Shkresë për informim të mosdepozitimit të pasqyrave financiare 2022, dërguar nga Degët e thesarit	Shkresë tërheqje vëmendje për mosdepozitim të Pasqyrave Financiare 2022, nga mFE
1	Bashkia Pustec	Me Vonese	1515	Shkresë nr. 400, date 04.04.2023	Shkresë nr. 7400/1, date 24.04.2023
2	Ujesjelles Kanalizime sha Patos	Me Vonese	909	Shkresë nr. 329 date 24.04.2023	ne protokoll
3	Bashkia Kavaje	Me Vonese	3513	Shkresë nr.150/1 date 04.04.2023	Shkresë nr. 7395, date 24.04.2023
4	Bashkia Kolonje	Me Vonese	1515	Shkresë nr.65 date 03.04.2023	ne protokoll
5	Bashkia Pustec	Me Vonese	1515	Shkresë nr.400 date 04.04.2023	ne protokoll
6	Keshilli I Qarkut Diber	Me Vonese	606	Shkresë nr. 231 date 04.04.2023	Shkresë nr. 7394, date 24.04.2023
7	Klubi Sportiv Gramozi	Me Vonese	1514	Shkresë nr. 65 date 03.04.2023	Shkresë nr. 7392, date 24.04.2023
8	Ndermarrja Rruga Durres	Pa Dorezuar	707	Shkresë nr. 547 date 19.04.2023	ne protokoll
9	Ujesjelles Kanalizime sha Fushe Arrez	Me Vonese	3330	Shkresë nr. 121/2 date 03.04.2023	ne protokoll
10	Qendra e Zhvillimit Shkoder	Me Vonese	3333	Shkresë nr.764, date 04.04.2023	Shkresë nr. 7419, date 24.04.2023
11	Qendra Kulturore FS Noli	Me Vonese	1515	Shkresë nr. 65 date 03.04.2023	ne protokoll



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

12	Teatri Migjeni Shkoder	Me Vonese	3333	Shkrese nr. 764, date 04.04.2023	ne protokoll
13	Ujesjelles Kanalizime Durres	Pa Dorezuar	707	Shkrese nr. 547, date 19.04.2023	ne protokoll
14	Ujesjelles Kanalizime Elbasan	Me Vonese	808	Shkrese nr. 384 date 20.04.2023	ne protokoll
16	Ujesjelles Kanalizime Pustec	Me Vonese	1515	Shkrese nr.400, date 04.04.2023	Shkrese nr. 7400, date 24.04.2023
17	Ujesjelles Kanalizime Shkoder	Me Vonese	3333	Shkrese nr.764, date 04.04.2023	ne protokoll
18	Ujesjelles Kanalizime Vau I Dejes	Me Vonese	3333	Shkrese nr.764, date 04.04.2023	ne protokoll
19	Zyres Vendore Arsimore Gjirokaster-Libohove	Me Vonese	1111	Shkrese nr.764, date 04.04.2023	Shkrese nr. 7393, date 24.04.2023
20	Gjykata Kruje	Pa Dorezuar	716	Shkresa po ndjek rruge zyrtare	ne protokoll
21	IEVP Kruje	Pa Dorezuar	716	Shkresa po ndjek rruge zyrtare	ne protokoll
22	Ujesjelles Kanalizime Kruje	Me Vonese	716	Shkresa po ndjek rruge zyrtare	ne protokoll
23	Klubi Sportiv Kastrioti	Me Vonese	716	Shkresa po ndjek rruge zyrtare	ne protokoll
24	Klubi Sportiv Iliria	Me Vonese	716	Shkresa po ndjek rruge zyrtare	ne protokoll
25	Ujesjelles Kanalizime Vlore	Pa Dorezuar		Shkresa po ndjek rruge zyrtare	ne protokoll
26	Ujesjelles Kanalizime Selenice	Pa Dorezuar	3737	Shkresa po ndjek rruge zyrtare	ne protokoll
27	Ujesjelles Kanalizime Himare	Pa Dorezuar	3737	Shkresa po ndjek rruge zyrtare	ne protokoll
28	Klubi I Futbollit Oriku	Pa Dorezuar	3737	Shkresa po ndjek rruge zyrtare	ne protokoll
29	Sha Rajonale Ujesjelles Kanalizime Lushnje	Me Vonese	922	Shkresa po ndjek rruge zyrtare	ne protokoll
30	Ministria e Kultures	Pa Dorezuar	3535	Shkresa po ndjek rruge zyrtare	ne protokoll
31	Agjencia Kometare Profesionale	Pa Dorezuar		Shkresa po ndjek rruge zyrtare	ne protokoll
32	Agjencia e Mbrojtjes se Zonave te Mbrojtura	Pa Dorezuar		Shkresa po ndjek rruge zyrtare	ne protokoll
33	Agjencia e Mbrojtjes se Turizmit	Pa Dorezuar		Shkresa po ndjek rruge zyrtare	ne protokoll
34	Njesia e Zbatimit te Projektit Global Fund	Pa Dorezuar		Shkresa po ndjek rruge zyrtare	ne protokoll
35	Ministria e Mbrojtjes	Me Vonese			
36	Drejtoria Rajonale e Trashegimise Kulturore	Pa Dorezuar		Shkresa po ndjek rruge zyrtare	ne protokoll
37	Qendra Kombetare e Kultures per Femijet	Pa Dorezuar		Shkresa po ndjek rruge zyrtare	ne protokoll
38	Federata e Motociklizmit	Me Vonese			
39	Sherbimi Kombetar I Rinise	Me Vonese			
40	Federata Shqiptare e Radioamatorizmit	Me Vonese			
41	Federata Shqiptare e Aeronautikes	Me Vonese			

Burimi: DPTH, Drejtoria e Operacionev të Thesarit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

Për mosdorëzim, ose depozitim jashtë afatit ligjor të pasqyrave financiare për v.2022, bazuar në informacionet e përcjella nga ana e Degëve të Thesarit, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, janë hartuar shkresat me tërheqjen e vëmendjes për 41 institucioneve buxhetore apo ekstrabuxhetore, që pas nënshkrimit nga ana e Nëpunësit të Parë Autorizues, u janë dërguar subhekteve buxhetore dhe Degëve të Thesarit.

□ **Depozitimi i Pasqyrave Financiare Vjetore Përmbledhëse ose të Konsoliduara (PFK) nga ana e institucioneve shtetërore përgjegjëse:**

U auditua zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga Neni 62 "Përgatitja e llogarive vjetore të buxhetit", të ligjit nr. Nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", me ndryshimet; dhe i paragrafëve nr. 23, 24 dhe 25, të Udhëzimit Nr. 5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.8, datë 09.03.2018, "Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njesitë e Qeverisjes së Përgjithshme", lidhur me hartimin dhe depozitimin e pasqyra financiare të konsoliduara nga Njesitë e Qeverisjes së Përgjithshme për vitin 2021 dhe 2022, ku rezulton se:

Në zbatim të pikës nr.23, 24 dhe 25 të Udhëzimit Nr. 5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.8 datë 09.03.2018, "Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore", bazuar në të dhënat e DPTH, duhet të depozitohet fizikisht pasqyrat financiare të konsoliduara **për vitin 2021**, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, institucionet si më poshtë:

- **12 Ministrinë e Linjës administrative**
- **53 Institucionet Qendrore**
- **61 Bashkitë**
- **12 Këshillat e Qarkut.**

Kanë depozituar pasqyrat financiare të konsoliduara për këtë vit, 10 Ministri të linjës, 12 bashki, 9 këshilla të qarkut, dhe më konkretisht:

Tabela nr. 5, Depozitimi në MFE i PFK të vitit 2021

Nr. Rendor	Ministritë e Linjës/ Këshillat e Qarkut	Kodi SIFQ	Statusi	Shkresë sipas Protokollit te Institucionit
1	Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë	1006001	Depozituar	nr. 3699/1, date 09.05.2022
2	Ministria e Mbrojtjes	1017001	Depozituar	nr. 2258/1 date 29.04.2022
3	Ministria e Mjedisit	1026001	Depozituar	nr.5553, date 8.7.2022
4	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	1010001	depozituar	5819/2 date 29.04.2022
5	Ministria e Kultures	1012001	Nuk janë depozituar	
6	Ministria për Europen dhe Punët e Jashtme	1015001	Depozituar	nr. 7940/10 date 29.04.2022
7	Ministria e Shëndetsisë dhe Mireqenies Sociale	1013001	Depozituar	nr. 1731, date 14.04.2022
8	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	1011001	Depozituar	nr.2810/1, date 29.04.2022
9	Ministria e Brendshme	1016001	Depozituar	nr.2396/2, date 29.04.2022
10	Ministria e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural	1005001	Depozituar	nr. 1014/21, date



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

				20.04.2022
11	Ministria e Drejtësisë	1014001	Depozituar	nr. 1693/1 date 28.04.2022
Nr. Rendor				
1	Keshilli I Qarkut Tirane	2035001	Depozituar	nr. 290/1, date 28.04.2022
2	Keshilli I Qarkut Lezhe	2020001	Depozituar	nr. 366, date 27.06.2023
3	Keshilli I Qarkut Vlore	2037001	Depozituar	nr. 543/1, date 25.03.2022
4	Keshilli I Qarkut Berat	2042001	Depozituar	nr.381/1, date 29.04.2022
5	Keshilli I Qarkut Gjirokaster	2011001	Nuk jane depozituar	
6	Keshilli I Qarkut Korce	2015001	Depozituar	nr.256, date 06.05.2022
7	Keshilli I Qarkut Shkoder	2033001	Depozituar	nr. 181, date 15.04.2022
8	Keshilli I Qarkut Elbasan	2048001	Depozituar	nr.415, date 21.06.2022
9	Keshilli I Qarkut Fier	2048001	Depozituar	nr. 522, date 29.04.2022
10	Keshilli I Qarkut Durres	2047001	Depozituar	nr.461, date 28.04.2022
11	Keshilli I Qarkut Diber	2046001	Nuk jane depozituar	
12	Keshilli I Qarkut Kukes	2018001	Nuk jane depozituar	
Nr. Rendor				
	FSDKSH	003	Dorezuar	nr. 3218, date 26.04.2022
	ISSH	004	dorezuar	date 26.04.2023
Nr. Rendor				
1	Bashkia Shkoder		Dorezuar	nr. 6542 date 27.04.2022
2	Bashkia Bulqize		Dorezuar	nr. 3325, date 05.05.2022
3	Bashkia Perrenjas		Dorezuar	nr. 680, date 25.02.2022
4	Bashkia Fier		Dorezuar	nr.3599, date 29.04.2022
5	Bashkia Korce		Dorezuar	nr. 3900, date 29.04.2022
6	Bashkia Klos		Dorezuar	nr.838/1, date 29.04.2022
7	Bashkia Vau Dejes		Dorezuar	nr.2317, date 20.04.2022
8	Bashkia Finiq		Dorezuar	nr.765, date 25.03.2022
9	Bashkia Mat		Dorezuar	nr.2032, date 11.05.2022
10	Bashkia Vau i Dejes		Dorezuar	nr.2531, date 04.05.2022
11	Bashkia Durres		Dorezuar	nr. 5806, date 30.06.2022
12	Bashkia Patos		Dorezuar	nr. 1383, date 31.05.2022
1	Institucione te tjera Qendrore		pjeserisht dorezuar	

Shenim: Bashkai vau i Dejs ka depozituar PF dy here, ne dt 20.4.2022 dhe 4.5.2022

Burimi: DPTH, Drejtoria e Operacionev të Thesarit

Njësitë e menaxhimit të projekteve me financim të huaj për 2021 janë 621, por dorëzuar pasqyrat pranë degës së thesarit janë 10, siç janë listuar në tabelë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

Tabela nr. 6 , Njësitë e Zbatimit të Projektit për 2021 depozituar pranë degës së thesarit.

Inst.	Emertimi i Institucioneve Buxhetore	TDO
1005915	PIU Burimet ujore dhe te ujitjes (3535)	3535
1006917	PIU I Ujit (3535) (0000)	3535
1006933	Njesia e Manaxhimit te projektit te ndertimit te seg	3535
1006934	Njesia e Manaxhimit te projektit Ndertimi i Seksioni	3535
1006935	Njesia e Menaxhimit te Projektit (NJMP) (3535)	3535
1006947	PIU Program I Investimeve per Shpermdarjen e Energji	3535
1010902	PMU Mbeshtetje per SME	3535
1013902	PIU Rehabilitimit te Sisitemit Shendetesor (3535)	3535
1013903	PIU Global Fund (3535)	3535
1013907	Niesia e Koordinimit te Projektit Permiresimi i Sist	3535

Në formë më të përmbledhur, për vitin 2021, numri i insitucioneve që kanë detyrimin për të depozituar fizikisht pasqyrat financiare të konsoliduara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe atyre që e kanë përmbushur këtë detyrim janë si më poshtë:

Nr. rendor	Kategoria ose emërtesa e strukturës raportuese	Numri i institucioneve që kanë detyrimin për hatimin dhe depozitimin e PFK-ve	Numri i institucioneve që kanë dorëzuar në DPTH, PFK-të	Nuk kanë dorëzuar PFK për vitin 2021
1.	Ministritë e Linjës	12	10	2
2.	Institucionet Qendrore dhe tjera	53	36	17
3.	Bashkitë	61	11	50
4.	Këshillat e Qarkut	12	9	3
	Gjithsej	138	66	72

Burimi: DPTH, Drejtoria e Operacionev të Thesarit, përpunuar nga grupi i auditimit.

Si përfundim, bazuar në informacionet e administruara nga DPTH, rezulton se, nuk janë depozituar Pasqyrat Finnciare të Konsoliduara (PFK) për vitin 2021, nga 72 njësi të qeverisjes së përgjithshme, nga 138 gjithsej që sipas MFE që kanë detyrimin për hatimin dhe depozitimin e PFK-ve, ose 53 % institucioneve nuk kanë përmbushur këtë detyrim, ku peshën kryesore në këtë parregullsi e zënë institucionet e vetëqeverosjes vendore. Analizuar sipas strukturës së referuar më lartë detajohen si mëposhtë vijon:

- ⊕ **2 ministri**, (Ministria e Kultures dhe Kryeministria);
- ⊕ **3 Këshilla të Qarqeve**, përkatësisht, Këshilli i Qarkut Gjirokaster, Dibër dhe Kukës;
- ⊕ **51 bashkitë**: Tiranë, Vorë, Berat, Kuçovë, Poliçan, Skrapar, Ura Vajgurore, Dibër, Belsh, Cërrik, Elbasan, Gramsh, Delvinë, Himarë, Devoll, Kolonjë, Divjakë, Dropull, Gjirokastër, Këlcyrë, Libohovë, Memaliaj, Përmet, Tepelenë, Krujë, Shijak, Has, Kukës, Tropojë, Kamëz, Fushë-Arrëz,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

Malësi e Madhe, Pukë, Kavajë, Rrogozhinë, Konispol, Sarandë, Selenicë, Vlorë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Librazhd, Peqin, Lushnje, Mallakastër, Roskovec, Maliq, Pogradec, Pustec, etj.

⊕ 17 institucione qendrore.

Për vitin 2022, numri i insitucioneve që kanë detyrimin për të depozituar fizikisht pasqyrat financiare të konsoliduara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe atyre që e kanë përmbushur këtë detyrim janë si më poshtë vijon:

Tabela nr. 7, Depozitimi në MFE i PFK te vitit 2022

Nr. Rendor	Ministrite e Linjes/ Keshillat e Qarkut	Kodi SIFQ	Statusi	Shkrese sipas Protokollit te Institucionit
1	Ministria e Infrastruktures dhe Energjise	1006001		Shkrese Nr 4489 date 22.05.2023
2	Ministria e Mbrojtjes	1017001		Shkrese Nr. 1985 date 03.04.2023
3	Ministria e Mjedisit dhe Turizimit	1026001		
4	Ministria e Financave dhe Ekonomise	1010001		
5	Ministria e Kultures	1012001		
6	Ministria per Europen dhe Punet e Jashtme	1015001		
7	Ministria e Shendetise dhe Mireqenies Sociale	1013001	Dorezuar	Shkrese Nr. 1635 date 11.04.2023
8	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise	1011001		Nr.2802, date 28.4.2023
9	Ministria e Brendshme	1016001		Shkrese Nr 3030/1 date 28.04.2023
10	Ministria e Zhvillimit Bujqesore dhe Rural	1005001	Dorezuar	Shkrese Nr. 1063/21 date 20.04.2023
11	Ministria e Drejtesise	1014001	Dorezuar	Shkrese Nr. 3136 date 28.04.2023
Nr. Rendor				
1	Keshilli I Qarkut Tirane	2035001		
2	Keshilli I Qarkut Lezhe	2020001		
3	Keshilli I Qarkut Vlore	2037001		
4	Keshilli I Qarkut Berat	2042001		
5	Keshilli I Qarkut Gjirokaster	2011001		
6	Keshilli I Qarkut Korce	2015001	Dorezuar	Shkrese Nr. 290 date 19.04.2023
7	Keshilli I Qarkut Shkoder	2033001		
8	Keshilli I Qarkut Elbasan	2048001	Dorezuar	Shkrese Nr. 290 date 03.05.2023
9	Keshilli I Qarkut Fier	2048001	Dorezuar	Shkrese Nr. 364 date 27.03.2023
10	Keshilli I Qarkut Durres	2047001	Dorezuar	Shkrese Nr. 163 date 03.04.2023
11	Keshilli I Qarkut Diber	2046001		
12	Keshilli I Qarkut Kukes	2018001		
Nr. Rendor				
	FSDKSH	003	Dorezuar	Shkrese Nr. 1417 date 25.04.2023
	ISSH	004	Dorëzuar	
Nr. Rendor				
1	Bashkia Shkoder			Nr.5970, dt 28.4.2023
2	Bashkia Bulqize			



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

3	Bashkia Perrenjas			
4	Bashkia Fier		Dorezuar	Shkrese Nr. 3749 date 28.04.2023
5	Bashkia Korce		Dorezuar	Shkrese Nr. 3382 date 27.04.2023
6	Bashkia Klos			
7	Bashkia Vau Dejes			
8	Bashkia Finiq			
9	Bashkia Mat			Nr.2131, dt 3.5.2023
10	Bashkia Vau i Dejes			
11	Bashkia Durres			
12	Bashkia Patos			
13	Bashkia Perrenjas		Dorezuar	Shkrese Nr. 574 date 23.02.2023
1	Keshilli I Larte Gjyqesor		Dorezuar	Shkrese Nr. 2643 date 28.04.2023
2	Radio Televizioni Shqiptar		Dorezuar	Shkrese Nr. 769 date 31.3.2023
3	ADISA		Dorezuar	Shkrese Nr. 220 date 29.03.2023
4	Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit		Dorezuar	Shkrese Nr. 186 date 20.03.2023
5	Komisioni I Prokurimit Publik		Dorezuar	Shkrese Nr. 671 date 30.03.2023
6	Agjencia e Zhvillimit te Territorit		Dorezuar	Shkrese Nr. 1453 date 23.03.2023
7	Drejtoria e Pergjithshme Detare Durres		Dorezuar	Shkrese Nr. 435 date 24.03.2023
8	Universiteti Ismail Qemali		Dorezuar	Shkrese Nr. 628/1 date 31.03.2023
9	Rrjeti Akademik Shqiptar		Dorezuar	Shkrese Nr. 128 date 31.03.2023
10	Inspektorati I Larte I Drejtesise		Dorezuar	Shkrese Nr. 955 date 27.03.2023
11	Autoriteti I Mediave Audiovizive		Dorezuar	Shkrese Nr. 1414 dt 31.03.2023
12	Autoriteti Kombetar per Sigurine e Informacionit te Klasifikuar		Dorezuar	Shkrese Nr. 946 date 29.03.2023
13	SASPAC		Dorezuar	Shkrese Nr. 321 date 15.03.2023
14	Fondi Shqiptar I Zhvillimit per Diasporen		Dorezuar	Shkrese Nr. 1067 date 23.03.2023
15	Keshilli Kombetar I Kontabilitetit		Dorezuar	Shkrese Nr. 54 date 07.03.2023
16	Institucioni I Presidentit te Republikes		Dorezuar	Shkrese Nr. 1007 d ate 13.03.2023
17	ILDKPI		Dorezuar	Shkrese Nr. 1476 date 17.03.2023
18	Autoriteti I Mbikqyrjes se Lojrave te Fatit		Dorezuar	Shkrese Nr. 429 d ate 02.03.2023
19	Shkolla e Magjistratures		Dorezuar	Shkrese Nr. 207 date 10.03.2023
20	QTTB Vlore		Dorezuar	Shkrese Nr. 70/1 date 27.03.2023
21	Qendra Kombetare e Biznesit		Dorezuar	Shkrese Nr. 6829 date 20.03.2023
22	Fondi Shqiptar I Zhvillimit		Dorezuar	Shkrese Nr. 1207 date 03.04.2023
23	ARRSH		Dorezuar	Shkrese Nr. 2899 date 03.04.2023
24	Instituti I Statistikave		Dorezuar	Shkrese Nr. 772 date 20.04.2023
25	Qendra Kombetare e Kultures per Femije		Dorezuar	Shkrese Nr. 89/1 date 16.05.2023

Burimi: DPTH, Drejtoria e Operacionev të Thesarit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

Analizuar për vitin 2022 janë edhe **728 njësi të menaxhimit të projekteve me financim të huaj**, por njesitë e zbatimit të projekteve të cilat kane operacione me deget e thesarit dhe kanë depozituar pasqyrat financiare pranë këtyre degëve janë **6** për vitin 2022, si më poshtë:

Tabela nr. 8 ,Njësitë e Zbatimit të Projektit për 2022 depozituar pranë degës së thesarit.

Distrikti	Emertimi i Institucionit	Kodi i institucionit
3535	PIU I Ujit (3535)	1006917
3535	Njesia e Menaxhimit te projektit te ndertimit te segn	1006933
3535	Njesia e Menaxhimit te Projektit (NJMP) (3535)	1006935
3535	PIU Rehabilitimit te Sisitemit Shendetesor (3535)	1013902
3535	PIU Global Fund (3535)	1013903
3535	Qendra Kombetare e Edukimit ne Vazhdim (3535)	1013904

Konstatim nr.5:

Nuk rezulton që të gjithë Njësitë e Zbatimit të Projekteve për v.2021 dhe 2022 të kenë depozituar pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore pranë DPTH së MFE-së si dhe, nuk janë përfshirë PF e NJZP si pjesë e pasqyrave financiare të konsoliduara të njësive publike qendrore, në kundërshtim me përcaktimet e Paragrafit nr. 20, shkronja “c”, e UMF nr. 5, datë 21.2.2022, i cili ka parashikuar se:

Konsolidimi i Pasqyrave Financiare Vjetore deri në nivelin e Qeverisjes së Përgjithshme kryhet nëpërmjet grupimit të informacionit (duke bërë eliminimet dhe mënjauar dublimet) dhe duke kaluar nivelet e mëposhtme:

.....
c.Konsolidimi i pasqyrave financiare në **nivel qeverisje qendrore përfshirë të gjitha pasqyrat financiare të konsoliduara** të njësive publike qendrore (ministri, institucione të tjera qendrore, fondet speciale të krijuara prej tyre, **njësitë e menaxhimit dhe zbatimit të projekteve**), informacionin e Ilogarisë qendrore të qeverisë, të Ilogarive të tjera speciale si dhe informacionin për borxhin qeveritar publik.

Në formë më të përmbledhur, për vitin 2022, numri i insitucioneve që kanë detyrimin për të depozituar fizikisht pasqyrat financiare të konsoliduara pranë Drejtorisë së Pergjithshme të Thesarit dhe atyre që e kanë përmbushur këtë detyrim janë si më poshtë:

Nr. Rendor	Kategoria ose emërtesa e strukturës raportuese	Numri i institucioneve që kanë detyrimin për hatimin dhe depozitimin e PFK-ve	Numri i institucioneve që kanë dorëzuar në DPTH, PFK-të	Nuk kanë dorëzuar PFK për vitin 2022
1.	Ministrite e Linjes	12	7	5
2.	Institucionet Qendrore dhe tjera	53	25	28
3.	Bashkite	61	5	56
4.	Këshillat e Qarkut	12	4	8



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

Gjithsej	138	41	97
----------	-----	----	----

Burimi: DPTH, Drejtoria e Operacionev të Thesarit, përpunuar nga grupi i auditimit.

Si përfundim, bazuar në informacionet e administruara nga DPTH, rezulton se, nuk janë depozituar Pasqyrat Financiare të Konsoliduara (PFK) për vitin 2022, nga 97 njësi të qeverisjes së përgjithshme, ose 70.3 % e institucioneve që kanë detyrimin për hatimin dhe depozitimin e PFK-ve, që sipas strukturës së referuar më lartë detajohen si mëposhtë vijon:

- ⊕ **5 ministri:** (Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Mjedisit dhe Turizimit, Ministria e Kulturës, Ministria për Europën dhe Punet e Jashtme, Kryeministria).
- ⊕ **8 Këshilla të Qarqeve,** përkatësisht, Këshilli i Qarkut Tiranë, Shkodër, Gjirokastrë, Berat, Lezhë, Vlorë, Dibër dhe Kukës.
- ⊕ **56 bashkitë:** Berat, Kuçovë, Poliçan, Skrapar, Ura Vajgurore, Bulqizë, Dibër, Klos , Belsh, Cërrik, Elbasan, Gramsh, Delvinë, Himarë Finiq, Devoll, Kolonjë, Divjakë, Dropull, Gjirokastrë, Këlcyrë, Libohovë, Memaliaj, Përmet, Tepelenë, Durrës, Krujë, Shijak, Vau i Dejës, Has, Kukës, Tropojë, Kamëz, Shijak, Fushë-Arrëz, Malësi e Madhe, Pukë, Kavajë, Rrogozhinë, Tiranë, Vorë, Konispol, Sarandë, Selenicë, Vlorë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Librazhd, Peqin, Lushnje, Patos, Mallakastër, Roskovec, Maliq, Pogradec, Pustec.
- ⊕ **28 institucione qendrore dhe të tjera.**

Siç është referuar edhe nga veersimet e mëprashme të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare (FMN, BB, SIGMA, etj):

- *Njësitë individuale qeveritare prodhojnë, por nuk publikojnë pasqyra financiare duke përfshirë bilancin. Asetet dhe detyrimet që lidhen me partneritetin publiko-privat nuk raportohen rregullisht.*
- *Rezultatet fiskale prodhohen dhe publikohen në kohën e duhur, por nuk përbëjnë një grup të pasqyrave financiare.*
- *Është rekomanduar publikimi i një bilanci për qeverisjen e përgjithshme, duke filluar me aktivet financiare dhe detyrimet dhe zgjerimi në mënyrë progresive i bilancit për të përfshirë të gjitha aktivet financiare dhe jofinanciare dhe detyrimet, etj.*

Konstatim nr.6:

Nuk kanë gjetur zbatim të plotë detyrimet ligjore për konsolidim e pasqyrave financiare nga njësitë publike e sektorit publik, në nivel qendror dhe vendor, etj. sipas përcaktimeve të Udhëzimit të MFE nr.5, datë 21.2.2022, që ka përcaktuar se:

Kriteri:

Paragrafi 20, i UMFE nr 5/2022, ka nënvizuar se, “Në Kapitullin IV "Përbërja, përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara", paragrafi 101 ndryshon si më poshtë vijon:

Konsolidimi i Pasqyrave Financiare Vjetore deri në nivelin e Qeverisjes së Përgjithshme kryhet nëpërmjet grupimit të informacionit (duke bërë eliminimet dhe mënjatuar dublimet) dhe duke kaluar nivelet e mëposhtme:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

- i) Konsolidimi i pasqyrave financiare në **nivel njësie publike qendrore**, duke përfshirë informacionin financiar të organit qendror të njësisë (aparati), të gjitha njësitë e varësisë/njësi shpenzuese dhe pasqyrat financiare të kompanive nën kontroll ose pronësi të njësisë publike qendrore;
- j) Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivel njësie publike të **vetëqeverisjes vendore**, duke përfshirë informacionin financiar të organit qendror të njësisë (aparati), të gjitha njësitë e varësisë/njësi shpenzuese dhe pasqyrat financiare të kompanive nën kontroll ose pronësi të njësisë publike vendore;
- k) **Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivel qeverisje qendrore përfshirë të gjitha pasqyrat financiare të konsoliduara të njësive publike qendrore (ministri, institucione të tjera qendrore, fondet speciale të krijuara prej tyre, njësitë e menaxhimit dhe zbatimit të projekteve), informacionin e llogarisë qendrore të qeverisë, të llogarive të tjera speciale si dhe informacionin për borxhin qeveritar publik.**
- l) Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivel qeverisje vendore, përfshirë të gjitha pasqyrat financiare të konsoliduara të njësive publike të vetëqeverisjes vendore (bashkitë dhe këshillat e qarqeve).
- m) Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivel qeverisje të përgjithshme, përfshirë pasqyrat e konsoliduara sipas pikës c dhe d.

Paragrafi nr.23, e UMF nr.5 /2022, ka parashikuar që Kapitulli V "Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore", Paragrafi 120 i UMFE nr.8/2018, ndryshohet si më poshtë vijon:

Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore hartojnë përmbledhësen e konsoliduar për pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e flukseve monetare dhe shënimet shpjeguese për vitin ushtrimor të sapo mbyllur, për të gjitha institucionet apo njësitë e varësisë së tyre, brenda muajit Prill të vitit pasardhës dhe e depozitojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Pasqyra e konsoliduar vjetore e pozicionit financiar (Balanci) kontrollohet me pasqyrën përmbledhëse të pozicionit financiar të gjeneruar nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë dhe në rast mosrakkordimi i kthehet njësisë publike qendrore (organit qendror të saj) për azhorrime në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë sipas informacionit kontabël të të drejtave të konstatuara që disponon njësia qendrore.

Si përfundim:

Për sa sipër, është vepruar në mosrespektim të kërkesave të:

- ✓ Nenit 62 “Përgatitja e llogarive vjetore të buxhetit”, të ligjit nr. Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, me ndryshimet:

Ministri i Financave nxjerr, për të gjithë nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes qendrore, vendore dhe të fondeve speciale udhëzim për mbylljen e vitit buxhetor dhe për publikimin e pasqyrave financiare.

*-Nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes së përgjithshme, në fund të vitit depozitojnë në sistemin e thesarit **raporte financiare**, sipas përcaktimeve të nëpunësit të parë autorizues, për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshme.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

-Nëpunësit autorizues të njërive të qeverisjes së përgjithshme finalizojnë dhe konfirmojnë përfundimisht me nëpunësin e parë autorizues pasqyrat financiare vjetore të buxhetit, brenda datës 31 mars.

- ✓ Paragrafit 125, Kreu V “Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore”, të Udhëzimit nr. 8, datë 9.3.2018 i ndryshuar, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, që shprehimisht ka përcaktuar se:

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, hartohen Pasqyrat Financiare Përmbledhëse/ të Konsoliduara të Qeverisjes së Përgjithshme, qendrore e vendore, brenda Qershorit të vitit pasardhës, për vitin ushtrimor të mbyllur, mbi bazën e informacionit të depozituar nga strukturat përgjegjëse të përmendura në këtë udhëzim”.

- ✓ Paragrafi nr.5-7, Kreu I, i Udhëzimit vjetor për mbylljen e PF të vitit 2021:

Struktura përgjegjëse për thesarin në qendër harton të dhënat faktike përfundimtare të pasqyrës vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme brenda datës 15.02.2022. Pasqyra vjetore e konsoliduar e shpenzimeve dhe e të ardhurave të njërive të qeverisjes së përgjithshme publikohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në muajin shkurt 2022.

Pasqyra vjetore e konsoliduar e shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme e shoqëruar me raportimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2021, performancës makro-fiskale, situatës së menaxhimit të kontrollit të brendshëm financiar dhe auditimit të brendshëm i paraqitet Këshillit të Ministrave brenda muajit Maj të vitit 2022.

- ✓ Paragrafit 20 dhe 23, të UMFE nr.5, datë 21.2.2022.

Konstatim nr.7:

Për shkeljet ligjore, në lidhje me mos respektimin e afatit të depozitimit të Pasqyrave Financiare Individuale e Përmbledhëse/ të Konsoliduara nga ana e njërive shpenzuese/ institucioneve shtetërore buxhetore apo ekstrabuxhetore etj., nuk janë zbatuar përgjegjësitë ligjore nga ana e Nëpunësit të Parë Autorizues mbi marrjen e masave administrative. Më hollësisht, evidentohet se,

Për vitin 2021:

- Dorëzimi i PFK nga ana e MTM është bërë me datën 8.7.2022, ose **69 ditë** në shkelje të afatit ligjor për depozitimin e tyre;
- Dorëzimi i PFK nga ana e Këshillit të Qarkut Lezhë është bërë me datën 27.6.2022, ose **58 ditë** në shkelje të afatit ligjor për depozitimin e tyre;
- Dorëzimi i PFK nga ana e Bashkisë Durrës është bërë me datën 30.6.2022, ose **61 ditë** në shkelje të afatit ligjor për depozitimin e tyre;
- Dorëzimi i PFK nga ana e Këshillit të Qarkut Elbasan është bërë me datën 21.6.2022, ose **52 ditë** në shkelje të afatit ligjor për depozitimin e tyre;
- Dorëzimi i PFK nga ana e Bashkisë Patos është bërë me datën 31.5.2022, ose **31 ditë** në shkelje të afatit ligjor për depozitimin e tyre;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

- Dorëzimi i PFK nga ana e MIE është bërë me datën 9.5.2022, ose **9 ditë** në shkelje të afatit ligjor për depozitimin e tyre;
- Dorëzimi i PFK nga ana e Bashkisë Mat është bërë me datën 11.5.2022, ose **11 ditë** në shkelje të afatit ligjor për depozitimin e tyre;
- Dorëzimi i PFK nga ana e Këshillit të Qarkut Korçë është bërë me datën 6.5.2022, ose **6 ditë** në shkelje të afatit ligjor për depozitimin e tyre, etj.

Për vitin 2022:

- Dorëzimi i PFK nga ana e MIE është bërë me datën 22.5.2023, ose **22 ditë** në shkelje të afatit ligjor për depozitimin e tyre;
- Dorëzimi i PFK nga ana e Projektit të MSHMS, “Modernizimi i asistencës sociale shtesa nr.8” është bërë me datën 16.5.2023, ose **16 ditë** në tejkalim të afatit ligjor, etj.

Një numër subjektesh shtetërore, buxhetore dhe ekstrabuxhetore, (në shtatë raste), rezultojnë me problematika dhe shkelje në mënyrë të përsëritur për dy vitet radhazi 2021 dhe 2022 në lidhje me zbatimin e afatit të dorëzimit të pasqyrave financiare vjetore, të tilla si,

Bashkia Pustec, Shërbimi Kombëtar i Rinisë, Ministria e Kulturës, Ujësjellës Kanalizime sha Durrës, Ujësjellës Kanalizime sha Shkodër, Federata Shqiptare e Aero-nautikës, Federata Shqiptare e Motoçiklizimit, etj.

Sa sipër, është vepruar në kundërshtim me përcaktimet:

- **Nenit 71, germa ”e“, Kreu IX, të ligjit Nr. 9936, datë “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, që thekson (citojmë) :**

e) kur nëpunësi autorizues dhe/ose nëpunësi zbatues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme nuk përmbushin detyrimet për mbylljen e vitit buxhetor dhe nxjerrjen e llogarive vjetore të buxhetit, në kundërshtim me nenin 62 të këtij ligji, dënohen nga nëpunësi i parë autorizues me masë administrative ose me gjobë në masën 1-3 paga mujore.

- **Paragrafit nr. 45, Kreu V, të Udhëzimit nr.25, datë 09.12.2021 “Për procedurat e mbylljes se llogarive vjetore te buxhetit për vitin 2021”, ku është shprehur se, (cituuar):**

“Për mosrespektim të kërkesave të këtij udhëzimi nga ana e nëpunësit autorizues dhe zbatues të njësive të qeverisjes së përgjithshme, Nëpunësi i Parë Autorizues zbaton penalitetet e përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;

- **Paragrafit nr. 45, Kreu VI “Masat administrative”, të Udhëzimit nr.34, datë 14.12.2022 “Për procedurat e mbylljes se llogarive vjetore te buxhetit për vitin 2022, (cituuar):**

“Për mosrespektim të kërkesave të këtij udhëzimi nga ana e nëpunësve autorizues dhe zbatues të njësive të qeverisjes së përgjithshme, Nëpunësi i Parë Autorizues zbaton penalitetet e përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

III. Auditimi dhe analiza e informacionit kontabël dhe i të dhënave të Pasqyrave Financiare të depozituara nga institucionet e qeverisjes së përgjithshme pranë MFE:

Procesi i auditimit të institucioneve buxhetore, si dhe ai i analizimit të pasqyrave financiare vjore individuale (PFVI) ka nxjerrë në pah:

- **dobësi dhe mangësi në organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit mbi bazën e kritereve të përcaktuara, ka edhe vonesa e cilësi të dobët të informacionit financiar, llogari kontabile që nuk kanë analiza inventariale dhe të rezultojnë të paidentifikuara, ku këtu kane ndikuar edhe fakti i ristrukturimeve të ministrive dhe institucioneve qendrore e vendore;**
- **një sërë mospërputhjesh ndërmjet pasqyrave individuale dhe konsolidimit të tyre në Pasqyrat financiare të nivelit të gupit nga ana e institucionet e qeverisjes së përgjishme;**
- **parregullsi në zbatimin e kërkesave të Udhëzimit të MFE nr. 5, datë 21.02.2022 mbi përgatitjen dhe hartimin e këtyre pasqyrave.** Kjo për shkak se disa prej Njësiteve Shpenzuese Buxhetore (NJSB), nuk kanë regjistruar dhe pasqyruar drejt disa zëra të llogarive në pasqyrat e tyre financiare dhe Ministrinë e linjës administrative kanë bërë konsolidimin e këtyre të dhënave ashtu siç janë raportuar nga institucionet publike dhe subjektet buxhetore raportuese, si dhe
- **mospërputhje ndërmjet të dhënave të pasqyrave të llogaridhënies vjetore individuale me ato të regjistruara në Sistemin Informativ Financiar të Qeverisë (SIFQ), duke dhënë ndikimin e tyre në rezultatet dhe shtësinë e informacionit kontabël të konsoliduar, për hartimin e Pasqyrave Financiare të Qeverisjes së Përgjithshme.**

Midis pasqyrave fizike të dorëzuara nga institucionet buxhetore në degët e thesarit dhe pasqyrave financiare të gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ), **rezultojnë diferenca**, për shkak se:

- ✓ Në pasqyrat financiare të gjeneruara nga SIFQ, pasqyrohen **shpenzimet faktike të vitit**, ndërsa në **pasqyrat fizike (manuale) të institucioneve buxhetore pasqyrohen detyrimet e konstatuara dhe të papaguara**, si pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, apo detyrimi për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit dhe paguhen me buxhetin e vitit të ardhshëm;
- ✓ Në pasqyrat financiare të gjeneruara nga SIFQ **pasqyrohen arkëtimet e vitit**, ndërsa në pasqyrat fizike të institucioneve buxhetore, **pasqyrohen të drejtat e konstatuara dhe të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme**, siç janë debitorët.

Nga ana e KLSH-së, prej disa vitesh është kërkuar që, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, (Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Publik), të marrin masa për hartimin e një metodologjie për përgatitjen e saktë të pasqyrave të konsoliduara financiare të qeverisë në përrputhje me rregullat bazë të kontabilitetit, por nuk rezultojnë të ketë një realizim të kësaj detyrimi me finalizimin e këtyre pasqyrave në nivelin e sektorit publik.

Parregullsitë, mangësitë apo mospërputhjet në shifrat e konsoliduara dhe pasqyrat financiare, kanë të bëjnë me çështjet si më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E FINANCIVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

Konstatim nr.8:

Për periudhën objekt auditimi 2021 dhe 2022, nga ana e Drejtorise së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të MFE, si dhe DPTH (në po këtë ministri) nuk evidentohet ndonjë rast i regjistruar, ku **si pasojë e konstatimit të mosrakordimeve të pasqyrave të konsoliduara vjetore të pozicionit financiar (Bilanci) në nivel gupi, t'i jenë kthyer institucionit buxhetor (ose organit qendror të saj), për azhornim në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë** ku nga, pasi është kontrolluar dhe me pasqyrën përmbledhëse të pozicionit financiar të gjeneruar nga SIFQ, bazuar në informacionin kontabël të të drejtave të konstatuara që disponon njësia qendrore, dhe referuar kërkesave të paragrafit nr. 23 dhe 24, të Udhëzimit të MFE nr.5, datë 21.2.2022, që përcakton se:

23.Në Kapitullin V "Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore", Paragrafi 120 ndryshon si më poshtë vijon:

Ministritë dhe institucionet e tjera qendore hartojnë përmbledhësen e konsoliduar për pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e flukseve monetare dhe shënimet shpjeguese për vitin ushtrimor të sapo mbyllur, për të gjitha institucionet apo njësitë e varësisë së tyre, brenda muajit Prill të vitit pasardhës dhe e depozitojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, **Pasqyra e konsoliduar vjetore e pozicionit financiar (Bilanci) kontrollohet me pasqyrën përmbledhëse të pozicionit financiar të gjeneruar nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë dhe në rast mosrakordimi i kthehet njësisë publike qendrore (organit qendror të saj) për azhornim në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë** sipas informacionit kontabël të të drejtave të konstatuara që disponon njësia qendrore.

24.Në Kapitullin V "Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore" Paragrafi 122 ndryshon si më poshtë vijon:

Njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë pasqyrat financiare të konsoliduara në mvel njësie publike, respektivisht pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e flukseve monetare dhe shënimet shpjeguese, brenda muajit Prill të vitit pasardhës dhe e depozitojnë atë në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. **Pasqyra e konsoliduar vjetore e pozicionit financiar (Bilanci) kontrollohet me pasqyrën përmbledhëse të pozicionit financiar të gjeneruar nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë dhe në rast mosrakordimi i kthehet njësisë publike vendore (organit qendror të saj) për azhormm ne bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë** sipas informacionit kontabël të të drejtave të konstatuara që disponon njësia vendore.

Konstatim nr. 9:

Nga analizimi i të dhënave të pasqyrave të rezultatit financiar, gjeneruar nga sistemi për 15 njesite shpenzuese me akses të drejteperdrejte në SIFQ për vitin 2022, rezulton se në 6 subektet e testuara, në 5 prej tyre, ***tepricat e llogarive më 31.12.2022 janë me të njëjtën shifër me tepricën e datës 31.12.2021, duke evidentuar riskun e parregullsive në hedhjen/ mbartjen e të dhënsve kontabile*** nga ana e kontabilisteve dhe hartuesve të problemeve të kontabilitetit në Institucionet qendrore me akses të drejtëpërdrejtë në SIFQ, për shembull:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

- **Kryeministria (aparati):** Ilogaritë me vlerë të njëjtë për dy vitet objekt auditimit 2021 dhe 2022, Ilogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, për 10,091,723 lekë; Ilog.31 “Materiale”, për 18,058,969 lekë; Ilog 467 “Kreditorë të ndryshëm”, për 1,304,380 lekë;
- **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural:** Ilogaritë me vlerë të njëjtë për dy vitet objekt auditimit 2021 dhe 2022, Ilogaria Aktivet Financiare (n. Ilog.25 dhe 26), për 2,217,739,000 lekë; Iloga 210 është zero për dy vitet; Ilog 212: 113,131,922 lekë; Ilog. 215 “Mjete transporti” për 19.674.990 lekë; Ilog.202 “Studime e kërkime”, për 3,504,000 lekë; Ilog.218 “Inventar ekonomik” për 44.486.418,85 lekë; etj. Ilog 202.
- **Bashkia e Tiranës:** Ilogaritë me vlerë të njëjtë për dy vitet objekt auditimit 2021 dhe 2022, Ilogaria 419 “Kliente (kreditore) për 58,702,072 lekë; Llog. 477 “Diferenca konvertimi aktive”, për 1.563.808 lekë, Llog. 464 “Detyrime për t'u paguar për blerjen e letrave vlerë” për 50.400 lekë; Ilog. 32 “Objekte inventari”, për 8.968.985 lekë;
- **Autoriteti Rrugor Shqiptar:** Ilogaritë me vlerë të njëjtë për dy vitet objekt auditimit 2021 dhe 2022, Ilogaria 423 e 429 “Personeli, paradhenie, deficite e gjoba”, për 2.360.000 lekë, etj.
- **Ministria e Financave dhe Ekonomisë:** Ilogaritë me vlerë të njëjtë për dy vitet objekt auditimit 2021 dhe 2022, Llog.411-418 “Kliente e Ilogari të ngjashme, për 535.303.000 lekë; Llog.21,24,28 “Aktive të Qendrushme të trupëzuara” për 2.452.317.835 lekë; Llog. 419 “Kliente(Kreditore), parapagese pjesore” për 535.272.185 lekë; Llog. 4341”Te tjera operacione me shtetin (kreditor)” për 7.268.412 lekë, etj.

Konstatim nr. 10:

Nga kryerja e testeve substanciale, për verifikimin e mbartjes së tepricave në fund të periudhës tek ato në fillim periudhës së vitit pasardhës, (tepricat e çeljes) në pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata, u konstatua se, **ekzistojnë mospërputhje midis shumave të bilancit të mbylljes të vitit ushtrimor dhe atij të çeljes në vitin pasardhës, për Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për 5 Institucione të Qeverisjes Qendrore (ministri), duke krijuar probleme e pasaktësi të informacionit kontabël, shtuar vështirësitë e konsolidimit në nivel grupi dhe më tej në nivel të qeverisjes së përgjithshme, pasi efekti i përgjithshëm i mosrakordimeve vetëm për institucionet e analizuara është për shumën prej 47,891,252,473 lekë, e cila detajohet si më poshtë vijon:**

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me mospërputhje prej 47,856,320,544 lekë;
- Ministria e Brendshme prej 4,884,847 lekë;
- Ministria e Arsimit dhe Sporteve prej 2,608,587 lekë;
- Ministria e Infrastruktues dhe Energjisë prej 4,676,301 lekë;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale prej 22,762,194 lekë.

Më hollësisht,

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

Konstatohet se, në bilancin e konsoliduar të vitit 2021, në pasqyrën nr.1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, totali i aktiveve nuk është i barabartë me totalin e pasivit të bilancit të konsoliduar për vitin 2020 dhe 2021.

Shuma totale e aktivitetit të bilancit të konsoliduar (pasqyra nr .1), për datën 31.12.2021 është 503,821,359,488 lekë, kurse shuma totale e aktivitetit të bilancit të dt. 31.12.2022, për ushtrimin paraardhës është 455,965,038,944 lekë, duke rezultuar me diferencë dhe mos barazim për vlerën - **47,856,320,544 lekë**.

2. Ministria e Brendshme:

Nga auditimi i PFK të Ministrisë së Brendshme, konstatohet se, egzistojnë mospërputhje të të dhënave të kolonës “ushtrimi i mbyllur” i bilancit të konsoliduar të dates 31.12.2021, (dërguar MFE me shkresën nr. 2396/2, dt 29.4.2022 të MB), pasqyruar totali aktivitet dhe pasivit për 30,812,751,940 lekë, me të dhënat e kolonës “ushtrimi paraardhës”, në bilancin e datës 31.12.2022, (dërguar në MFE me shkresën e MB nr. 3030/1, datë 28.4.2023 , protokoll i MFE nr. 9407, dt 23.5.2023), ku totali i aktivitet dhe pasivit pasqyruar për v.2021 është: 30,817,636,787 lekë, duke rezultuar me një diferencë në vlerën prej + **4,884,847 lekë**, sa nuk kuadrojnë të dhënat dhe pasqyruar me tepër celje ushtrimi i meparshëm, në fillim të vitit 2022.

3. Ministria e Arsimit dhe Sporteve:

Nga auditimi i PFK të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, konstatohet se, egzistojnë mospërputhje e të dhënave të kolonës “ushtrimi i mbyllur” i bilancit të konsoliduar të datës 31.12.2021, (dërguar MFE me shkresën nr. 2810/1, dt 29.4.2022), pasqyruar totali aktivitet dhe pasivit për 30,564,666,353 lekë), me të dhënat e kolonës “ushtrimi paraardhës”, në bilancin e datës 31.12.2022, (dërguar në MFE me shkresën e MAS nr. 2802, datë 28.4.2023 (ska nr. Protokollit të MFE), i pasqyruar totali i aktivitet dhe pasivit për vitin e meparshëm 2021 për: 30,562,057,766), duke patur një diferencë mosakordimi në vlerën prej - **2,608,587 lekë**, sa nuk kuadrojnë të dhënat dhe pasqyruar me tepër celje ushtrimi i meparshëm, në fillim të vitit 2022.

4. Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë:

Konstatohet se, nuk përputhen të dhënat e kolonës “ushtrimi i mbyllur” (i bilancit të dates 31.12.2021, i pasqyruar për 391,217,673,910 lekë) me të dhënat e kolonës “ushtrimi paraardhës”, (në bilancin e datës 31.12.2022, i pasqyruar për 391,212,997,609), duke patur një diferencë mosakordimi në vlerën prej - **4,676,301 lekë**, sa pasqyruar me pak celje ushtrimi i meparshëm, në fillim të vitit 2022.

5. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:

Nga kryerja e testeve substanciale, për verifikimin e mbartjes së tepricave në fund të periudhës tek ato në fillim periudhe (tepricat e çeljes) në pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata, u konstatua se, ekzistojnë mospërputhje midis shumave të bilancit të mbylljes dhe atij të celjes në vitin pasardhës, pasi: të dhënat e gjendjes së ushtrimit paraardhës në PFK të vitit 2022 (në formatin 1, “Totali i aktiveve”, rreshti nr.1 ka shumën prej 45,664,255,457 lekë, kurse në pasqyrën financiare të konsoliduar të vitit 2021, totali i aktiveve gjithsej në ushtrimin e mbyllur është regjistruar për tepricën neto 45,687,017,651 lekë në pasqyrën nr. 1 “Pozicioni financiar”, grupi “Aktivi i Bilancit Kontabël”, duke rezultuar një mbartje më pak të vlerave të llogarive në bilancin e çeljes prej -**22,762,194 lekë**, etj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

Konstatim nr.11:

I. Nga kryqëzimet e informacionit dhe auditimi i treguesve të pasqyrave financiare të gjeneruar nga Sistemi Informativ Financiar i Qeverisë (SIFQ) rezulton se për vitin 2020 dhe 2021 2022, ***pasqyrat individuale të llogaridhënies vjetore*** në 10 institucione qendrore (Ministri dhe aparati i Kryeministrit) nga 12 gjithsej të përfshira në analizë, ***për llogarinë nr. 210, “Toka, troje dhe terrene”, e kanë të pasqyruar vlerën zero lekë, në kundërshtim me parimet e përgjithshme të kontabilitetit mbi saktësinë dhe vërtetësinë e llogarive***, në mospërputhje me përcaktimet e paragrafit 60 dhe 62, pika 3.3, “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci) kreu III, të Udhëzimit Nr. 8, datë 9.3.2018 I ndryshuar, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, që përcakton shprehimisht se:

60.Pasqyra individuale e pozicionit financiar (bilanci kontabël) pasqyron në mënyrë të klasifikuar e strukturuar aktivet, detyrimet dhe fondet neto të njësisë së qeverisjes së përgjithshme në datën e përcaktuar për mbylljen e vitit ushtrimor raportues. Si rregull, periudha ushtrimore është nga data 1 Janar deri më 31 Dhjetor të vitit raportues.

62.Aktivet paraqiten në rubrikën A të pasqyrës së pozicionit financiar. Totali i aktiveve përbëhet nga shuma e totalit të aktiveve afatshkurtra dhe totalit të aktiveve afatgjata. Rubrika I e aktiveve, që përfaqëson aktivet afatshkurtra, përbëhet nga shuma e nënrubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, gjendje inventari qarkullues, llogari të arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra.

-Nënrubrika e “mjeteteve monetare dhe ekuivalentët e tyre” analizon mjetet monetare (në arkë dhe bankë) si dhe ekuivalentët e tyre (si letra me vlerë, disponibilitete në thesar, etj);

-Nënrubrika “gjendje inventari qarkullues” analizon të gjithë elementët e inventarit të stokuar (si inventar i imët, prodhim në proces, produkte, etj);

-Nënrubrika “llogari të arkëtueshme” evidenton llogaritë e të drejtave që ka njësia për të arkëtuar në fund të periudhës raportuese (si klientë, tatime dhe taksa, debitorë të ndryshëm, etj);

-Nënrubrika “të tjera aktive afatshkurtra” analizon elementë si parapagime, shpenzime për t’u shpërndarë në disa ushtrime, etj.

Rubrika e II-të e aktiveve, që përfshin aktivet afatgjata, përbëhet nga shuma e nënrubrikave që përfaqësojnë;

-Nënrubrika e aktiveve afatgjata jomateriale, që përfshin studime dhe kërkime, koncesione, patenta, licenca e të tjera të ngjashme;

-Nënrubrika e aktiveve afatgjata materiale, që përfshin toka, pyje, ndërtesa, rezerva shtetërore, etj;

-Nënrubrika e aktiveve afatgjata financiare, që përfshin huadhënie dhe pjesëmarrje në kapitalin e vet;

-Nënrubrika e investimeve, që përfshin aktivet në proces për aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale.

Më konkretisht,

Tabela nr.

Të dhënat në lekë

Nr	Emërtimi i institucionit Qendror	31.12.2021	31.12.2020
1.	Aparati i Kryeministrit	2,856,452,000	0



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

2.	MAS Tiranë	0	0
3.	M.Brendshme Tiranë	0	0
4.	MBZHR Tiranë	0	0
5.	MD Tiranë	0	0
6.	MFE Tiranë	0	0
7.	MIE Tiranë	35,465,284	298,544,186
8.	M.Kulturës Tiranë	261,298,634	261,298,634
9.	M.Mbrojtjes Tiranë	0	0
10.	MPJ Tiranë	0	0
11.	MSHMS Tiranë	0	0
12.	MTM Tiranë	0	0

Burimi: MFE, DPTH (Pasqyra financiar të gjeneruara nga SIFQ), përpunuar nga grupi i auditimit.

Nga auditimi rezultoi se, **edhe në pasqyrat financiare të konsoliduara nuk jepet asnjë e dhënë mbi vlerën e aktiveve afatgjata materiale , në zërin “Toka, troje dhe terrene”, që këto institucione kanë në pronësi apo administrim.** *Kështu psh,*

- ✓ PFK të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2021, (dërguar në MFE me shkresën nr. 1693/1, datë 28.4.2022), llog 210 e kanë në vlerën zero lekë;
- ✓ PFK të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për vitin 2021, (dërguar në MFE me shkresën nr. 5553/, datë 8.7.2022 dhe protokolluar ne MFE me nr. 13766, datë 18.7.2022), llog 210 e kanë në vlerën zero lekë;
- ✓ PFK të Ministrisë së për Evropën dhe Punët e Jashtme për vitin 2021, (dërguar në MFE e shkresën nr. ska, datë 27.4.2022 dhe potokolluar në MFE me nr. 7940/10, dt 29.4.2022), llog 210 e kanë në vlerën zero lekë;
- ✓ etj.

Edhe për pasqyrat financiare vjetore të v.2022, në një numër subjektësh, llogaria kontabile 210 është e pa përfshirë, pasi është shënuar për 0 lekë, dhe më konkretisht:

Tabela nr.

Institucioni	Llog.210	Llog.212	Llog.486
Drejtoria e përgjithsme e akreditimit	0	0	0
ILDKPKI	0	58,565,118	0
Drejtoria e përgjithsme detare	0	188,929,350	0
Keshilli kombëtar i kontabilitetit	0	0	0
Dr. Parandalimit të Parave	0	2,537,271	0
AKSIK	0	30,186,816	0
Agjensia e programimit strategjik dhe kordinimit të ndimes	0	0	0
QKB	0	5,020,075	
Prokuroria e përgjithsme	162,220,109	818,889,137	88,456,097
Qendra institucionale e rrjetit akademik shqiptarë	0	13,782,086	0
RTSH	19,196,000	243,940,157	0
FSHZH	111,828,785	905,120,793	0



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

SHISH	78,595	769,406,252	0
U.K Fush Arrez	610,892	15,282,551	
Qendra te transferimit te teknologjive bujqesorE VLORE	9,966,612	73,344,493	0
Qendra Kombetare Kulturore Femije	22,219,197	66,980,603	
I Statistikave	0	113,004,165	0
Lojrat e fatit	0	0	0
ILD	0	520,528,844	113,700,858
UNV Ismail Qemali Vlore	2,482,100	303,318,832	0
Shkolla e magjistraturës	0	6,664,207	0
AMA	0	78,644,034	
AIDA	0	0	0
KPP	0	0	0
KLJGJ	812,730	1,526,306,879	0
Presidenti I Shqiperise	0	242,464,927	101,600
A.ZH Territorit	0	0	1,179,903
Agjensia kombetare e planifikimit te territorit	0	0	0
B. Prrenjas	4,918,360	599,864,043	24,828,425
B. Fier	934,368,595	4,963,513,301	0
B. Shkoder	1,152,192,231	4,196,005,814	0
B. Mat	34,812,049	771,365,703	0
B. Korce	1,875,493,691	3,654,134,460	0
Keshilli Qarkut Vlore	0	68,134,613	0
Keshilli I qarkut Durres	0	48,964,017	51,499,860
Keshilli I Qarkut Fier	0	1,614,194	0
Keshilli I Qarkut Elbasan	0	7,264,475	
Ministria Mbrojtjes	0	0	1,204,664
Ministria e Drejtesise	0	5,963,091,063	112,296,500

Burimi: MFE, DPTH: (Pasqyrat financiar të depozituara fizikisht nga IB), përpunuar nga grupi i auditimit.

Nga auditimet e kyera nga ana e KLSH-së për këtë llogari, në kontabilitetin e institucioneve të ndryshme shtetërore, ka rezultuar se:

I.a- Evidentimi në kontabilitet i tokave bujqësore, (auditimi i kryer nga KLSH në institucionin e Kuvendit të Shqipërisë dhe Autoritetin e Mediave Audiovizive):

Kuvendi i Shqipërisë:

Titulli i Gjetjes: Nuk është regjistruar në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare për periudhën 2017- 2021 vlera e trojeve në administrim të institucionit. ndikojnë në funksionimin e sistemit të kontabilitetit dhe pasqyrimit me vërtetësi dhe saktësi të gjendjes së llogarive të bilancit kontabël për institucionin e Kuvendit. Në pasqyrat e llogaridhënies vjetore të mbyllur me datën 31.12.2020 dhe 31.12.2021, llogaria nr. 210 “Toka, troje e terrene” është në vlerën zero lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme


Ekzistojnë dokumentacionet dhe planimetritë për sipërfaqet që mbulojnë godinat dhe oborri ku janë vendosur këto tre objekte ndërtimore dhe që ka në dispozicion dhe përgjegjësi administrimi institucioni për periudhën objekt auditimi, por nuk është regjistruar kjo sipërfaqe në kontabilitetin e Kuvendit, ndonëse sipas VKM përkatëse, Agjencia Shtetërore e Kadastrës është ngarkuar për regjistrimin e objektit dhe truallit, për llogari të këtij institucioni.

Sipërfaqja totale e tokës që ka Kuvendi në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet. Kjo çështje për grupin e auditimit konsiderohet materiale, pasi, bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë", (Harta sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016, faqe 973), vlera e pasurisë së paluajtshme të tokës truall për qytetin e Tiranës, (referuar çmimeve të vitit 2014), përcaktohet me 66,969 lekë/m² në zonën kadastrale ku shtrihen këto pasuri publike.

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA):

Titulli i Gjetjes: Në pasqyrat e llogaridhënies vjetore të mbyllur me datën 31.12.2021, llogaria 212 "Ndërtesa" si dhe llogaria nr. 210 "Toka, troje e terrene" (për vitin 2020 dhe 2021) janë në vlerën zero lekë. Ekzistojnë dokumentacionet dhe planimetritë për sipërfaqet që mbulon godina që ka në dispozicion dhe përgjegjësi administrimi për periudhën objekt auditimi, Si rrjedhojë, nuk është regjistruar kjo sipërfaqe në kontabilitetin e AMA-s, ndonëse sipas VKM nr.468, dt 3.6.2015, Agjencia Shtetërore e Kadastrës është ngarkuar për regjistrimin e objektit dhe truallit, për llogari të institucionit të AMA-së.

Kjo çështje për grupin e auditimit konsiderohet materiale, pasi, bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë", (Harta sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016, faqe 973), vlera e pasurisë së paluajtshme të tokës truall për qytetin e Tiranës, (referuar çmimeve të vitit 2014), përcaktohet se **për zonën kadastrale ZK 8160**, çmimi është **33,755 lekë/m² x sipërfaqja 10,177 m² = 343,524,635 leke**, vlerë kjo që rezulton mbi prapenë të materialitetit sasior në auditim.



(Burimi: Harta e tokës dhe vlera e pasurive të paluajtshme për tokën truall, sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016, faqe 973)

Në referim të çmimit për m² për zonën kadastrale nr. 8160 sipas VKM nr. 89, datë 3.2.2016 duhet të ishin kryer përlllogaritjet dhe evidentimet e vlerës së truallit në kontabilitetin e njësisë shpenzuese, nga zero lekë e pasqyruar në bilancin e periudhës që auditohet.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

I.b-Evidentimi në kontabilitet i tokave bujqësore, (auditimi i KLSH në MZHBR):

Titulli i Gjetjes: Nga auditimi u konstatua se, sipërfaqet e tokës bujqësore të dhëna me qira janë siguruar në mbështetje të Vendimeve të Këshillit të Ministrave si vijon:

(i) VKM nr.995, datë 9.12.2015, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 926.55 Ha, në pronësi shtetërore, dhënë në përdorim Komunave Buçimas, Çërravë dhe Udenisht dhe për disa ndryshime në Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.244, datë 4.4.2012, nr.417, datë 8.6.2011 dhe nr.534, datë 1.5.2008" ka kaluar në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së toka bujqësore në pronësi të shtetit me sipërfaqe 926,55 Ha.

(ii) VKM nr.45, datë 29.01.2014 "Për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe institucioneve kërkimore shkencore të kësaj ministrie aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave", pika 1, ka kaluar në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së toka bujqësore në pronësi të shtetit me sipërfaqe 18,076 Ha.

(iii) VKM nr.142, datë 24.2.2016 "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të sipërfaqes së tokës bujqësore, në pronësi të shtetërore, në fshatin Vojnik, Njësia Administrative Maqellarë, Bashkia Dibër" ka kaluar në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së toka bujqësore në pronësi të shtetit me sipërfaqe 31,4 Ha, pasuria nr.2/17, Zona Kadastrale 3811.

Sa më sipër, fondi i tokës bujqësore në pronësi të shtetit në përgjegjësi administrimi të MBZHR është 19,033.95 ha.

Nga kjo sipërfaqe, janë dhënë me qira nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për periudhën 2013-2021 sipërfaqja prej 2,519 ha e 7,366 m².

Gjithashtu nga fondi i disponueshëm i tokave në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së, është kaluar sipërfaqja prej 617,68 ha nën administrim të AIDA-s, për zhvillimin e investimeve strategjike të programuara.

Për periudhën 2019-2021 është dhënë me qira sipërfaqja prej 714 ha e 3,484 m².

Aktualisht sipërfaqja e lirë e disponueshme në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së, për t'u dhënë me qira, është 15,896 ha e 5, 334 m².

Në bazë të ligjit nr.8318 datë 01.04.1998 "Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetërore" i ndryshuar, neni 17, shprehet se, rregjistrimi i kontratës së dhënies me qira të tokës në Zyrën e Rregjistrimit të Pasurisë së Paluajshme, është i përjashtuar nga pagesa e tarifës.

Ndërsa për pjesën e sipërfaqeve të lira në administrim nga MBZHR, të përfituara sipas VKM-të e mësipërme, u konstatua se, gjendja juridike e sipërfaqes së lirë prej 15 896 ha e 5334m² është e pa rregjistruar pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, duke rritur riskun e tjetërsimit të pronave bujqësore, nga palë të treta. Ndërsa sipërfaqja prej 3137 ha është rregjistruar, në momentin kur ka filluar procedura e dhënies me qira të tokës bujqësore nga MBZHR, por nga auditimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 dhe 2020, llogaria (210) "toka, troje" figuron në vlerën 0 lekë.

Kjo situatë është e mbartur në vite në Ministrinë e Bujqësië dhe nga struktura përgjegjëse të saj, nuk është ndërmarrë asnjë masë për rregjistrimin e sipërfaqes në pronësi.

-Lidhur me fondin e tokës bujqësore disponibël shtetërore, objekt i VKM-së nr. 45/2014, "Për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe ish-institucioneve kërkimore-



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

shkencore të kësaj ministrie, aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”.

Nga auditimi u konstatua se, me shkresë nr.7254 prot datë 24.09.2019 të MBZHR nga Sekretari i Përgjithshëm, i është kërkuar Këshillit të Ministrave, vënia në dispozicion të kopjes së njehësuar me origjinalin e listës së inventarit për pasuritë përfshirë në Vendimin nr.45, datë 29.01.2014 të Këshillit të Ministrave, por nga Këshilli i Ministrave nuk ka pasur asnjë përgjigje në lidhje mbi këtë kërkesë.

Konstatim nr.12:

Nga analiza e pasqyrave financiare të gjeneruar nga Sistemi Informativ Financiar i Qeverisë (SIFQ) rezulton se për vitin 2020 dhe 2021, pasqyrat individuale të llogaridhënies vjetore në 10 institucione qendrore (Ministri dhe aparati i Kryeministrit) nga 12 gjithsej të përfshira në analizë, nuk kanë zbatuar përcaktimet e paragrafit 15, pika 3.1, kreu III” Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, të Udhëzimit Nr. 5, datë 21.2.2022 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, për kryerjen e veprimeve kontabile në lidhje me **llogarinë nr. 4864, “Shpenzime të periudhave të ardhshme”**, (mbi ndryshimin e paragrafit 42, pika 3.1, kreu III” Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”), ku përcaktohet shprehimisht se:

Seksioni 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Paragrafi 42 ndryshon si vijon:

Degët e Thesarit regjistruar në SIFQ raportin/listën e faturave të siguruar sipas pikës 6 (b) të këtij udhëzimi lidhur me detyrimet e prapambetura të njësive të qeverisjes së përgjithshme ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara për shkak të mungesës së fondeve publike. Për të evidentuar këto detyrime, degët e thesarit përdorin Llogarinë kontabël 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme", funksionimi i të cilit caktohet me udhëzim të veçantë dhe vetëm për qëllime monitorimi të performancës financiare të njësive të qeverisjes së përgjithshme. Regjistrimet e thesarit në Llogarinë 486 nuk janë pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar që prodhohet nga SIFQ në nivel njësie shpenzuese, ose njësie publike qendrore ose vendore për efekte rakordimi me këto të fundit.

Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, përpara mbylljes së llogarive vjetore 2021, kryejnë veprimin e mbylljes së llogarisë 4864 "Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura" në debi të llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm" për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në këto llogari në datën 31 Dhjetor 2021.

Të gjitha detyrimet e prapambetura të regjistruara në Llogarinë 4864 deri në fund të periudhës ushtrimore 2021 konsiderohen detyrime të prapambetura të trashëguara nga vitet e kaluara.

Më konkretisht,

Tabela nr. Institucionet që nuk kanë kryer veprimet kontabile të mbylljes së llogarisë 486 dhe rezultojnë me gjendje në PF individuale vjetore:

Nr	Emërtimi i institucionit Qendror	31.12.2021	31.12.2020
1.	Aparati i Kryeministrit	0	0



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

2.	MASH Tiranë	4,213,846	14,374,559
3.	M.Brendshme Tiranë	7,353,150	6,626,184
4.	MBZHR Tiranë	28,414,200	25,000,000
5.	MD Tiranë	101,540,505	101,540,505
6.	MFE Tiranë	3,600,000	8,794,114
7.	MIE Tiranë	1,305,132,866	993,241,300
8.	M.Kulturës Tiranë	31,674,611	31,674,611
9.	M.Mbrojtjes Tiranë	1,204,644	0
10.	MPJ Tiranë	0	0
11.	MSHMS Tiranë	33,494,422	60,363,463
12.	MTM Tiranë	1,406,020	80,623,172

Të dhënat në lekë

Burimi: MFE, DPTH (Pasqyra financiar të gjeneruara nga SIFQ), përpunuar nga grupi i auditimit

II. Situata konkrete nga verifikimet e grupit të auditimit të KLSH-së mbi evidentimin kontabël të Aktiveve Afatgjata Materiale: Problematikat mbi pasqyrimin në kontabilitet të vlerës së Aktiveve Afatgjata Materiale (llogaria 212) “Ndërtesa”:

• *Institucioni i Kuvendit të Shqipërisë:*

Llogaria 212, “Ndërtime dhe rikonstruksione” është e kontabilizuar për vitin 2020 për vlerën neto prej 237,6 milionë lekë dhe në vitin 2021 për 247 milionë lekë, *përkatësisht:*

Të dhënat në lekë

Llogaria	Përshkrimi	Viti 2021	Viti 2020
212	Ndërtesa Konstruksione	246,403,952	237,618,240

Burimi: Kuvendi i Shqipërisë, Shërbimi Financës dhe Buxheti, PF v.2021, formati F1

Titulli i gjetjes:

Pasaktësi në evidentimin në kontabilitet të vlerës së ndërtesave dhe mospërputhje e sipërfaqeve të truallit me përcaktimet VKM-së që ka miratuar listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi Kuvendit të Shqipërisë. Në pasqyrat financiare të mbyllura më 31.12.2020 dhe 31.12.2021, Aktivët Afatgjata Materiale pasqyrojnë vetëm vlerat e investimeve për rikonstruksioneve të kryera në këto tre objekte ndërtimore. Kjo ka ndodhur, pavarësisht marrjes së masave nga administrata dhe shërbimet e institucionit të Kuvendit. Procedurat e transferimit dhe dorëzimit fizik të aktivitet afatgjatë material “Ndërtesa” janë kryer sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave, mirëpo mungojnë të dhënat mbi vlerën kontabile të godinës, me qëllim kontabilizimin e saj në Pasqyrat Financiare të institucionit të Kuvendit të Shqipërisë. Si rrjedhojë, Pasqyrat Financiare të llogaridhënies për zërin “Ndërtime e konstruksione”, kanë regjistruar vlerën prej 246,403 mijë lekë që i përket vetëm vlerës së rikonstruksioneve të kryera ndër vite.

Në regjistrin kontabël të pasurive të Kuvendit të Shqipërisë, nuk ishte regjistruar objekti në të cilin operon institucioni i Kuvendit dhe godina e Sallës Plenare. Kjo ka ndodhur, pavarësisht marrjes së masave nga administrata dhe shërbimet e institucionit të Kuvendit. Nuk është evidentuar në pasqyrat financiare të mbyllura për periudhën 1.1.2017 deri më 31.12.2021 vlera e plotë dhe të saktë kontabile e llogarisë ekonomike 212 “Ndërtesa” tek AQT e institucionit. Procedurat e transferimit dhe dorëzimit fizik të aktivitet afatgjatë material “Godinë” janë kryer



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave, mirëpo mungojnë të dhënat mbi vlerën kontabile të godinës, me qëllim kontabilizimin e saj në Pasqyrat Financiare të institucionit të Kuvendit të Shqipërisë. Rezultoni se në kontabilitet dhe në pasqyrat e llogaridhënies vjetore dhe regjistrin e Aktiveve Afatgjata Materiale janë pasqyruar vetëm vlerat e investimeve për rikonstruksioneve të kryera në këto objekte ndërtimore.

Si rrjedhojë, Pasqyrat Financiare të mbyllura me datën 31.12.2020 dhe 31.12.2022 nuk kanë të pasqyruara në kontabilitet vlerën e drejtë e të saktë në pasqyrën e pozicionit financiar për zërin “Ndërtime e konstruksione”, pasi kjo llogari (llog. 212 “Ndërtesa dhe rikonstruksione”) është pasqyruar për vlerën 246,403 mijë lekë që ka regjistruar vetëm vlerën e rikonstruksioneve të kryera.

Sa sipër është në mospërputhje të paragrafit nr.21, të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit SKK 1 “Kuari i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”, që ka përcaktuar se, “vetëm ato aktive, kostoja e të cilëve mund të përcaktohet me besueshmëri, njihen në pasqyrën e pozicionit financiar”.

SKK nr.5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”

Paragrafi 20 “Një klasë AAM, vlera e drejtë e së cilave mund të matet me besueshmëri, paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar me shumën e rivlerësuar, e cila është vlera e drejtë në datën e rivlerësimit, pakësuar në periudhat në vijim me amortizimin e akumuluar të mëpasshëm dhe humbjet e akumuluar të mëpasshme nga zhvlerësimi. Rivlerësimet duhet të kryhen rregullisht, në mënyrë që vlera kontabël të mos ndryshojë materialisht nga vlera që do të rezultonte nëse vlerësimi i AAM-së, në datën e raportimit do të bëhej me vlerën e drejtë.

Paragrafi 21, “Vlera e drejtë e truallit dhe ndërtesave zakonisht përcaktohet mbi bazën e treguesve të tregut nëpërmjet vlerësimeve të kryera nga vlerësues profesionistë të kualifikuar. Vlera e drejtë e elementeve të AAM-së është zakonisht vlera e tyre e tregut e përcaktuar nga vlerësuesit.

- **Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)**

*Titulli i Gjetjes: Në pasqyrat financiare të mbyllura më 31.12.2020 dhe 31.12.2021, Aktivet Afatgjata Materiale pasqyrojnë **vetëm vlerat e investimeve për rikonstruksioneve të kryera në këtë objekt ndërtimor.** Procedurat e kalimit në përgjegjësi administrimi dhe transferimit dhe dorëzimit fizik të aktivitet afatgjatë material “Ndërtesa” nuk janë dokumentar rregullisht sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave, pasi mungojnë të dhënat mbi vlerën kontabile të godinës, me qëllim kontabilizimin e saj në Pasqyrat Financiare të institucionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Si rrjedhojë, Pasqyrat Financiare të llogaridhënies vjetore për zërin “Ndërtime e konstruksione”, kanë regjistruar në fund të v.2021 vlerën neto prej 82.4 mln lekë që i përket vetëm vlerës së rikonstruksioneve të kryera ndër vite.*

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.468, datë 03.06.2015 ka kaluar në përgjegjësi administrimi nga Radio Televizioni Shqiptar tek Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) objektin me emërtimin “Atelier për Dekorin e Radio Televizionit”, në zonën kadastrale nr. 8160 me numër pasurie 2/94, me sipërfaqe. totale 10,177 m2 dhe sipërfaqe ndërtese 6,202 m2. Në këtë vendim nuk është përcaktuar vlera e asetëve të transferuara. Nga ana e AMA-s janë kryer rikonstruksione dhe riparime që kanë përfshirë në Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara të periudhes 2016-2022, vetëm vlerën e situacioneve të likuiduara dhe nuk është përfshirë vlera tjetër e objektit sipas



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

Vendimit të Këshillit të Ministrave. Veprimi i mësipërm shtrembëron vlerën e aktiveve të Institucionit si edhe të shpenzimeve të amortizimit, që duhen llogaritur për këtë aktiv.

Si rrjedhojë, Pasqyrat Financiare të mbyllura me datën 31.12.2020 dhe 31.12.2022 nuk kanë të pasqyruara në kontabilitet vlerën e drejtë e të saktë në pasqyrën e pozicionit financiar për zërin “Ndërtime e konstruksione”, pasi kjo llogari (llog. 212 “Ndërtesa dhe rikonstruksione”) është pasqyruar për vlerën 246,403 mijë lekë që ka regjistruar vetëm vlerën e rikonstruksioneve të kryera.

Sa sipër është në mospërputhje të paragrafit nr.21, të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit SKK 1 “Kuatridhe i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”, që ka përcaktuar se, “vetëm ato aktive, kostoja e të cilëve mund të përcaktohet me besueshmëri, njihen në pasqyrën e pozicionit financiar”.

SKK nr.5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”.

• **Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI):**

Mos-transferim i aktiveve IT nga MFE tek AKSHI, sipas përcaktimeve të akteve ligjore.

Procedurat e prokurimit si dhe lidhja e kontratave për mallrat apo shërbimet në fushën e teknologjisë së informacionit, janë zhvilluar dhe nënshkruar nga AKSHI, ndërsa vetë investimi si dhe detyrimi financiar kalojnë dhe i takojnë MFE, sipas VKM Nr.673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar, saktësisht në pikën 18, citohet se: “Institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave duhet të dorëzojnë pranë AKSHI-t 1 (një) kopje të dokumentacionit të plotë të çdo sistemi dhe infrastrukture TIK ekzistuese dhe kodin e burimit. Sistemet dhe infrastruktura TIK ekzistuese kalojnë nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse brenda datës 30 shtator 2018”. Në zbatim të kërkesave të VKM Nr.673, nga MFE dhe AKSHI janë ndërmarrë hapat e mëposhtëm: - Me Urdhër të përbashkët të Sekretarit të Përgjithshëm të MFE dhe Drejtorit të Përgjithshëm të AKSHI-t, me Nr.5762 prot., datë 21.03.2018 (MFE) dhe Nr.1311 prot., datë 16.03.2018 (AKSHI), janë ngritur grupet e punës për evidentimin e sistemeve IT dhe infrastrukturave hardware të MFE, si dhe përcaktimin e listës së aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara objekt kalimi kapital...Krahas grupeve të ngritura, ngarkohen për zbatim të urdhrimit edhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në MFE dhe Sektori i Financës tek AKSHI. Afati për zbatim të urdhrimit është data 30.03.2018. - Me shkresën Nr.1649 prot., datë 06.04.2018, Drejtori i Përgjithshëm i AKSHI-t ka vënë në dijeni MFE për mosvënien ende në dispozicion të dokumentacionit përkatës lidhur me kalimin kapital të këtyre aktiveve nga ana e grupit të punës së MFE, edhe pse është tejkaluar afati 30.03.2018 i përcaktuar. - Me Urdhër të Brendshëm Nr.234, me Nr.2520 prot, datë 31.05.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKSHI-t, është caktuar grupi i punës për evidentimin e infrastrukturave hardëare dhe sistemeve IT të MFE, si dhe marrjen në dorëzim të këtyre sistemeve, infrastrukturave hardware si dhe dokumentacionit përkatës lidhur me to.

Edhe pse ka kaluar disa vite nga nxjerrja e urdhrimit të përbashkët për kalimin e kapitalit dhe afati i vendosur në VKM Nr.673, ky proces ende nuk ka përfunduar. Aktualisht sistemet e IT dhe infrastruktura hardware e MFE, janë ende pjesë e aktiveve të MFE-së, e për pasojë edhe detyrimet juridike dhe financiare mbi këto sisteme, në kundërshtim me pikën 18, të VKM nr.673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

• Shoqëritë Anonime në likuidim e sipër:

Perfshirja e tre shoqërive, “Ak.sha në likuidim e sipër”, “Ab.sha në likuidim e sipër”, “Am.sha në likuidim e sipër”, që janë klasifikuar si subjekte apo njësi shpenzuese ekstra-buxhetore, dhe që përfitojnë fonde të konsiderueshme nga buxheti i shtetit.

Shoqëria Anonime “Am” Sh.a, në krijimin e saj, nuk ka trashëguar dokumentacionin e duhur për asetet e gjashtë Sh.a-ve bashkëthemeluese të saj, (të tilla si, harta topografike, planimetri të minierave, koordinata të vendndodhjes së punimeve minerare, etj.). Kjo situatë e mungesës së dokumentacionit teknik ka krijuar probleme për administrimin e asetëve të kësaj shoqërie dhe për përcaktimin e saktë të zonave minerare të rrezikshme në territoret ne juridiksionin e saj. Bashkimi i 6 (gjashtë) Sh.a-ve, bashkëthemeluese të “Am” Sh.a., është realizuar nga bashkimi i vlerave të bilanceve të ish-shoqërive, në të cilët vlerat e pasqyruara me postet e aktivitetit dhe pasivitetit rezultojnë pa analizë, pa mbështetje dhe rakordim me inventare të rregullta të vlerave të Aktiveve Qarkullueshme të Trupëzuara dhe Aktiveve Qarkulluese. Rrjedhimisht, shoqëria ka trashëguar një bilanc jo realist nga shoqëritë anonime bashkëthemeluese të “Am” Sh.a.

Konstatime:

1. Bashkimi i gjashtë sh.a-ve, bashkëthemeluese të “Am” Sh.a, është realizuar nga bashkimi formal matematikor, i vlerave të bilanceve të ish-shoqërive, në të cilët, **vlerat e pasqyruara me postet e aktivitetit dhe pasivitetit rezultojnë pa analizë, pa mbështetje dhe rakordim me inventarë të rregullt të vlerave të Aktiveve Qarkullueshme të Trupëzuara dhe Aktiveve Qarkulluese.**

Rrjedhimisht, sipas testimeve të kryera mbi verifikimin e saktësisë së të dhënave të kontabilitetit, por edhe sipas raporteve të ekspertëve kontabël të autorizuar, është trashëguar në bilanc joreal i kësaj Shoqërie, nga Shoqëritë Anonime bashkëthemeluese të “Am” Sh.a, pasi;

- ✓ *Bashkimi i bashkëthemelueseve është shoqëruar, krahas të tjerave dhe me mungesë pothuajse totale, jo vetëm të dokumentacionit ekonomik - financiar, por dhe atij teknik, (si, harta topografike, planimetri të minierave, koordinata të vendndodhjes së punimeve minerare, etj.), si për objektet ndërtimore sipërfaqësore dhe për punimet minerare të 34 minierave në juridiksionin e Shoqërisë., duke krijuar probleme të vazhdueshme në administrimin e asetëve të Shoqërisë, por dhe në përcaktimin e saktë të zonave minerare të rrezikshme në territoret e juridiksionit të kësaj shoqërie.*
- ✓ *Nuk kanë patur bilance ekonomike të sakta, për periudhën kur ato kanë funksionuar si subjekte më vete.*
- ✓ *Llogaritë inventariale të tyre kanë qenë të paargumentuara.*
- ✓ *Detyrimet debitore e kreditore të shoqërive anonime, bashkë-themeluese të “Am” Sh.a, kanë qenë të pashoqëruara me dokumentacion bazë e origjinal justifikues (fletë-dalje, fatura, kontrata etj).*
- ✓ *Ne bilancin e Shoqërisë janë përfshirë dhe objekte ndërtimore sipërfaqësore të cilat, në momentin e themelimit të saj ishin të zëna nga banorë, etj.*

2. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion të audituesve të autorizuar të KLSH, **mbi 352** aktive afatgjata/ pasuri sipërfaqësore që administrohen nga “Am” sha në likuidim e sipër, me vlerë fillestare në kontabilitet prej **499,724,696 lekë gjithësej**, në fakt janë të kontabilizuara sipas të dhënave që i përkasi periudhës **1970 e në vijim** dhe kjo tregon për mospërputhje të gjendjes faktike të objekteve pasuri shtetërore me konfirmimin e dokumentacionit financiar dhe se ky informacion kontabël nuk pasqyron gjendjen e vërtetë vlerore të këtyre pasurive. Kështu, janë raportuar nga “Am” me status të ndryshëm aktive në Sektorin Tiranë, Degën Pogradec, Korçë,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

etj., të tilla si, *zënë nga banorët, dëmtuar, përdoret nga C.E.Z, përdoret nga komuna, dëmtuar 80%, ekzistojnë vetëm muret anësore, ekziston vetëm një rresht me kolona, zënë nga banorët, ekziston vetëm si truall, dëmtuar pjesërisht (në këtë kategori janë rreth 70-80 % e aktiveve që janë në inventarin e shoqërisë) etj.*

Referuar dhe dokumentacionit zyrtar të administruar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (raporti bashkëlidhur shkresës nr. 23652/7 prot, e kësaj ministrie, datë 8.3.2021), **rezultojnë 613 pasuri të miratuara për privatizim ndër vite, për të cilat procesi i vlerësimit nuk ka vijuar për arsye të ndryshme.**

3. Procesi ligjor i likuidimit të këtyre shoqërive është vonuar dhe tejzgjatur dhe nuk është përfunduar në kohë, deri në shkrirjen dhe çrregjistrimin përfundimtar të këtyre shoqërive.

Shpenzimet që i ngarkohen buxhetit të shtetit për kostot e stafit administrativ të minierave me status “*Sha në likuidim e sipër*” janë të konsiderueshme. Ndaj rekomandohet që, të studiohet mundësia e bashkimit me anë të përthithjes së të këtyre tre sha-ve që operojnë në sektorin e industrisë minerare, në një shoqëri më vete, e cila duhet të realizojë procedurat e likuidimit të shoqërisë dhe të përjashtohet nga skema e financimit buxhetor.

Konstatim nr.13:

Nga auditimi i zërave të pasqyrave financiare të depozitura në MFE , së paku në tre institucione shpenzuese buxhetore, (Bashkia Fier, Qendra Kombëtare e Kinematografisë, Agjensia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve), zëri “Aktiveve Neeto/ Fondet Neto” nuk përputhen me zërin “Fondin e Konsoliduar” në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në kundërshtim me përcaktimet e UMFE nr.8, datë 9.3.2018, ndryshuar me UMFE nr 5, datë 21.2.2022.

Më hollësisht,

-Me shkresë nr.3599 prot datë 29.04.2022, Bashkia Fier ka depozituar pranë Ministrisë së Financës pasqyrat financiar të konsoliduar për vitin 2021 dhe me shkresë nr.3749 datë 28.04.2023 ka depozituar pasqyrat financiar të konsoliduar për vitin 2022.

-Me shkresë nr.1750 prot datë 10.03.2022 Qendra Kombëtare e Kinematografisë ka depozituar pranë Ministrisë së Financës pasqyrat financiar të konsoliduar për vitin 2021.

-Me shkresë nr.2879/31 prot datë 30.03.2023 Agjensia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ka depozituar pranë Ministrisë së Financës pasqyrat financiar të konsoliduar për vitin 2022.

Nga Auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduar konstatohen problematika si me poshtë vijon: **Bashkia Fier** për vitin 2021 konstatohet se Aktiviteti neto/fondet në total është në shumën 9,784,144,788 ndërkohe që fondi i konsoliduar total është në vlerën 10,132,229,543 me një diferencë prej 348,084,755 lekë, dhe në pasqyrat financiare të konsoliduar për vitin 2022 konstatohet e njëjta problematik aktiviteti neto/fondet në total është në shumën 11,395,909,398 ndërkohe që fondi i konsoliduar total është në vlerën 12,040,625,758 me një diferencë prej 644,716,360 lekë.

Qendra Kombëtare e Kinematografisë për pasqyrat financiar të vitit 2021 konstatohet se Aktiviteti neto/fondet në total është në shumën 17,648,279 ndërkohe që fondi i konsoliduar total është në vlerën 17,537,450 me një diferencë prej 110,829 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

Agjensin Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve për pasqyrat financiare të vitit 2022 konstatohet se Aktivi neto/fondet në total është në shumën 27,679,135 ndërkohe që fondi i konsoliduar total është në vlerën 55,693,022 me një diferencë prej 28,013,887 lekë.

Pasqyrave financiare të konsoliduar për vitin 2021			
Bashkia Fier		Qendra Kombëtare e Kinematografisë	
Aktivi neto/fondet	fondi i konsoliduar	Aktivi neto/fondet	fondi i konsoliduar
9,784,144,788	10,132,229,543	17,648,279	17,537,450
diferenca	-348,084,755	diferenca	110,829

Pasqyrat financiare të konsoliduar për vitin 2022			
Bashkia Fier		Agjensin Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve	
e	fondi i konsoliduar	Aktivi neto/fondet	fondi i konsoliduar
11,395,909,398	12,040,625,758	27,679,135	55,693,022
diferenca	-644,716,360	diferenca	-28,013,887

Konstatim nr.14:

Nga auditimi i mbi verdikimin e ekzistencës së aktiveve, rezultoi se Ministria e Financës dhe Ekonomisë nuk ka realizuar proceset e inventarizimit për vitin 2021 dhe 2022.

Titulli gjetjes:	Ministria e Financës dhe Ekonomisë nuk ka realizuar proceset e inventarizimit për vitin 2021 dhe 2022.
Situata:	Grupi i auditimit konstatoi se për periudhën 2021-2022 nuk janë realizuar proceset e inventarizimit për Ministrin e Financës dhe Ekonomisë. Gjithashtu komisioni i ngritur me nr.6583 prot datë 12.04.2021 për vlerësim e aktiveve të identifikuar për nxjerrje nga përdorimi nga komisionet e inventarizimi të vitit 2017 dhe 2019 nuk ka realizuar procesin e plotë pasi ka vlerësuar vetëm aktivet e propozuar për nxjerrje nga përdorimi për vitin 2017 dhe jo të vitit 2019.
Kriteri:	<i>UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar. Pika 74 ,95 dhe 96. urdhëri nr. 6583 prot datë 12.04.2021 pika 3.</i>
Ndikimi/Efekti	Pasqyrat financiare nuk sigurojnë të dhënave të plota dhe nuk paraqesin, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje, në regjistrat kontabël.
Shkaku:	Mungesë veprimesh nga strukturat përgjegjëse.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi:	- Titullari i institucionit të marrë masa për kryerjen e inventarëve në fund të çdo viti ushtrimor, duke caktuar në përbërje të komisioneve të inventarizimit të aktiveve specialistë të fushës, me qëllim kryerjen e inventarizimit me cilësi, pasqyrim të drejtë të procesit të inventarizimit,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

	<p>vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve.</p> <p>- Institucioni të ndjekë hapat e mëtejshëm bazuar në konkluzionet e grupi te inventarizimit (nr.1996/2 datë 19.06.2019) për procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese, duke bërë të mundur kështu përfundimin e procesit te inventarizimit si dhe heqjen nga kontabiliteti referuar masave te cilat do merren për aktivet e vlerësuara për tu nxjerrë jashtë përdorimit.</p>
--	---

Gjetje: Grupi i auditimit konstatoi se për periudhën 2021-2022 nuk janë realizuar proceset e inventarizimit për Ministrin e Financës dhe Ekonomisë. Gjithashtu komisioni i ngritur me nr.6583 prot datë 12.04.2021 për vlerësim e aktiveve të identifikuar për nxjerrje nga përdorimi nga komisionet e inventarizimi te vitit 2017 dhe 2019 nuk ka realizuar procesin e plotë pasi ka vlerësuar vetëm aktivet e propozuar për nxjerrje nga përdorimi për vitin 2017 dhe jo te vitit 2019.

Rekomandimi 1: Titullari i institucionit të marrë masa për kryerjen e inventarëve në fund të çdo viti ushtrimor, duke caktuar në përbërje të komisioneve të inventarizimit të aktiveve specialistë të fushës, me qëllim kryerjen e inventarizimit me cilësi, pasqyrim të drejtë të procesit të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve.

Rekomandimi 2: Institucioni të ndjekë hapat e mëtejshëm bazuar në konkluzionet e grupi te inventarizimit (nr.1996/2 datë 19.06.2019) për procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese, duke bërë të mundur kështu përfundimin e procesit te inventarizimit si dhe heqjen nga kontabiliteti referuar masave te cilat do merren për aktivet e vlerësuara për tu nxjerrë jashtë përdorimit.

III. Parregullsitë apo mospërputhjet në shifrat e dërguara MFE-së, për institucionet e analizuara, që kanë dorëzuar në MFE pasqyrat fizike të llogaridhënies vjetore për vitin 2022, kanë të bëjnë çështjet si më poshtë:

1. Nga ana e institucionit “**Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave**” Tiranë, me shkresën nr.424 prot, datë 30.3.2023, janë depozituar pasqyrat financiare të njësisë shpenzuese për vitin 2022, protokolluar në MFE me nr.6435 datë 06.04.2023. Vlera e AAM dhe AAJM në Pasqyrën e konsoliduar të Pozicionit Financiar (Formati nr.1) është përkatësisht prej 65,590 mijë dhe 11,571 mijë lekë, të cilat përputhen me vlerën e regjistruar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e AAGJ” (me vleren neto). Vlera e llogarisë toka, troje e terrene është e njëjte për dy vitet prej zero lekë, kurse llog.212 “Ndërtesa evidentohet për 2,537 mijë lekë. Llogaria 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” nuk rezulton me gjendje në PFV të v.2021 dhe v.2022. Seti i PFK kanë si pjesë të tyre pasqyren nr.5 “Shënime shpjeguese për PFK të vitit 2022”, por rubrikat e pyetësorit janë të pa plotësuara.
2. Nga ana e institucionit të “**Prokurorisë së Përgjithshme**”, me shkresën nr.291/17 prot, datë 27.04.2023, janë depozituar pasqyrat financiare të njësisë kontrolluese dhe konsoliduese për vitin 2022, depozituar në MFE me datë 22.05.2023. Në relacionin shpjegues thuhet se janë konsoliduar të dhënat e 29 njësisive shpenzuese (aparati + prokuroritë e rretheve). Vlera e AAM dhe AAJM në Pasqyrën e konsoliduar të Pozicionit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

- Financiar më 31.12.2022 (Formati nr.1) është përkatësisht prej 1,407,643 mijë dhe 1,463 mijë lekë, e cila përputhet me vlerën prej 1,407,643 mijë dhe 1,463 mijë lekë, të Pasqyres nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e AAGJ” (me vleren neto). Vlera e llogarisë toka, troje e terrene është e njëjte për dy vitet prej 162,2 milionë lekë. Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është në rreshtin nr.41 të F1 dhe ka të regjistruar tepricat debitore për cdo vit, përkatësisht prej 59,746 mijë në v.2021 dhe 88,456 mijë në v.2022. Seti i PFK kanë si pjesë të tyre pasqyren nr.5 “Shënime shpjeguese për PFK të vitit 2022”.
3. Nga ana e institucionit të **“Presidentit të Republikës”**, me shkresën nr.1007 prot, datë 13.03.2023, janë depozituar pasqyrat financiare të njësisë shpenzuese për vitin 2022, protokolluar në MFE me nr.4978, datë 13.3.2023. Bashkëlidhur këtyre pasqyrave është relacioni shpjegues. Pasqyrat financiare janë depozituar rregullisht edhe në Degen e Thesarit Tiranë me nr. 787/54, dt 10.03.2023. Vlera e AAM dhe AAJM në Pasqyrën e konsoliduar të Pozicionit Financiar më 31.12.2022 (Formati nr.1), është përkatësisht prej 302,932 mije dhe 0 lekë, e cila përputhet me vlerën e shënuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e AAGJ” (me vleren neto). Vlera e llogarisë toka, troje e terrene (llog.210) është e njëjte për dy vitet prej zero lekë. Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është në rreshtin nr.41 të F1 dhe ka të regjistruar tepricat debitore për të njëjtën vlerë në të dy vitet, përkatësisht prej 102 mijë lekë si për v.2021, ashtu edhe për v.2022. Seti i PFK kanë si pjesë të tyre pasqyren nr.5 “Shënime shpjeguese për PFK të vitit 2022”.
 4. Nga ana e institucionit të **“Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar”**, me shkresën nr.945 prot, datë 29.3. 2023, janë depozituar pasqyrat financiare të njësisë për vitin 2022, protokolluar në MFE me nr.787/2307 datë 29.03.2023. Vlera e llogarisë toka, troje e terrene është e njëjte për dy vitet prej zero lekë, ndërsa vlera e ndertesave është 30,186 mijë lekë. Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është në rreshtin nr.41 të F1 dhe nuk rezulton me gjendja në PFV të v.2021 dhe v.2022. Seti i PFK kanë si pjesë të tyre pasqyren nr.5 “Shënime shpjeguese për PFK të vitit 2022”.
 5. Nga ana e institucionit të **“Autoritetit të Mediave Audiovizive” (AMA)**, e cila është subjekt shtetëror jo buxhetor, me shkresën nr.1416 prot, datë 31.03.2023, janë depozituar pasqyrat financiare individuale të vitit 2022, protokolluar në MFE me nr.6353, datë 5.4.2023. Pasqyrat financiare janë miratuar nga bordi i AMA me vendimin nr. 20, datë 24.03.2023. Vlera e AAM për llogarinë 210 “Toka, troje e terrene” është e njëjte për dy vitet prej zero lekë, kurse vlera e llogarisë 2012 “ndertesat” ka të pasqyruar vetëm vlerën e rikonstruksioneve dhe jo vlerën e objektit . Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është në rreshtin nr.41 të F1 dhe nuk rezulton me gjendja në PFV të v.2021 dhe v.2022. Seti i PFK kanë si pjesë të tyre pasqyren nr.5 “Shënime shpjeguese për PFK të vitit 2022”.
 6. Nga ana e institucionit të **“Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” (ILD)**, me shkresën nr.955 prot, datë 27.03.2023, janë depozituar pasqyrat financiare individuale të njësisë shpenzuese për vitin 2022, protokolluar në MFE me nr.2879/30, datë 30.03.2022. Vlera e AAM dhe AAJM në Pasqyrën e konsoliduar të Pozicionit Financiar (Formati nr.1) është përkatësisht prej 547,287 mijë dhe 1,881 mijë lekë, e cila përputhet me vlerën e referuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e AAGJ” (me vleren neto). Vlera e AAM për llogarinë 210 “Toka, troje e terrene” është e njëjte për dy vitet prej zero lekë, kurse vlera e llogarisë 2012 “ndertesat” ka të pasqyruar vlerën 520,528 mijë lekë. Llogaria 486



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

- “Shpenzime te periudhave te ardhshme” është në rreshtin nr.41 te F1 dhe ka të regjistruar tepricat debitore per çdo vit, përkatësisht prej 11,377 mijë lekë në v.2021 dhe 113,700 mijë në v.2022. Seti i PFK kanë si pjesë të tyre pasqyren nr.5 “Shënime shpjeguese për PFK të vitit 2022”.
7. Nga ana e institucionit të **“Rrjetit Akademik Shqiptar” (RRASH)**, me shkresën nr.128 prot, datë 31.3.2023, janë depozituar pasqyrat financiare të njësisë për vitin 2022, protokolluar në MFE me nr.6183, datë 3.4.2023. Nga audiuesit e autorizuar të KLSH u auditua rakordimi i vlerave të AAM dhe AAJM në bazë të Pasqyrës së Pozicionit Financiar (Formati nr.1), që janë përkatësisht prej 74,326 mijë dhe 120 mijëlekë, e cila nuk përputhet me vlerën e regjistruar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e AAGJ” (me vleren neto), ku janë evidentuar për AAJM vlera prej 120 mijë lekë(OK) kurse për AAM vlera prej 18,649 mijë lekë (dhe si rrjedhojë totli i kësaj pasqyre është 18,769 mijë lekë, me mospërputhje dhe mungesë kuadrimi me Pasqyren e Pozicionit Fianciar. Vlera e llogarisë toka, troje e terrene është e njëjte për dy vitet prej zero lekë, kur vlera e llog 212 “Ndertesa” është kontabilizuar për 13,762 mijë. Llogaria 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” është në rreshtin nr.41 te F1 është zero lekë në v.2021 dhe v.2022. Seti i PFK kanë si pjesë të tyre pasqyren nr.5 “Shënime shpjeguese për PFK të vitit 2022”.
8. Nga ana e institucionit **“Drejtorja e Përgjithshme Detare Durrës**, me shkresën nr.453 prot, datë 23.3.2023, janë depozituar pasqyrat financiare individuale për vitin 2022, protokolluar në MFE me nr.2879/28, datë 29.03.2023. Vlera e AAM dhe AAJM në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (Formati nr.1) përputhet me vlerën e regjistruar të Pasqyres nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e AAGJ” (me vleren neto). Vlera e llogarisë toka, troje e terrene është e njëjte për dy vitet prej zero lekë, kur vlera e llogarisë 212 “Ndertesa” është 188,929 mijë lekë. Nga audiuesit e autorizuar të KLSH u auditua rakordimi i vlerave të AAM dhe AAJM në bazë të Pasqyrës së Pozicionit Financiar (Formati nr.1), me të dhënat e ngarkuara në Sistemin Informativ Financiar të Qeverisë (SIFQ), dhe rezultoi se rakordojnë në mbyllje të ushtrimit më 31.12.2022 të dhënat e bilancit vjetor (F1) me ato të ngarkuar në SIFQ për llogaritë: 202, 212,213,214,215, dhe 218. Konstatohet se, **ka pasaktësi dhe mospërputhje në lidhje me vlerën e regjistruar në Pasqyrën nr. 1 “Pozicionit Financiar” (ku llogaria 231 “Shpenzime per investimet afatgjata materiale” në rreshtin nr. 64 të bilancit ka të evidentuara tepricat më 31.12.2021 për vlerën neto 37,128 mijë dhe më 31.12.2022 për 2,768 mijë lekë, ndërkohë që në pasqyrën e ngarkuar në SIFQ, teprica e logarisë 231 në SIFQ më 31.12.2021 është 37,128 mijë lekë (e njëjtë me bilancin e v.2021), por teprica e datë 31.12.202 është 64,857 mijë lekë (ku shtesat nga viti 2022 në SIFQ janë 27,7728 mijë lekë. Sa sipër, ekzistojnë mospërputhje dhe mungesë kuadrimi me Pasqyren e Pozicionit Fianciar me të dhënat e SIFQ për v.2022 për këtë llogari. Llogaria 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” është zero lekë për dy vitet. Seti i PFK kanë si pjesë të tyre pasqyren nr.5 “Shënime shpjeguese për PFK të vitit 2022”.**
9. Nga ana e institucionit të **“Komisioni i Prokurimeve Publike” Tiranë**, me shkresën nr.671 prot, datë 30.3.2023, janë depozituar pasqyrat financiare të subjektit për vitin 2022, protokolluar në MFE me nr.6182, datë 3.4.2023. Konstatohet se në bilancin e vitit 2022 zëri i Aktiveve Neto (rreshti 96, kolona C e Formatit F1) është e kuadruar me zërin “Fondi i Konsoliduar” të asaj pasqyre për 33,829 mijë lekë më 31.12.2022. Rezulton se vlera e AAJM dhe AAM në Pasqyrën e konsoliduar të Pozicionit Financiar (Formati nr.1) është



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

përkatësisht prej 0 lekë dhe 28,693 mijë lekë, e cila përputhet për të njëjtat vlera me shumat e regjistruara në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e AAGJ” (me vleren neto). Llogaria 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” është zero. Seti i PFK kanë si pjesë të tyre pasqyrën nr.5 “Shënime shpjeguese për PFK të vitit 2022”. Gjatë përpilimit të PF janë konstatuar gabime në postin e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” për vitin 2021, ku kjo llogari është vendosur për 26,063,349 lekë, (rreshti nr.81 i F1, në PFV të v.2021 derguar në MFE me shkresën nr. 481, datë 07.03.2022), vlerë e njëjtë kjo me shumën e vendosur në kolonën “Ushtrimi parardhës 2021”; ndërkohë që referuar realcionit shpjegues të bilancit, vlera e saktë duhet të ishte 21,172,541 lekë, ku rezulton një diferencë me llogaritë analitike prej 4,890,808 lekë, aq sa është në gjendjen financiare të llogaritur nga Dega e Thesarit.

10. Nga ana e institucionit “**Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) Tiranë**, me shkresën nr.220 prot, datë 29.3.2023, janë depozituar pasqyrat financiare të subjektit për vitin 2022, protokolluar në MFE me nr. 2879/31, datë 30.3.2023. Konstatohet se në bilancin e vitit 2022 zëri i “Aktiveve Neto” (rreshti 96, kolona C e Formatiti F1) nuk është i kuadruar me zërin “Fondi i Konsoliduar” të asaj pasqyre. Më konkretisht, teprica e grupit C (Aktivet neto/Fondet neto) më 31.12.202 është 27,679,135 lekë, kurse vlera e grupit D “Fondi i konsoliduar” është pasqyruar në shumën prej 55,693,022 lekë, duke rezultuar me një diferencë në kuadraturë prej 28,013,887 lekë, situatë kjo e lidhur me gabimet e mbartura në mbylljen e PFV të vitit 2021. Referuar relacionit shpjegues të PFV, mungon analiza e llogarive dhe informacioni për mbylljen e pasqyrave financiare ka qenë i mangët. Është konstatuar nga ana e NZ së sapoemëruar, se mbyllja e PF të vitit 2021 kishte gabime në formulat e formateve të pasqyrave, mungesë të relacionit analitik e shpjegues mbi analizen e posteve të bilancit, etj. Mosperputhje ekzistojnë edhe midis totalit të fondeve sipas pasqyrës F4 dhe totalit të fondeve në pasqyrën F1, prej 5,821,512 lekë.

Rezulton se vlera e AAJM dhe AAM në Pasqyrën e konsoliduar të Pozicionit Financiar (Formati nr.1) është përkatësisht prej 10,930 mijë lekë dhe 9,035 mijë lekë, e cila përputhet për të njëjtat vlera me shumat e regjistruara në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e AAGJ” (me vleren neto). Vlera e llogarisë toka, troje e terrene dhe nderta është kontabilizuar për 0 lekë. Llogaria 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” ka të regjistruar tepricat debitore per cdo vit, përkatësisht prej 3,768 mijë lekë në v.2021 dhe zero lekë në fund të v.2022. Seti i PFK kanë si pjesë të tyre pasqyrën nr.5 “Shënime shpjeguese për PFK të vitit 2022”.

11. Nga ana e institucionit “**Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit” Tiranë**, me shkresën nr. 186 prot, datë 20.03.2023, janë depozituar pasqyrat financiare të subjektit për vitin 2022, protokolluar në MFE me nr. 2879/34, datë 31.3.2023. Konstatohet se në bilancin e vitit 2022 zëri i Aktiveve Neto (rreshti 96, kolona C e Formatiti F1) është e kuadruar me zërin “Fondi i Konsoliduar” të asaj pasqyre, si për v.2021, ashtu edhe për v.2022. Nga kryqëzimi i informacionit vërejmë si parregullsi që, vlera e aktiveve neto/ fondeve neto në pasqyrën F1 në fund të v.2022 është 12,724,172 lekë, kur në pasqyrën nr.4 “Pasqyra e ndryshimeve në fondet neto/aktivet neto” është 18,793,313 lekë, me një diferencë të pa justifikueshme prej 6,069,141 lekë. Gjithashtu, shuma totale e fondit të konsoliduar (Grupi D, rreshti 97 i F1) është i pa detajuar në nënlllogaritë analitike 15, 85, 101-111). Rezulton se vlera e AAJM dhe AAM në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (Formati nr.1) është përkatësisht prej 1,060,787 lekë dhe 12,817,433 lekë, e cila nuk përputhet me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

- shumat e regjistruara në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e AAGJ” (me vleren neto), ku vlera e tyre është përkatësisht për 1,060,787 dhe 9,427,845 lekë, duke evidentuar mospërputhje dhe diferenca, repektivisht në kategorinë e AAGJM prej 3,296,327 lekë (9,427,845 lekë-12,724,172 lekë). Vlera e llogarisë toka, troje e terrene dhe ndërtesa e konstruksione është kontabilizuar për 0 lekë. Llogaria 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” ka të regjistruar tepricat zero lekë per cdo vit.. Seti i PFK kanë si pjesë të tyre pasqyren nr.5 “Shënime shpjeguese për PFK të vitit 2022”.
12. Nga ana e institucionit “**Bashkia Korçë**”, me shkresën nr. 3382 prot, datë 27.4.2023, janë depozituar pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2022, protokolluar në MFE me nr.7980, datë 2.5.2023. Konstatohet se, vlera totale e aktivitetit dhe pasivitetit përpunohen midis tyre (përkatësisht 12,226,002 mijë lekë në v.2022, dhe për 12,297,255 mijë për v.2021). Në bilancin e vitit 2022 zëri i Aktiveve Neto (rreshti 96, kolona C e Formatit F1) është e kuadruar me zërin “Fondi i Konsoliduar” të asaj pasqyre, perkatesisht 11,316,963 mijë në v.2022 dhe 11,419,476 mijë në v.2021. Rezulton se vlera e AAJM dhe AAM në Pasqyrën e konsoliduar të Pozicionit Financiar (Formati nr.1) është përkatësisht prej lekë dhe lekë, e cila përputhet për të njëjtat vlera me shumatat e regjistruara në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e AAGJ” (me vleren neto). Llogaria 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” në bilanc është 0 lekë si për v.2021, ashtu dhe për v.2022.
- A.Nga shqyrtimi i llog.15-16 ‘llogari te pagueshme/pasivet agfagjata), ne rreshtin 93 të F1, për v.2022 është vendosur shumata prej 51,327,411 lekë. Nga zberthimi i analizës së zërave të llogarisë 15 dhe 16 “Huadhënie” të evidentuara në pasqyren e pozicionit financiar, rezulton se, vlera e paraqitur në llog.56 dhe 16 në Bilancin e bashkisë Korçë është 51,327,411 lekë, pasi huatë e marra nga Bankat ISP dhe PCB janë bërë hyrje për llogari të bashkisë Korçë, ndersa vlera e huasë CEB, nuk është bërë hyrje në Bashkinë Korçë, ajo është akorduar për projektet e strehimit nëpërmjet marrëveshjeve nënkontraktore dhe vetëm për pagesat Bashkia kontabilizon veprimet. Si rrjedhojë, kjo llogari në SIFQ nuk rakordon me atë të PFV.

Banka	Vlera e marre e huasë	Vlera totale e huase së shlyer	Vlera e huase 1.1.2021	Likujdimet gjatë v.2021	Vlera e huase, mbetur per tu shlyer
Intesa San Paolo	200,000,000	124,400,232	75,599,769	24,272,358	51,327,411
ProCredit Bank	92,600,000	90,339,847	2,260,154	2,260,153	0
CEB	157,504,838	112,604,822	59,298,898	14,398,882	44,900,016
Totali	450,344,901	327,344,901	137,158,820	40,931,393	96,227,427

Burimi:PF Konsoliduara,Bashkia Korçë, v.2022

B. Në lidhje me vleren e pasqyruar në llog.85 “Rezultati i ushtrimit”, konstatohet se ajo në F1 është regjistruar për v.2021 për 125,487 mijë leke dhe në fund të v.2022 për 228,565 mijë lekë, kurse nga kontrolli i të dhënave të pasqyruara në rreshtin 132, të F2 “Pasqyra e Performancës Financiare”, vlera e llog.85 nuk përputhet me të dhënat e mësipërme, pasi janë përkatësisht 120,283 mijë për v.2021 dhe 165,855 mijë për v.2022,me një diferencë dhe mosrakordim përkatësisht prej 5,204 mijë në v.2021 dhe 62,710 mijë lekë. (Në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

arsyetimin e Bashkisë, kjo sujë përbëhet nga vlera e letrave me vlerë në arkë të cilat pasqyrohen në llog.532 “vlera të tjera” (për Bashkinë Korçë 10,561 mijë lekë, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike 747 mijë lekë dhe Qendra e Artit dhe Kultures 85 mijë lekë) si dhe vlera e mbështetjes financiare, për të cilën shpenzimi është kryer në muajin dhjetor dhe banka është prekur në janar në vlerën 5,315,826. Lekë).

Seti i PFK kanë si pjesë të tyre pasqyrën nr.5 “Shënime shpjeguese për PFK të vitit 2022”.

13. Nga ana e institucionit “**Këshilli i Qarkut Fier**”, me shkresën nr. 364 prot, datë 27.3.2023, janë depozituar pasqyrat financiare të subjektit për vitin 2022, protokolluar në MFE me nr. 2879/37, datë 31.3.2023. Kostatohet se në bilancin e vitit 2022 zëri i Aktiveve Neto (rreshti 96, kolona C e Formatit F1) është e kuadruar me zërin “Fondi i Konsoliduar” të asaj pasqyre. Grantet e brendshme kapitale (llog.105) në Pasqyrën nr.4 “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”, përputhen me kreditin e pasqyres nr. 6 “Investimet dhe burimet e financimit”. Rezulton se llog 85 përputhet në F1 dhe F2. Vlera e AAJM dhe AAM në Pasqyrën e konsoliduar të Pozicionit Financiar (Formati nr.1) është përkatësisht prej 30,840 mijë lekë dhe 1,990 mijë lekë, e cila përputhet për të njëjtat vlera me shumat e regjistruara në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e AAGJ” (me vleren neto). Vlera e llogarisë toka, troje e terrene është kontabilizuar për zero lekë, kurse vlera e llog 212 për 1,614 mijë lekë. Llogaria 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” është zero në v.2021 dhe v.2022. Seti i PFK kanë si pjesë të tyre pasqyrën nr.5 “Shënime shpjeguese për PFK të vitit 2022”.

Nga krahasimi i të dhënave të PFV me informacionin e ngarkuar në QIFQ rezultojnë disa mosrakovime, të cilat nuk janë trajtuar në pyetësorin me shënimet shpjeguese, për **diferencat midis pasqyrave financiare të Njesisë Raportuese dhe pasqyrave financiare të gjeneruara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në SIFQ**, (rubrika nr. 28 e pyetësorit), në mospërputhje me përcaktimet e **paragrafit 39, pika 3.1**,”Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, kreu III, të Udhëzimit Nr. 8, datë 9.3.2018 ndryshuar, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, që përcakton shprehimisht se,

Këto pasqyra i'u dërgohen njësive të qeverisjes së përgjithshme të juridiksionit përkatës të degëve të thesarit për krahasimin e bilancit vërtetues me informacionin financiar të SIFQ, rakorduar gjatë vitit sipas paragrafit 37. Qëllimi kryesor është përgatitja e pasqyrave financiare individuale për çdo njësi shpenzuese, **përgatitja e pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara në nivel njësie publike qendrore ose vendore, së bashku me shënimet shpjeguese, ku analizohet diferenca midis vlerave kontabël të njësive dhe vlerave kontabël të SIFQ, veçanërisht diferenca midis zërave të Pasqyrës së Flukseve Monetare prodhuar nga SIFQ dhe zërat e Pasqyrës së Performancës Financiare prodhuar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme.**

Si vijon:

Në leke

Zërat e bilancit	Për vitin 2021		Për vitin 2022	
	Bilanci Kontabel	SIFQ	Bilanci Kontabel	SIFQ
Aktivët qarkulluese				
<i>Klasa 4, llogaritë e arketueshme</i>	2,279,498	2,279,498	2,379,498	2,279,498
<i>Klasa 3, llog. Gjendjes se</i>	1,331,251	1,331,251	2,528,943	1,331,251



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

<i>Invetarit</i>				
Aktive Joqarkulluese				
<i>Investimet</i>	446,899,286	446,899,286	436,327,474	447,654,326
AQT	20,954,029	20,954,029	30,840,226	20,954,029
AQPT	1,990,000	1,990,000	1,990,000	1,990,000
Llogari te pageshme kl4.	7,362,285	7,362,285	6,933,514	7,033,694
<i>Ne kete grup (llog 421-428 detyrimet): llog e personelit dhe te lidhura</i>	1,363,516	1,363,516	1,411,530	1,563,516

Burimi: PFV Këshilli Qarkut Fier, përpunuar nga grupi i auditimit

14. Nga ana e institucionit të “**Ministrisë së Mbrojtjes**” Tiranë, me shkresën nr.1985 prot, datë 3.4.2023, janë depozituar pasqyrat financiare individuale të subjektit për vitin 2022, protokolluar në MFE me nr. 6387, datë 5.4.2023. Konstatohet se në bilancin e vitit 2022 zëri i Aktiveve Neto (rreshti 96, kolona C e Formatiti F1) është e kuadruar me zërin “Fondi i Konsoliduar” të asaj pasqyre per 136,436 mijë lekë. Grantet e brendshme kapitale (llog.105) në Pasqyrën nr.4 “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”, përputhen me kreditin e pasqyres nr. 6 “Investimet dhe burimet e financimit” për vlerën e tyre prej 11,345 mijë lekë. Rezulton se vlera e AAJM dhe AAM në Pasqyrën e konsoliduar të Pozicionit Financiar (Formati nr.1) është përkatësisht prej 105,687 mijë lekë dhe 0 lekë, e cila përputhet për të njëjtat vlera me shumat e regjistruara në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e AAGJ” (me vleren neto). Vlera e llogarisë toka, troje e terrene është kontabilizuar për zero lekë, si dhe po aq është vlera e llog 212 “Ndertesa” të kësaj Ministrie (Rep.Ushtarak 6001, Ministria e Mbrojtjes). Nga auditimi KLSH rezulton se, Llogaria 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” ka të regjistruar tepricat debitore per cdo vit, përkatësisht prej 1,204,664 lekë në v.2021 dhe për të njëjtën vlerë edhe në v.2022. Sa sipër, është vepruar në kundërshtim me paragrafin nr.15, të UMF nr.5, datë 21.2.2022. Seti i PFK kanë si pjesë të tyre pasqyren nr.5 “Shënime shpjeguese për PFK të vitit 2022”.
15. Nga ana e institucionit “**Këshilli i Qarkut Durrës**”, me shkresën nr. 163 prot, datë 3.4.2023, janë depozituar pasqyrat financiare individuale (pasi në shkresën përcjellëse të sipërcituar të subjektit është theksuar se nuk ka nësi varësie), për vitin 2022, protokolluar në MFE me nr. 6358, datë 5.4.2023. Nga analiza e posteve të bilancit të vitit 2022, zëri i Aktiveve Neto (rreshti 96, kolona C e Formatiti F1) është e kuadruar me zërin “Fondi i Konsoliduar” të asaj pasqyre. Grantet e brendshme kapitale (llog.105) në Pasqyrën nr.4 “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”, përputhen me kreditin e pasqyres nr. 6 “Investimet dhe burimet e financimit” për vlerën e tyre prej 329,420 mijë lekë. Rezulton se vlera e AAJM dhe AAM në Pasqyrën e konsoliduar të Pozicionit Financiar (Formati nr.1) është përkatësisht prej 62,719 mijë lekë dhe 0 lekë, e cila përputhet për të njëjtat vlera me shumat e regjistruara në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e AAGJ” (me vleren neto). Vlera e llogarisë toka, troje e terrene është kontabilizuar për zero lekë, kurse vlera e godinës prej 48,964 mijë lekë. Llogaria 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” ka të regjistruar tepricat debitore per cdo vit, përkatësisht prej 55,687 mijë lekë në v.2021 dhe 51,499 mijë lekë në v.2022. Konstatohet se, teprica në fillim dhe mbyllje të ushtrimit (v.2022), në pasqyren “Investimet dhe burimi i financimit”, për llogaritë 230 dhe 231, kjo teprice eshte zero dhe janë evidencuar vetëm, transaksionet në debi dhe kredi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

- të këture llogarive, duke i vendosur për të njëjat vlera dhe duke ekspozuar më 31.12.2022 vleren zero, e cila nuk përputhet me tepricen e llogr 231 në Pasqyrën F1, që është 245,430 mië lekë. Seti i PFK kanë si pjesë të tyre pasqyren nr.5 “Shënime shpjeguese për PFK të vitit 2022”.
16. Nga ana e institucionit, **“Këshilli i Qarkut Korçë”**, me shkresën nr. 290 prot, datë 19.4.2023, janë depozituar pasqyrat financiare individuale (pasi ne shkresën përcjellëse të sipërcituar të njësisë raportuese është theksuar se nuk ka nësi varësie), për vitin 2022, protokolluar në MFE me nr. 7479, datë 24.4.2023. Nga shqyrtimi i të dhënave vërejmë se, në bilancin e vitit 2022, zëri i Aktiveve Neto (rreshti 96, kolona C e Formatiti F1) është i kuadruar me zërin “Fondi i Konsoliduar” të asaj pasqyre, për 524,402 mijë lekë. Grantet e brendshme kapitale (llog.105) në Pasqyrën nr.4 “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto”, përputhen me tepricen në fund të periudhës, të pasqyrës nr. 6 “Investimet dhe burimet e financimit” për vlerën e tyre prej 361,673 mijë lekë. Rezulton se vlera e AAJM dhe AAM në Pasqyrën e konsoliduar të Pozicionit Financiar (Formati nr.1) është përkatësisht prej 13,736 mije lekë dhe 74,032 mijë lekë, e cila përputhet për të njëjtat vlera me shumat e regjistruara në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e AAGJ” (me vleren neto). Vlera e llogarisë toka, troje e terrene është kontabilizuar për zero lekë, kurse llog 212 “Ndërtesa” prej 68,134 mijë lekë. Llogaria 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” janë zero lekë në v.2021 dhe v.2022. Seti i PFK kanë si pjesë të tyre pasqyren nr.5 “Shënime shpjeguese për PFK të vitit 2022”.
17. Nga ana e institucionit **“Ministria e Brendshme Tiranë”**, me shkresën nr. 284 prot, datë 28.4.2023, janë depozituar pasqyrat financiare përmbledhëse për vitin 2022, protokolluar në MFE me nr. 9407, datë 23.05.2023. Konstatohet se, në bilancin e vitit 2022 zëri i Aktiveve Neto (rreshti 96, kolona C e Formatiti F1) është i kuadruar me zërin “Fondi i Konsoliduar” të asaj pasqyre. Grantet e brendshme kapitale (llog.105) në Pasqyrën nr.4 “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto”, përputhen me tepricen në fund të periudhës, të pasqyrës nr. 6 “Investimet dhe burimet e financimit” për vlerën e tyre prej 23,141,537 mijë lekë. Rezulton se vlera e AAJM dhe AAM në Pasqyrën e konsoliduar të Pozicionit Financiar (Formati nr.1) është përkatësisht prej 48,668 mijë lekë dhe 20,015,529 mijë lekë, e cila përputhet për të njëjtat vlera me shumat e regjistruara në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e AAGJ” (me vleren neto). Vlera e llogarisë toka, troje e terrene është kontabilizuar për 5,438,803 mijë lekë. Llogaria 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” ka të regjistruar tepricat debitore per cdo vit, përkatësisht prej 579,311 mijë lekë në v.2021 dhe 819,641 mijë lekë në v.2022. Detyrimet prej 820 milionë lekë përbëhen nga këto njësi shpenzuese: IKMT në shumën 686.5 milionë lekë detyrime të lidhura nga vendimet gjyqesore te formes se prerë, të mbaruta nga vitet e mëparshme dhe atyre të v.2022; DP Policisë së Shtetit 126 milionë lekë, Aparatii MB prej 5.8 milionë lekë, Prefektura e Qarkut Tiranë prej 0.9 milionë lekë.
Nga shqyrtimi i PFK, evidentohet një stok shumë i lartë i kërkesave të arkëtueshme, (të drejtat mbi debitorët, klasa 4), një pjesë e madhe e të culave është krijuar para vitit 2000. Me një vlerë të përgjithshme për strukturat e varësisë së MB, (përpunuar sipas 22 pasqyrave financiare vjetore që janë përmbledhur nga 62 njësi shpenzuese), gjithësej rezultojnë në fund të v.2022, kërkesa për arkëtim mbi debitorët për vlerën 10,272 milionë lekë, nga 7,645 milionë lekë që regjistroheshin këto të drejta në vitin e mëparshëm. Këtu janë kontabilizuar debitorë për paradhënie, debitorë të ndryshëm, debitorë të Gardës së Republikës dhe Policisë së Shtetit, gjodat e vendosura nga policia rrugore, etj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

Nga auditimi i PFK të Ministrisë së Brendshme, konstatohet se, **egzistojnë mospërputhje e të dhënave të kolonës “ushtrimi i mbyllur” i bilancit të konsoliduar të dates 31.12.2021**, (dërguar MFE me shkresen nr. 2396/2, dt 29.4.2022 të MB), pasqyruar totali aktivitet dhe pasivitet për 30,812,751,940 lekë) me të dhënat e kolonës “ushtrimi paraardhës”, (në bilancin e datës 31.12.2022, (dërguar në MFE me shkresen e MB nr. 3030/1, datë 28.4.2023 (protokoll i MFE nr. 9407, dt 23.5.2023), i pasqyruar totali i aktivitet dhe pasivitet për v.2021 për: 30,817,636,787), duke patur një diferencë mosakordimi në vlerën prej + 4,884,847 lekë, **sa nuk kuadrojnë të dhënat dhe pasqyruar me tepër celje ushtrimi i meparshëm, në fillim të vitit 2022**, në mospërputhje me përcaktimet e **paragrafit 31, pika 3.1**,”Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, kreu III, të Udhëzimit Nr. 8, datë 9.3.2018 ndryshuar, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, që përcakton shprehimisht se,

"Për këtë qëllim, çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme duhet të **saktësojë regjistrimet kontabël** në momentin fillestar dhe në fund të vitit financiar në **pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara** për njësinë publike qëndrore ose vendore, që përfshin të gjitha njësitë e varësisë dhe kompanitë nën kontroll ose pronësi.

Më konkretisht:

- Në PFK të v.2021 të Ministrisë së Brendshme , (të depozituara në MFE me shkresen nr. 2396/2, dt 29.4.2022 të MB),

(të dhënat në Lekë):

Emërtesa	v.2021 (ushtrimi i mbyllur)	v.2020 (ushtrimi i meparshëm)
Shuma totale aktivitet-pasivitet	30,812,751,940	30,812,751,940

- Në PFK të v.2022 të MB, (dërguar në MFE me shkresen e MB nr. 3030/1, datë 28.4.2023 (protokoll i MFE nr. 9407, dt 23.5.2023):

(të dhënat në Lekë):

Emërtesa	v.2022 (ushtrimi i mbyllur)	v.2021 (ushtrimi i meparshëm)
Shuma totale aktivitet-pasivitet	30,817,636,787	30,817,636,787

U audituan barazimet e llogarive dhe rakordimi i informacionit financiar dhe vlerat e regjistruara të AAJM dhe AAM në Pasqyrën e konsoliduar të Pozicionit Financiar (Formati nr.1) për vitin 2021 dhe 2022 dhe krahasimet nëse përputhen vlerat e llogarive të AAJM dhe AAGJM me shumatat e regjistruara në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e AAGJ” (me vlerën neto

Llogaria 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” ka të regjistruar tepricat debitore per cdo vit. Në lidhje me mbartjen e teprices se llogarise 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” evidentohen diferenca dhe paraqitet kjo situatë nga kryqezimi i te dhënave të informacionit kontabël:

Emërtesa	PF te vitit 2022 (ushtrimi i meparshëm)v.2021	31.12.2021 Ushtrimi i mbyllur.	Diferencat/ moskuadrim
Shuma e llog 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme”	579,311,918	585,797,600	6,485,682

Seti i PFK kanë si pjesë të tyre pasqyrën nr.5 “Shënime shpjeguese për PFK të vitit 2022”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

18. Nga ana e institucionit, "Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural" Tiranë me shkresën nr. 1063/21 prot, datë 20.4.2023, janë depozituar pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2022, protokolluar në MFE me nr. 7462, datë 24.4.2023. Konstatohet se, në bilancin e vitit 2022 zëri i Aktiveve Neto (rreshti 96, kolona C e Formatit F1) është 30,267,834 mijë lekë, kurse në F4 "Pasqyra e ndryshimeve në AN/FN" është në total në fund të vitit për 27,206,665 mijë lekë, e njëjtë me vlerën e vitit të mëparshëm dhe duke mos u kuadruar me zërin "Fondi i Konsoliduar" të asaj pasqyre. Grantet e brendshme kapitale (llog.105) në Pasqyrën nr.4 "Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto", përputhen me tepricën në fund të periudhës, të pasqyrës nr. 6 "Investimet dhe burimet e financimit". Vlera e llogarisë toka, troje e terrene është kontabilizuar për 292,280 mijë lekë, në zërin "Pyje dhe plantacione" për 13,213 mijë lekë dhe rruge ,rrije e vepra ujore per 8,283,708 mijë lekë.Llogaria 486 "Shpenzime te periudhave te ardhshme" ka të regjistruar tepricat debitore per cdo vit, përkatësisht prej 58,569 mijë lekë në v.2021 dhe 81,486 mijë lekë në v.2022. Seti i PFK kanë si pjesë të tyre pasqyren nr.5 "Shënime shpjeguese për PFK të vitit 2022".
19. Nga ana e institucionit, "Ministria e Arsimit dhe e Sporteve" Tiranë me shkresën nr. 2802 prot, datë 20.4.2023, janë depozituar pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin 2022, (mungon numri i protokollit në MFE). Konstatohet se, në bilancin e vitit 2022 zëri i Aktiveve Neto (rreshti 96, kolona C e Formatit F1) është 27,289,129 mijë lekë, e cila rakordon me F4 "Pasqyra e ndryshimeve në AN/FN" është në total në fund të vitit me zërin "Fondi i Konsoliduar" të asaj pasqyre. Grantet e brendshme kapitale (llog.105) në Pasqyrën nr.4 "Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto", përputhen me tepricën në fund të periudhës, të pasqyrës nr. 6 "Investimet dhe burimet e financimit" për vlerën e tyre vjetore. Rezulton se vlera e AAJM dhe AAM në Pasqyrën e konsoliduar të Pozicionit Financiar (Formati nr.1) është përkatësisht prej 358,177 mijë lekë dhe 19,316,037 mijë lekë, shumë kjo e njëjtë me vlerën e regjistruar në Pasqyrën nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e AAGJ" (me vlerën neto). Llogaria 486 "Shpenzime te periudhave te ardhshme" ka të pasqyruar tepricat debitore për cdo vit, përkatësisht prej 22,458,693 leke dhe 13,586,137 lekë. Nga auditimi i PFK të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, konstatohet se, **egzistojnë mospërputhje e të dhënave të kolonës "ushtrimi i mbyllur" i bilancit të konsoliduar të dates 31.12.2021, (dërguar MFE me shkresën nr. 2810/1, dt 29.4.2022), pasqyruar totali aktivitet dhe pasivitet për 30,564,666,353 lekë), me të dhënat e kolonës "ushtrimi paraardhës", në bilancin e datës 31.12.2022, (dërguar në MFE me shkresën e MAS nr. 2802, datë 28.4.2023 (ska nr. Protokollit te MFE), i pasqyruar totali i aktivitet dhe pasivitet për vitin e mëparshëm 2021 për: 30,562,057,766), duke patur një diferencë mosakordimi në vlerën prej - 2,608,587 lekë, sa nuk kuadrojnë të dhënat dhe pasqyruar me tepër celje ushtrimi i meparshëm, në fillim të vitit 2022, në mospërputhje me përcaktimet e **paragrafit 31, pika 3.1,**"Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", kreu III, të Udhëzimit Nr. 8, datë 9.3.2018 ndryshuar, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, që përcakton shprehimisht se:**

"Për këtë qëllim, çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme duhet të **saktësojë regjistrimet kontabël** në momentin fillestar dhe në fund të vitit financiar në **pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara** për njësinë publike qendrore ose vendore, që përfshin të gjitha njësitë e varësisë dhe kompanitë nën kontroll ose pronësi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

Ujësjetllës Kanalizime Vau i Dejës	0.597173

Burimi: MFE, DPTH,

Në bazë të të dhënave kontabël të gjeneruara nga sistemi informatik financiar i qeverisë për **vitin 2021**, vlera e mbetur e “arrears” është **13,334 milionë lekë**, e cila në periudhën **12-2022** është **12,751 milionë lekë** (saktësia e këtyre të dhënave varet nga paraqitja e plotë në Degën e Thesarit apo regjistrimi i plotë në SIFQ nga njësitë shpenzuese “online”).

1. Totali detyrimeve të qeverisë qendrore rreth 6,231.4 milionë lekë.
2. Totali detyrimeve të pa përfshira në qeverisjen qendrore dhe vendore (Ujësjetllës kanalizime dhe niversitetet) 554.6 milionë lekë.
3. Totali detyrimeve të qeverisë vendore rreth 5,965.9 milionë lekë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

Lidhur me raportimin nga Drejtorise se Thesarit të të dhenave të stokut të detyrimeve të prapambetura, ky informacion gjenerohet nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, pas rakordimit të degëve të Thesarit me njesite shpenzuese qe operojne ne rrethet e tyre dhe konfirmimit të degeve të thesarit për përfundimin e procesit të rregjistrimit dhe rakordimit të detyrimeve të prapambetura.

Raporti i gjeneruar nga SIFQ sipas niveleve të qeverisjes së përgjithshme dhe sipas natyrës ekonomike të detyrimit të prapambetur agregohet në skedar format excel dhe i dërgohet cdo fund muaji për muajin parardhës Drejtorisë së Buxhetit.

Detyrimet e tjera kontigjente, Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ).

Në nenin 19/4 të Ligjit “Për Avokaturën e Shtetit” përcaktohen dy mënyra ekzekutimi të shpërblimit:

- Vendimet me detyrim financiar mbi 10.000 euro, implikojnë nxjerrjen e VKM-ve respektive për ekzekutimin e tyre.
- Vendimet me detyrim financiar deri në 10.000 euro, ekzekutohen drejtpërdrejtë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pas kërkesës zyrtare të Avokaturës së Shtetit.

Tabela e Vendimeve të GJEDNJ të ekzekutuara gjatë vitit 2021

VITI 2021											
Nr	Vendimi GJEDNJ	Shuma Euro	Shuma LEK (principal)	Interes	Totali paguar ALL	Likujdimi	Burimi i Financimit	USH	Datë		kursi i kembimit
1	Per ekzekutimin e VGJE per te drejtat e njeriut, date 4.08.2020, per ceshijen Tershana kunder Shqiperise"	14,720.00	1,841,472.00	4,099.00	1,845,571.00	Likujduar	FR	206	05.03.2021	VKM nr. 78, date 18.02.2021	125.1
2	Per ekzekutimin e VGJEDNJ, date 14.10.2021, per ceshijen Sheti dhe Gjashta kunder Shqiperise" kerkesat VKM nr.13514/16 dhe 52735/20		569,020.00		569,020.00	Likujduar	MFE	1305 dhe 1306	06.12.2021		123.7
3	Pagese e interese vonesave ceshijen 18343/1, "Vogli kunder Shqiperise"			15,313.00	15,313.00	Likujduar		1243	16.11.2021		
			2,410,492.00	19,412.00	2,429,904.00						

Burimi: MFE, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar

Gjatë vitit 2022 rezultoi se Këshilli i Ministrave ka miratuar 5 (pesë) VKM me një vlerë totale prej **72,200.00 euro**, ndërkohë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ekzekutuar 18 (tetembedhete) vendime të GJEDNJ, me vlera nën **17,628,853 Lekë**.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

Në lidhje me burimin e financimit për ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ-së tek tabela në kolonën (Burimi i financimit) për të gjithë rastet kur burim financimi është FR 2022 kemi të bëjmë me vendime të ardhura në MFE me VKM dhe në të gjitha rastet e tjera ku burimi është MFE janë për shuma nën 10000 euro të cilat janë paguar referuar shkresave dhe vendimeve të gjykatës Evropiane të sjella nga Avokatura.

Tabela e Vendimeve të GJEDNJ të ekzekutuara gjatë vitit 2022

Nr	Vendimi GJEDNJ	Shuma Euro	Shuma LEK (principl)	Interes	Totali paguar ALL	Likuidimi	Burimi i Financimit	USH	Datë		kursi i kembimit
1	B. kundër Shqipërisë (VKM)	10,700 €	1,313,960	37,790	1,351,750	Likuiduar	FR 2022	121	28.02.2022	VKM 29, DATE 19.01.2022	122.8
2	M. N kundër Shqipërisë	2,300 €	286,580	0	286,580	Likuiduar	MFE	38	21.01.2022		124.6
3	E. Zh kundër Shqipërisë	2,300 €	286,580	6,900	293,480	Likuiduar	MFE	39	21.01.2022		124.6
4	D. M kundër Shqipërisë	5,000 €	622,000	0	622,000	Likuiduar	MFE	68	03.02.2022		124.4
5	Mr-Ikundër Shqipërisë	2,750 €	341,000	0	341,000	Likuiduar	MFE	397	15.04.2022		124
6	P. P kundër Shqipërisë	2,350 €	288,345	0	288,345	Likuiduar	MFE	543	26.05.2022		122.7
7	P. B kundër Shqipërisë	2,400 €	294,480	0	294,480	Likuiduar	MFE	542	24.05.2022		122.7
8	K. kundër Shqipërisë	3,500 €	429,450	803	430,253	Likuiduar	MFE	664	16.06.2022		122.7
9	A. K kundër Shqipërisë	5,000 €	613,500	0	613,500	Likuiduar	MFE	663	16.06.2022		122.7
10	F. Z kundër Shqipërisë	15,000 €	1,777,500	21,208	1,798,708	Likuiduar	FR 2022	779	20.07.2022	VKM 369, DATE 01.06.2022	118.5
11	L. kundër Shqipërisë	10,500 €	1,269,450	7,912	1,277,362	Likuiduar	FR 2022	698	16.06.2022	VKM 290, DATE 11.05.22	120.9
12	E. B kundër Shqipërisë	1,200 €	143,880	0	143,880	Likuiduar	MFE	895	24.08.2022		119.9
13	R. P kundër Shqipërisë	2,500 €	299,750	0	299,750	Likuiduar	MFE	896	24.08.2022		119.9
14	S. kundër Shqipërisë	5,000 €	600,000	0	600,000	Likuiduar	MFE	912	26.08.2022		120
15	B. kundër Shqipërisë	13,500 €	1,603,800	7,909	1,611,709	Likuiduar	FR 2022	1110	20.10.2022	VKM 586, DATE 7.9.2022	118.8
16	H. kundër Shqipërisë	2,050 €	246,000	0	246,000	Likuiduar	MFE	1200	07.11.2022		120
17	X dhe të tjerë kundër Shqipërisë	22,500 €	2,605,500	41,115	2,646,615	Likuiduar	FR 2022	1417; 1418; 1419; 1420; 1477	30.12.2022	VKM nr 760 dt 12.12.2022	115.8
18	L. kundër Shqipërisë	3,850 €	464,695	745	464,695	Likuiduar	MFE	1458	30.12.2022		120.7
...											
...			17,135,475	494,123	17,628,853						

Burimi: MFE, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar

Në zbatim të Urdhërit 287, datë 29.12.2022 janë kryer pagesat e pagave për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna për aparatit e MFE për ish-punonjësit si vijon: H.M; R.U; G. M; D.D; L. A.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

Grupit të auditimit pas komunikimeve të vazhdueshme me email nuk na u vu në dispozicion dokumentacioni vertetues sic janë urdhër-shpenzimet mbi pagesat e kryera për periudhën 2021/2022.

Kosto Administrative/ligjore/kontrata studiosh ligjore/anullime vendimesh etj për vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar:

Nr	Përshkrimi i vendimit (Nr. i çështjes/Data/ Emërtimi)	Ofruesi i shërbimit (studio ligjore)	Detyrimi i faturuar	Data e Faturimit	Pagesat	Data e pagesës	Pagesa ne leke	Nr. Ush
1	Pagese per sherbimet e eksperteve te CT Group per perfaqsim dhe mbrojtje ne Gjykatat e Anglise dhe Uellsit per vendimin e arbitrazhit ICSID No. ARB/15/28 dt 24.04.2019	CTS AND PRIVATE ADVISORY LTD	50,000 £	22.01.2022	50,000 £	23.02.2022	7,325,000.00	120
2	Shpenzime procedurale gjyqesore per rishikimin e vendimit te arbitrazhit ICSID Case No. ARB/15/28	IC for St of I D	10,000 \$		10,000 \$	20.04.2022	1,123,000.00	427
3	Tarife e studios ligjore CMS De.B LLP,per perfaq dhe mbrojtje inter te Shqiperise ne kunder te vendim te arbitrazh dt.24.04.19 'Sekues.e llog.te Ac sh.a. ne Mbreterine e Belgjikes"	CMS DeB S.C.R.L.	26,895 €	08.04.2022	26,895 €	19.05.2022	3,267,742.50	516
4	Pagese e avokatit per kundershtimin e njohjes dhe ekzek.vendim arbitrazh dt. 24.04.2019 ne Itali	STUDIO LEGALE C	60,000 €	29.04.2022	60,000 €	19.05.2022	7,290,000.00	517
5	Pagese e avokatit per kundershtimin e njohjes dhe ekzek.vendim arbitrazh dt. 24.04.2019 ne Itali	STUDIO LEGALE C	30,000 €	17.05.2022	30,000 €	07.06.2022	3,639,000.00	615
6	Pagese e shpenzimeve paraprake gjyqesore per ceshtjen e arbitrazh SCC Case No.V2021/155: IVICOM Holding GmbH kunder Shqiperise.	ARBITRATION INSTITUTE OF THE SCH OF CE	272,550 €		272,550 €	03.08.2022	32,160,900.00	821
7	Shpenzime per likuidimin e studios ligjore N.D BV/SRL per kundershtimin e ekzekut. vendimit te arbitrazhit ICSID Case No. ARB/15/28	N. D BV/SRL	128,000 €	03.08.2022	128,000 €	26.08.2022	15,104,000.00	903
8	Shpenzime per likuidimin e studios ligjore O.S. LLP per sherbimin e konsulences sipas kontr dt.15.06.2022.	O.S.LL	150,000 €	08.08.2022	150,000 €	13.09.2022	17,820,000.00	952
9	Shpenzime per likuidimin e studios ligjore O.S. LLP per sherb e perfaqes dhe mbrojtje sipas kontr dt.22.07.2022.	O. S.LLP	100,000 £	12.09.2022	150,000 €	21.09.2022	13,500,000.00	984
10	Shpenzime per likuidimin e ekspertit "C&G" per rishikimin e vendimit te arbitrazhit dt.22.04.2019 ref ICSID Case No.ARB/15/28.	C&G (UK) LLP	250,000 £	15.08.2022	250,000 £	16.09.2022	33,625,000.00	976
11	Pagese per kundersht.proc.ed per ekzek.vendim. arbitrazh. ceshtja ICSID Case no:ARB 15/28 (kesti II.)	O. S.LLP	150,000 \$	13.09.2022	10,000 \$	21.09.2022	17,685,000.00	975
12	Kosto adminitr per fazen fillestare per rishikimin e vendimit te arbitrazhit ICSID Case No. ARB/15/28 (200.000\$)	I. Bank for Reconstruction and Development as Trustee.	200,000 \$		200,000 \$	15.11.2022	22,780,000.00	1235
13	Shpenzime per likuidimin e ekspertit "C&G" per rishikimin e vendimit te arbitrazhit dt.22.04.2019 ref ICSID Case No.ARB/15/28.Kesti i dyte (250.000 pound)	C&G	250,000 £	06.12.2022	250,000 £	15.12.2022	33,675,000.00	1337



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

14	Shpenzime për likuidimin e studios ligjore Nauta Dutilh BV/SRL për kundërshtimin e ekzekut. vendimit të arbitrazhit ICSID Case No. ARB/15/28 (150.000 euro)	N. D BV/SRL	150,000 €	15.12.2022	150,000 €	31.12.2022	17,640,000.00	1415
15	Shpenzime për likuidimin e studios ligjore C.Ch në kuadër të shërbimit të përfaqësimit dhe mbrojtjes në zbatim të kontratës së shërbimit date 10.06.2022, për çështjen e arbitrazhit SCC Case no.V2021/155 (200.000 euro)	C. Ch	200,000 €	13.12.2022	200,000 €	31.12.2022	23,520,000.00	1416
16	Shpenzime për likuidimin e studios ligjore O.S. LLP për shërbimin e konsulentës sipas kontr. dt.15.06.2022. (150.000 euro)	O.S. LLP	150,000 €	20.12.2022	150,000 €	31.12.2022	18,020,000.00	1413
17	Shpenzime për likuidimin e studios ligjore O.S. LLP për shërb. e përfaqës.	O.S. LLP	200,000 €	08.12.2022	200,000 €	31.12.2022	23,140,000.00	1414

Burimi: MFE, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar

Konstatim Nr.15:

1.Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nuk janë zbatuar detyrimet e te paragrafit nr., 23 dhe 24 të UMFE nr.5 datë 21.2.2022, ku është nënvizuar shprehimisht se, **“Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.37/2020 "Per monitorimin dhe Publikimin e stokut të Detyrimeve të Prapambetura" si dhe çdo akt tjetër nënligjor që i referohet detyrimeve të prapambetura, të rishikohen në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi.”**

2.Mungesa e një strukture në nivelin e Drejtorisë së Përgjithshme të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar dhe pamjaftueshmëri e kapaciteteve në DPTH për shqyrtimin, analizimin, përpunimin dhe konsolidimin e informacionit kontabël të pasqyrave financiare të sektorit publik nga 1,046 njësitë shpenzuese të sektorit publik.

Bazuar në konkluzionet kryesore të raportit të auditimit, ***KLSH nënvizon nevojën, për një vëmendje të shtuar të drejtuesve të MFE nga njëra anë, por edhe të titullarëve të subjekteve publike nga ana tjetër,*** për forcimin e masave dhe përmirësimin e proceseve në fushat e identifikuar. Është e nevojshme që të instalohen mekanizma, të cilët sigurojnë zbatimin e parimeve, rregullave dhe standardeve të kontabilitetit të sektorit publik, por edhe rishikimit dhe forcimit të strukturave organike, sanksioneve e masave ndëshkuese, pasi një numër i gjetjeve mbi parregullsitë e fushës së kontabilitetit dhe raportimit financiar, vijnë të përsëriten nga viti në vit, siç prezantohen në raportet e auditimit të KLSH në subjektet e audituara.

Titulli i gjetjes:	Problematika të konstatuara në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë mbi përmbushjen e direktivave të rishikimit të detyrimeve të prapambetura.
Situata 1:	Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nuk janë zbatuar detyrimet e paragrafit 23 dhe 24 të Urdhrit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 22.02.2022 ku është nënvizuar shprehimisht se “udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë 37/2020 “Për monitorimin dhe publikimin e stokut të detyrimeve të prapambetura” si dhe çdo akt tjetër nënligjor që i referohen detyrimeve të prapambetura, të rishikohen në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi. Ministria e Financave dhe Ekonomisë në drejtim të monitorimit dhe raportimit të detyrimeve të prapambetura dhe në zbatim të së përgjithshme”. Në këtë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

Udhëzimet reflektohen procedurat që duhet të ndjekin strukturat përgjegjëse në Udhëzimet nr. 4, datë 25.01.2021, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, kapitulli III “Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes qendrore”, përgatit raportin e konsoliduar të këtyre detyrimeve çdo tre muaj bazuar në të dhënat e raportuara në SIFQ. Procesi i raportimit dhe monitorimit të detyrimeve të prapambetura është detajuar në Udhëzimin nr. 37, datë 06.10.2020 për “Monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes njësitë shpenzuese për raportimin e informacionit lidhur me detyrimet e prapambetura për të cilat nuk ka fonde në dispozicion nëpërmjet Urdhër Regjistrimit të Detyrimeve të Prapambetura dhe më pas regjistrimin nga ana e Thesarit të këtyre detyrimeve, për të vijuar me likuidimin e tyre pas regjistrimit të fondeve shtesë në SIFQ nga Buxheti. Ky udhëzim ka ndryshuar edhe metodologjinë e raportimit për shkak se deri në fund të vitit 2020 raportimi është kryer në bazë të vetë deklaratimit të njësisve duke përfshirë vetëm ministrinë e linjës dhe njësitë e vendore; ndërsa për vitin 2021 detyrimet janë gjeneruar automatikisht nga moduli përkatës në SIFQ, për tu konsoliduar më pas me raportimin nga DPT për stokun e rimbursimit të TVSH. Struktura përgjegjëse për Thesarin në qendër gjeneron periodikisht nga SIFQ raportet e të dhënave të detajuara të stokut të detyrimeve të prapambetura sipas njësisve shpenzuese të qeverisjes qendrore dhe vendore, si dhe sipas natyrës ekonomike të detyrimit të prapambetur.

Deri në fund të muajit Dhjetor 2021 nisur nga raporti mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2021 dhe raportimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit rezulton se u regjistrua një stok kumulativ prej 13,334.94 miliardë lekë i detyrimeve të prapambetura nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, nga të cilat:

1. Totali detyrimeve të qeverisë qendrore rreth 6,149.8 milionë lekë.
2. Totali detyrimeve të qeverisë vendore rreth 6,604.174 milionë lekë.
3. Totali detyrimeve për Universitetet dhe Ujësjetllësat e Kanalizimet rreth 0.48 milionë lekë.

Në bazë të të dhënave kontabël të gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë për vitin 2021 vlera e mbetur e “*arrears*” është 13.334 milionë lekë, e cila në periudhën 12-2022 është 12.751 milionë lekë (saktësia e këtyre të dhënave varet nga paraqitja e plotë në degën e Thesarit apo regjistrimi i plotë në SIFQ nga njësitë shpenzuese “online” i “*arrears*”).

1. Totali detyrimeve të qeverisë qendrore rreth 6,231.4 miliardë lekë.
2. Totali detyrimeve të pa përfshira në qeverisjen qendrore dhe vendore (Ujësjetllës kanalizime dhe universitetet) 554.6 milion lekë.
3. Totali detyrimeve të qeverisë vendore rreth 5,965.9 miliardë lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

	<p>Lidhur me raportimin nga Dr. e Thesarit të të dhënave të stokut të detyrimeve të prapambetura, ky informacion gjenerohet nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë pas rakordimit të degeve të Thesarit me njësitë shpenzuese që operojnë në rrethet e tyre dhe konfirmimit të degeve të thesarit për perfundimin e procesit të regjistrimit dhe rakordimit të detyrimeve të prapambetura.</p> <p>Raporti i gjeneruar nga SIFQ sipas niveleve të qeverisjes së përgjithshme dhe sipas natyrës ekonomike të detyrimit të prapambetur agregohet në skedar format excel dhe i dërgohet çdo fund muaji për muajin parardhës Drejtorisë së Buxhetit.</p>
Kriteri:	Paragrafi 23 dhe 24 të Urdhrit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 22.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme””
Ndikimi/Efekti:	Mos raportimi i borxhit sipas krijimit të tij me metodologjinë aktuale të raportimit dhe mungesa e pasqyrit të të dhënave të sakta për vendimmarrje të konsoliduar.
Shkaku:	Mos përmbushja e direktivave të rishikimit të detyrimeve të prapambetura.
Rëndësia:	E mesme.
1.1 Rekomandimi:	Struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Financave të marrë masat e nevojshme për zbatimin e paragrafit 23 dhe 24 të Urdhrit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 22.02.2022.

Projekt Raporti i Auditimit i është dërguar Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Për projekt raportin janë dërguar sqarime nga ana e Drejtorisë së përgjithshme e Thesarit sipas shkresës me nr. 7019/6, datë 18.8.2023, protokolluar në institucionin e Kontrollit të Lartë me nr. 360/9, datë 22.8.2023 dhe vënë në dispozicion të grupit të auditimit me datën 28.8.2023, ku për disa rekomandime janë paraqitur disa komente, të pasqyruara më poshtë, si vijon:

1. Në vijim të rekomandimit nr.1 (faqja 105,...) sqarojmë se rekomandimi pranohet dhe është i zbatueshëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit. Për të gjitha rastet e mosrespektimit të afateve ligjore të miratuara nga ana e institucioneve të qeverisjes së përgjithshme është proceduar me tërheqje vëmendje nga Nëpunësi i Parë Autorizues.

2. Në vijim të rekomandimit nr. 2.1 (faqja 106) sqarojmë se, rekomandimi është i zbatueshëm . Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit që paraqitet në Keshillin e Ministrave përmban në përbërjen e tij Pasqyrën vjetore të konsoliduar të zbatimit të buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet e njësitë të qeverisjes së përgjithshme (tabela fiskale) si e vetmja pasqyrë për transaksionet financiare të shtetit, në zbatim të nenit 63 të ligjit organik të buxhetit të shtetit.

3. Në vijim të rekomandimit nr. 2.2 (faqja 107) sqarojmë se, rekomandimi është pjesërisht i zbatueshëm. Në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë realizohet procesi i eliminimeve të kontabilizimeve midis qeverisjes qendrore, vendore dhe fondeve speciale për të ardhurat dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

shpenzimet, grantet, transfertat brenda të njëjtës njësi qeverisje nëse ka të tilla, sikurse shpjeguar në shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit Nr. 7019/3, datë 21.07.2023 "Mbi projekt raportin e KLSH-se për auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit për vitin 2022 mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme" dhe Aneksit Nr. I të këtij projektraporti (në faqen 117 të tij).

4. Në vijim të rekomandimit nr. 4.1 (faqja 108) sqarojmë se zbatimi i këtij rekomandimi është kompetencë e NA dhe NZ të njësive të qeverisjes së përgjithshme. Në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë regjistrohen balancat e llogarive kontabël të cilat depozitohen nga njësitet shpenzuese në Degët e Thesarit në rrethe. Struktura e thesarit nuk kontrollon/certifikon balancat kontabile të llogarive ekonomike të njësive të qeverisjes së përgjithshme në librat e tyre të kontabilitetit. Në vijim të diferencave të konstatuara, DPTH po punon për të përmirësuar saktësinë e të dhënave në SIFQ për të qenë të njëjta me të dhënat e pasqyrave financiare të protokolluara në degët e thesarit.

5. Në vijim të rekomandimit nr. 5.1 dhe 5.2 (faqja 110), sqarojmë përkatësisht: 5.1- Rekomandimi zbatohet nga Degët e Thesarit. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit do t'i kërkojë Degëve të Thesarit forcimin e mëtejshëm të këtij kontrolli. 2 3 5.2- Rekomandimi është përgjegjësi e NA dhe NZ të njësive të qeverisjes së përgjithshme.

6. Në vijim të rekomandimit nr. 6.1 (faqja 110), shprehemi se rekomandimi është i zbatueshëm dhe sqarojmë se Njësitë e qeverisjes së përgjithshme "online" me SIFQ të listuara në gjetjen nr. 6 (faqe 1 10) nuk kishin regjistruar ende të dhënat e pasqyrave financiare në SIFQ në periudhën kur po zhvillohej auditimi. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit ka proceduar ndaj këtyre njësive me shkresë zyrtare "terheqje vemendje" nga NPA.

7. Në vijim të rekomandimit nr. 7.1 (faqja 1 11), sqarojmë se Degët e Thesarit nuk kontrollojnë saktësinë e ngjarjeve kontabël në llogaritë e duhura ekonomike. Kompetenca dhe përgjegjësia është e NA dhe NZ të njësive të qeverisjes së përgjithshme.

8. Në vijim të rekomandimit nr. 8.1 (faqja 112), sqarojmë se rekomandimi zbatohet dhe monitorimi është proces pune që kryhet vazhdimisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit. Rastet e evidentuara janë në përgjegjësi të NA dhe NZ të njësive të qeverisjes së përgjithshme Për t'u sistemuar.

9. Në vijim të rekomandimit nr. 9.1 (faqja 112-113), sqarojmë se Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit dhe Degët e Thesarit nuk kanë kompetencë certifikimin e saktësisë së të dhënave të pasqyrave financiare të njësive të qeverisjes së përgjithshme. 10. Në vijim të rekomandimit nr. 11.1 (faqja 113).

10. Në vijim të rekomandimit nr. 11.1 (faqja 113), sqarojmë se rishikimi i strukturës organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit për ngritjen e një drejtorie me objekt kontabilitetin dhe raportimin financiar do të jetë në varësi të ecurisë së projektit për zbatimin e Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në sektorin publik.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Referuar sqarimeve me shkresën me lëndë: “Mbi projekt raportin e KLSH-së për auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit për vitin 2022 mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme”, të dërguara në KLSH, theksojmë se:

Në këto objeksione, nga 21 rekomandime të lëna në Projekt Raportin e Auditimit (nga të cilat 4 rekomandime për përmirësime ligjore dhe të dispozitave nënligjore, dhe 17 masa organizative), janë bërë komente për 10 rekomandime, të cilat pranohen dhe konsiderohen të zbatueshme (plotësisht apo pjesërisht, pasi një pjesë e tyre u atribuohen dhe Degëve të Thesarit nëpër rethe apo Njësive të Qeverisjes Qendore), për të cilat, kërkohet një angazhim më i plotë i DPTH në kuadër të ushtrimit të përgjegjësive zyrtare të kësaj strukture, për bashkërendimin dhe koordinimin e veprimtarive me Deget e Thesarit dhe NA e NZ e institucioneve të qeverisjes së përgjithshme etj, me qëllim hartimin e pasqyrave financiare individuale e të konsoliduara për sektorin publik, të cilat të evidentojnë me saktësi dhe vërtetësi gjendjet pasurore, të drejtat e detyrimet e tyre, etj.

Për sa më sipër, audituesit shtetëror të autorizuar, duke vlerësuar sqarimet e dërguara, si dhe nisur nga fakti se përgjigjia e DPTH/MFE nuk sjell argumente të tjera ligjore, këto konstatime dhe rekomandimet që rrjedhin prej tyre me qëllimin e përmirësimit të situatës në të ardhmen, do të vazhdojnë të pasqyrohen në raportin përfundimtar të auditimit.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET:

Në përfundim për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN DHE AKTET NËNLIGJORE NË FUQI:

1. Gjetje nga auditimi:

Për periudhën objekt auditimi, kuadri unifikues dhe baza rregullatore e sistemit të kontabilitetit të detyrueshëm në institucionet e qeverisjes së përgjithshme të sektorit publik, (të qeverisjes qendrore, vendore dhe fondeve speciale), përfaqësohet nga një akt nënligjor teknik, siç është Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.3.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.5, datë 21.2.2022, i cili konsiderohet një nivel i ulët në hierkinë e dispozitave ligjore të kësaj fushe. Në këtë kontekst, nuk është shënuar ndonjë progres në fushën e legjislacionit të kontabilitetit të sektorit publik, meqenëse deri në mesin e vitit 2018, veprimtaria e kontabilitetit publik në sektorin buxhetor rregullohej nga një ligj i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, (specifikisht Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i shfuqizuar).

Sa më sipër, nuk janë përmbushur,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

- kërkesat e Nenit 61 ”Standardet dhe procedurat e kontabilitetit”, Kreu VII “Kontabiliteti i sistemit buxhetor”, të Ligjit nr.9936, dt. 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, që ka përcaktuar se, (citur):

Ministri i Financave është përgjegjës për krijimin e sistemit të kontabilitetit të detyrueshëm për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuar. Ministri i Financave përcakton njësinë përkatëse të qeverisjes së përgjithshme dhe njësitë shpenzuese, të cilat janë të detyruara të mbajnë kontabilitet dhe të raportojnë sipas standardeve të përcaktuara.

Sistemi i thesarit mban kontabilitetin e shtetit dhe është pjesë e kontabilitetit publik. Ai është përgjegjës për mbajtjen e llogarive të shtetit dhe përgatitjen e raporteve periodike dhe vjetore të zbatimit të buxhetit.

Kontabiliteti dhe raportimi në sektorin publik rregullohen me ligj të veçantë dhe Ministri i Financave nxjerr udhëzim për standardet dhe procedurat e kontabilitetit, për njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

- detyrimet e Kreut 5.4, (Produkti 5.4.2), të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022, miratuar me VKM nr. 824, dt. 18.12.2019, mbi përfundimin e akteve ligjore në përputhje me IPSAS dhe
- planin e miratuar të veprimit strategjik të vendit, që ka përcaktuar si afat përfundimtar nxjerrjen e akteve ligjore Tremujorin e Katërt të vitit 2022.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.1 , faqe 16-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi:

Të merren masat nga Ministri i Financave, si autoriteti shtetëror përgjegjës për krijimin, organizimin dhe funksionimin e sistemit të kontabilitetit të detyrueshëm për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, që të hartohet ligji mbi kontabilitetin dhe raportimin financiar në sektorin publik, në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuar.

Afati: Brenda vitit 2024

2.Gjetje nga auditimi:

Përsa i takon fuqisë juridike të Udhëzimeve të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë në fushën e Kontabilitetit të Sektorit Publik, *rezulton se,*

- Paragrafi nr.127, i Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, ka përcaktuar shprehimisht (citur), “Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare. Efektet e këtij udhëzimi shtrihen duke filluar nga përgatitja dhe raportimi i pasqyrave financiare vjetore të vitit 2018”.

Nga auditimi rezulton se udhëzimi është publikuar në Fletoren Zyrtare me nr. 49, datë 11 Prill 2018.

- Paragrafët nr.27 dhe 28, të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.2.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, kanë përcaktuar se (citur): “Ky udhëzim hyn në fuqi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare”. ”Efektet e këtij udhëzimi shtrihen duke filluar nga përgatitja dhe raportimi i pasqyrave financiare vjetore të vitit 2021” .

Në referim të nenit 28, germa “ç”, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, *udhëzimi*, “është akti nënligjor i Këshillit të Ministrave, i ministrit ose drejtuesit të institucionit qendror, në varësi të Kryeministrit ose të ministrit, me karakter shpjegues, që shtjellon me hollësi të gjitha urdhërimet e ligjit ose të vendimit të Këshillit të Ministrave”. Sipas pikës 3, të nenit 29 “Hyrja në fuqi e akteve” të po këtij ligji: “*Udhëzimet e Këshillit të Ministrave dhe të ministrit marrin fuqi juridike pas botimit në Fletoren Zyrtare*”.

Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.5, datë 21.2.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, nga data e miratimit të tij, (21 Shkurt 2022), deri në datën e mbajtjes së raportit të auditimit, nuk është publikuar në Fletoren Zyrtare, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 ¹¹.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.1 , faqe 16-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi:

Nga ana e MFE të merren masat për unifikimin e Udhëzimit “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe botimin e tij në fletoren zyrtare, në funksion dhe shërbim të kontabilistëve të sektorit publik.

Afati: Brenda 4 muajsh

3.Gjetje nga auditimi:

Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nuk janë zbatuar detyrimet e paragrafit nr. 23 dhe 24 të UMFE nr.5 datë 21.2.2022, ku është parashikuar që “Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.37/2020 "Per monitorimin dhe publikimin e stokut të Detyrimeve të Prapambetura të qeverisjes së përgjithshme" si dhe çdo akt tjetër nënligjor që i referohet detyrimeve të prapambetura, të rishikohen në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi.”

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.1 , faqe 16-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi:

Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të merren masat për përmirësimin e kuadrit nënligjor në fuqi, nëpërmjet rishikimit, plotësimit dhe harmonizimit të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.37/2020, datë 6.10.2020, "Për monitorimin dhe publikimin e stokut të Detyrimeve të Prapambetura të qeverisjes së përgjithshme" si dhe çdo akti tjetër nënligjor që i referohet detyrimeve të prapambetura, në përputhje me përcaktimet e udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.5 datë 21.2.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, si dhe bashkërendojë e harmonizojë këto akte nënligjore me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor.

¹¹ -Udhëzimi nr. 5, i datës 21.02.2022, i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë mund të aksesohet nëpërmjet linkut të mëposhtëm në faqen zyrtare në internet të kësaj ministrie: (<https://financa.gov.al/akte-ligjore-dhe-nenligjore-ne-fushen-e-kontabilitetit-publik/>)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

Afati: Brenda 4 muajsh

4.Gjetje nga auditimi:

Nga shqyrtimi i zbatimit të kërkesave të Planit të Veprimit, që shoqëron Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike 2019-2022, miratuar me VKM nr. 824, datë 18.12.2019, rezulton se progresi i bërë në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar është i moderuar dhe nuk është i sinkronizuar dhe i përputhur me angazhimet dhe afatet e vendosura nga Këshilli i Ministrave në dokumentin e Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike 2019-2022, lidhur me implementimin e fazave të zbatimit të Kontabilitetit të Sektorit Publik mbi bazën e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (*IPSAS-International Public Sector Accounting Standards*), pasi: Nuk janë realizuar deri në datën e mbajtjes së këtij Raporti, ndryshimet e nevojshme ligjore për të mundësuar heqjen e pengesave për fillimin e zbatimit të metodologjisë së re kontabël dhe përgatitjen e pasqyrave financiare bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik.

- ✓ Ndonëse Qeveria Shqiptare synon që gradualisht të përshtasë, pjesërisht ose plotësisht, “Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik” (SNKSP), duke mbajtur parasysh kontekstin e Shqipërisë, nga analiza e dokumentacionit të vënë në dispozicion të audituesve të autorizuar të KLSH, por edhe nga raportet e institucioneve ndërkombëtare evidentohet se, nuk është specifikuar një datë indikative kur mund të përfundojë ky proces.

Për periudhën objekt auditimi (1.1.2021-31.12.2022), nga ana e MFE-së:

- *Është hartuar Metodologjia për Vlerësimin dhe Rivlerësimin e Aktiveve Afatgjata Materiale e Jomateriale të Sektorit Publik (asetet), e cila shërben si bazë për përgatitjen e inventarit të asetëve si për qeverisjen e përgjithshme, ashtu edhe për qeverisjen vendore, por edhe për përgatitjen e saktë të pasqyrave të konsoliduara financiare të qeverisë, por ky dokument nuk është miratuar përfundimisht, pasi nuk janë hartuar aktet ligjore sipas Strategjisë, (Aktiviteti 5.4.2, me afat realizimi T4/2022);*
- *Nuk ka gjetur zbatim regjistrimi i inventarit të plotë të aktiveve publike dhe procesi i migrimit të të dhënave nga institucionet buxhetore me akses të drejtëpërdrejtë në SIFQ, (Aktiviteti 5.5.2, pika “a”, me afat realizimi T4/2022), pasi nga 15 institucione me akses të drejtëpërdrejtë në SIFQ deri në fund të vitit 2022, vetëm 11 prej tyre kanë migruar asetet e tyre fikse në SIFQ, ndërkohë që, sipas tekstit të Strategjisë së MFP 2019-2022, aktivet publike të gjashtë institucioneve buxhetore janë hedhur në SIFQ që në vitin 2019 dhe se “ka përfunduar transferimi i aktiveve publike për qeverinë vendore”.*
- *Nuk është hartuar regjistri i konsoliduar i aktiveve të sektorit publik, nuk është zbatuar vlerësimi dhe inventarizimi i asetëve në të gjithë njësitë e qeverisjes qendrore sipas metodologjisë së aprovuar (Aktiviteti 5.5.1, pikat “a” dhe “c”, me afat realizimi T4/2022);*

Sa më sipër, nuk janë përmbushur të gjithë detyrimet e Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022 dhe Planit të Veprimit, miratuar me VKM nr. 824, datë 18.12.2019.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.1, faqe 16-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi:

Nga ana e MFE të merren masat për përmirësimin e kuadrit nënligjor në fuqi, (duke mbajtur parasysh miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin dhe Rivlerësimin e Aktiveve Afatgjata Materiale e Jomateriale të Sektorit Publik), të përfundojë procesi i hartimit të regjistrimit të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

konsoliduar të aktiveve të sektorit publik si dhe të zbatohet metodologjia e vlerësimit dhe inventarizimit të aseteve në të gjithë njësitë e qeverisjes qendrore dhe përpërfundimin e regjistrimit i inventarit të plotë të aktiveve publike dhe procesin e migrimit të të dhënave nga institucionet buxhetore me akses të drejtëpërdrejtë në SIFQ.

Afati: Në vijimësi.

B. MASA ORGANIZATIVE:

1.Gjetje nga auditimi:

1.a. Për periudhën objekt auditimit, rezulton se **69 institucioneve buxhetore të analizuar**, kanë shfaqur **probleme të shkeljes së afateve në lidhje me ngarkimin në SIFQ të pasqyrave individuale dhe dorëzimin e pasqyrave fizike individuale**, e më konkretisht,

- ✓ Për vitin 2021, evidentohet se 28 njësi shpenzuese / institucione buxhetore, nga 1016 institucione të qeverisjes së përgjithshme gjithsej (të qeverisjes qendrore, të vetëqeverisjes vendore, të fondeve speciale, të zbatimit të projekteve dhe marrëveshjeve, etj., të regjistruara nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit), ose afro 3 % e tyre, nuk kanë dorëzuar ose kanë dorëzuar me vonesë pasqyrat financiare individuale të institucioneve buxhetore pranë Degës së Thesarit, me tejkalim dhe shkelje të afateve ligjore të miratuara nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet e dala në zbatim të tij.
- ✓ Për vitin 2022, 41 njësi shpenzuese/ institucione buxhetore, nga 1046 institucione gjithsej (të qeverisjes së përgjithshme, të vetëqeverisjes vendore, të fondeve speciale, të zbatimit të projekteve dhe marrëveshjeve, etj., të regjistruara nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit), ose rreth 4 % e tyre, nuk kanë dorëzuar ose kanë dorëzuar me vonesë pasqyrat financiare individuale të institucioneve buxhetore pranë Degës së Thesarit, me tejkalim dhe shkelje të afateve ligjor të miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, sa vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet e dala në zbatim të tij.

1.b. Bazuar në informacionet e administruara nga DPTH, rezulton se, nuk janë depozituar **Pasqyrat Financiare të Konsoliduara (PFK)** nga institucionet buxhetore dhe ekstrabuxhetore, si vijon:

- ✓ Për vitin 2021, nga 72 njësi të qeverisjes së përgjithshme, nga 138 gjithsej që sipas MFE që kanë detyrimin për hatimin dhe depozitim të PFK-ve, ose nga 53 % institucioneve nuk kanë përmbushur këtë detyrim, ku peshën kryesore në këtë parregullsi e zënë institucionet e vetëqeverisjes vendore. Analizuar sipas strukturës së referuar, këto institucione detajohen si më poshtë vijon:
 - 2 ministri, (*Ministria e Kulturës dhe Kryeministria*);
 - 3 Këshilla të Qarqeve, *përkatesisht, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, Dibër dhe Kukës*;
 - 51 bashkitë: *Tiranë, Vorë, Berat, Kuçovë, Poliçan, Skrapar, Ura Vajgurore, Dibër, Belsh, Cërrik, Elbasan, Gramsh, Delvinë, Himarë, Devoll, Kolonjë, Divjakë, Dropull, Gjirokastrë, Këlcyrë, Libohovë, Memaliaj, Përmet, Tepelenë, Krujë, Shijak, Has, Kukës, Tropojë, Kamëz, Fushë-Arrëz, Malësi e Madhe, Pukë, Kavajë, Rrogozhinë,*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

Konispol, Sarandë, Selenicë, Vlorë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Librazhd, Peqin, Lushnje, Mallakastër, Roskovec, Maliq, Pogradec, Pustec, etj.

- 17 institucione qendrore.
- ✓ Për vitin 2022, nga 97 njësi të qeverisjes së përgjithshme, ose nga 70.3 % e institucioneve që kanë detyrimin për hatimin dhe depozitimin e PFK-ve, që sipas strukturës së referuar më lartë detajohen si mëposhtë vijon:
 - 5 ministri: (*Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Mjedisit dhe Turizimit, Ministria e Kulturës, Ministria për Europën dhe Punet e Jashtme, Kryeministria*).
 - 8 Këshilla të Qarqeve, *përkatësisht, Këshilli i Qarkut Tiranë, Shkodër, Gjirokastër, Berat, Lezhë, Vlorë, Dibër dhe Kukës*.
 - 56 bashkitë: *Berat, Kuçovë, Poliçan, Skrapar, Ura Vajgurore, Bulqizë, Dibër, Klos, Belsh, Cërrik, Elbasan, Gramsh, Delvinë, Himarë Finiq, Devoll, Kolonjë, Divjakë, Dropull, Gjirokastër, Këlcyrë, Libohovë, Memaliaj, Përmet, Tepelenë, Durrës, Krujë, Shijak, Vau i Dejës, Has, Kukës, Tropojë, Kamëz, Shijak, Fushë-Arrëz, Malësi e Madhe, Pukë, Kavajë, Rrogozhinë, Tiranë, Vorë, Konispol, Sarandë, Selenicë, Vlorë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Librazhd, Peqin, Lushnje, Patos, Mallakastër, Roskovec, Maliq, Pogradec, Pustec*.
 - 28 institucione qendrore dhe të tjera.

1.c. Nuk rezulton që të gjithë Njësitë e Zbatimit të Projekteve (NJZP) për v.2021 dhe 2022 të kenë depozituar pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore pranë DPTH së MFE-së si dhe, nuk janë përfshirë Pasqyrat Financiare të NJZP-ve, si pjesë e pasqyrave financiare të konsoliduara të njësive publike qendrore, në kundërshtim me përcaktimet e Paragrafit nr. 20, shkronja “c”, e UMF nr. 5, datë 21.2.2022, i cili ka parashikuar se:

“Konsolidimi i Pasqyrave Financiare Vjetore deri në nivelin e Qeverisjes së Përgjithshme kryhet nëpërmjet grupimit të informacionit (duke bërë eliminimet dhe mënjanuar dublimet) dhe duke kaluar nivelet e mëposhtme:

.....

c. Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivel qeverisje qendrore përfshirë të gjitha pasqyrat financiare të konsoliduara të njësive publike qendrore (ministri, institucione të tjera qendrore, fondet speciale të krijuara prej tyre, njësitë e menaxhimit dhe zbatimit të projekteve), informacionin e Ilogarisë qendrore të qeverisë, të Ilogarive të tjera speciale si dhe informacionin për borxhin qeveritar publik”.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.1 , faqe 16-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1. Rekomandimi:

1.1. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit të merren masat për të administruar sipas afateve ligjore të miratuara, pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore, individuale dhe përmbledhëse nga të gjithë institucionet e sektorit publik.

1.2. Për të gjitha rastet e mosrespektimit të këtyre afateve nga ana e institucioneve përgjegjëse, të zbatohen nga Nëpunësi i Parë Autorizues sanksionet e parashikuara ligjore, si kundrejtë titullarëve të institucioneve shtetërore, ashtu edhe ndaj nëpunësve autorizues e zbatues përkatës, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor.

Afati: Në vijimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

2.Gjetje nga auditimi:

Nuk kanë gjetur zbatim detyrimet ligjore për konsolidim e pasqyrave financiare nga njësitë publike e sektorit publik, në nivel të qeverisjes së përgjithshme, po ashtu edhe në nivel qendror dhe vendor, etj., në kundërshtim me përcaktimet e:

- Paragrafit nr.20 dhe 23, të UMFE nr.5, datë 21.2.2022, që ka përcaktuar se: “Konsolidimi i Pasqyrave Financiare Vjetore deri në nivelin e Qeverisjes së Përgjithshme kryhet nëpërmjet grupimit të informacionit (duke bërë eliminimet dhe mënjeluar dublimet) dhe duke kaluar nivelet e mëposhtme:
 - n) Konsolidimi i pasqyrave financiare në ***nivel njësie publike qendrore***, duke përfshirë informacionin financiar të organit qendror të njësisë (aparati), të gjitha njësitë e varësisë/njësi shpenzuese dhe pasqyrat financiare të kompanive nën kontroll ose pronësi të njësisë publike qendrore;
 - o) Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivel njësie publike të ***vetëqeverisjes vendore***, duke përfshirë informacionin financiar të organit qendror të njësisë (aparati), të gjitha njësitë e varësisë/njësi shpenzuese dhe pasqyrat financiare të kompanive nën kontroll ose pronësi të njësisë publike vendore;
 - p) **Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivel qeverisje qendrore përfshirë të gjitha pasqyrat financiare të konsoliduara të njësisë publike qendrore (ministri, institucione të tjera qendrore, fondet speciale të krijuara prej tyre, njësitë e menaxhimit dhe zbatimit të projekteve), informacionin e llogarisë qendrore të qeverisë, të llogarive të tjera speciale si dhe informacionin për borxhin qeveritar publik.**
 - q) Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivel qeverisje vendore, përfshirë të gjitha pasqyrat financiare të konsoliduara të njësisë publike të vetëqeverisjes vendore (bashkitë dhe këshillat e qarqeve).
 - r) Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivel qeverisje të përgjithshme, përfshirë pasqyrat e konsoliduara sipas pikës c dhe d.
- Nenit 62 “Përgatitja e llogarive vjetore të buxhetit”, të ligjit nr. Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, me ndryshimet:

“Nëpunësit autorizues të njësisë të qeverisjes së përgjithshme, në fund të vitit depozitojnë në sistemin e thesarit raporte financiare, sipas përcaktimeve të nëpunësit të parë autorizues, për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të qeverisjes së përgjithshme. Nëpunësit autorizues të njësisë të qeverisjes së përgjithshme finalizojnë dhe konfirmojnë përfundimisht me nëpunësin e parë autorizues pasqyrat financiare vjetore të buxhetit, brenda datës 31 mars.”
- Paragrafit 125, Kreu V “Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore”, të Udhëzimit nr. 8, datë 9.3.2018 i ndryshuar, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, që shprehimisht ka përcaktuar se:

“Në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, hartohen Pasqyrat Financiare Përmbledhëse/ të Konsoliduara të Qeverisjes së Përgjithshme, qendrore e vendore, brenda Qershorit të vitit pasardhës, për vitin ushtrimor të mbyllur, mbi bazën e informacionit të depozituar nga strukturat përgjegjëse të përmendura në këtë udhëzim”.
- Paragrafi nr.5-7, Kreu I, i Udhëzimit vjetor për mbylljen e PF të vitit 2021:

“Struktura përgjegjëse për thesarin në qendër harton të dhënat faktike përfundimtare të pasqyrës vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

përgjithshme brenda datës 15.02.2022. Pasqyra vjetore e konsoliduar e shpenzimeve dhe e të ardhurave të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme publikohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në muajin shkurt 2022.

Pasqyra vjetore e konsoliduar e shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme e shoqëruar me raportimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2021, performancës makro-fiskale, situatës së menaxhimit të kontrollit të brendshëm financiar dhe auditimit të brendshëm i paraqitet Këshillit të Ministrave brenda muajit Maj të vitit 2022”.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.1 , faqe 16-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2. Rekomandimi:

2.1. Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe ministrive të linjës administrative të merren masat për hartimin dhe paraqitjen për informim në Këshillin e Ministrave, të pasqyrave financiare të konsoliduara, të gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë për institucionet e qeverisjes së përgjithshme të sektorit publik. Këto pasqyra të inkuadrohen në raportin vjetor të zbatimit të buxhetit të shtetit, që përgatit Ministria përgjegjëse për financat.

2.2. Nga ana e MFE të drejtohet dhe monitorohet procesi i konsolidimit dhe rakordimit të informacionit kontabël, zbardhjes së gjendjeve/ tepcave të llogarive si dhe realizimit të procesit të eliminimit të dublikimeve, përmbledhjes dhe konsolidimit në pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore, për institucionet e sektorit publik.

2.3. Për të gjitha rastet e mosrespektimit të këtyre rregullave dhe teknikave të miratuara nga ana e institucioneve përgjegjëse, të zbatohen nga Nëpunësi i Parë Autorizues sanksionet e parashikuara ligjore, ndaj nëpunësve autorizues dhe zbatues të institucioneve shtetërore përkatës, në përputhje me legjisllacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor.

Afati: Në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi:

Për shkeljet ligjore, në lidhje me mos respektimin e afatit të depozitimit të Pasqyrave Financiare Individuale e Përmbledhëse/ të Konsoliduara nga ana e njëjësive shpenzuese/ institucioneve shtetërore buxhetore apo ekstrabuxhetore etj., nga ana e Nëpunësit të Parë Autorizues nuk janë zbatuar përgjegjësitë ligjore mbi marrjen e masave administrative.

Në një numër subjektsh shtetërore, buxhetore dhe ekstrabuxhetore, (në shtatë raste të analizuara), rezultojnë problematika dhe shkelje në mënyrë të përsëritur për dy vitet radhazi 2021 dhe 2022 lidhur me zbatimin e afatit të dorëzimit të pasqyrave financiare vjetore, të tilla si, *Bashkia Pustec, Shërbimi Kombëtar i Rinisë, Ministria e Kulturës, Ujësjellës Kanalizime sha Durrës, Ujësjellës Kanalizime sha Shkodër, Federata Shqiptare e Aero-nautikës, Federata Shqiptare e Motoçiklizimit, etj,*

Sa sipër, është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e :

- Nenit 71, germa ”e“, Kreu IX, të ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, “kur nëpunësi autorizues dhe/ose nëpunësi zbatues i njëjësive të qeverisjes së përgjithshme nuk përmbushin detyrimet për mbylljen e vitit buxhetor dhe nxjerrjen e llogarive vjetore të buxhetit, në kundërshtim me nenin 62 të këtij ligji, dënohen nga nëpunësi i parë autorizues me masë administrative ose me gjobë në masën 1-3 paga mujore”.
- Paragrafit nr. 45, Kreu V, të Udhëzimit nr.25, datë 09.12.2021 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2021”, “Për mosrespektim të kërkesave të këtij



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

Udhëzimi nga ana e nëpunësit autorizues dhe zbatues të njërive të qeverisjes së përgjithshme, Nëpunësi i Parë Autorizues zbaton penalitetet e përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;

- Paragrafit nr. 45, Kreu VI “Masat administrative”, të Udhëzimit nr.34, datë 14.12.2022 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2022”, që përcakton se “Për mosrespektim të kërkesave të këtij udhëzimi nga ana e nëpunësve autorizues dhe zbatues të njërive të qeverisjes së përgjithshme, Nëpunësi i Parë Autorizues zbaton penalitetet e përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.1 , faqe 16-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3. 1. Rekomandimi:

Të merren masat nga ana e Nëpunësit të Parë Autorizues për vënien përpara përgjegjësisë dhe zbatimit të sanksioneve e masave administrative për nëpunësit autorizues e zbatues të njërive të qeverisjes së përgjithshme, që janë përgjigjës për funksionimin e sistemit të kontabilitetit, në përputhje me ligjin e buxhetit, aktet e tjera në zbatim të tij dhe me udhëzimet e Ministrisë të Financave mbi procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare.

Afati: Në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi:

Për periudhën objekt auditimi 2021 dhe 2022, nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të MFE, si dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit (në po këtë ministri), nuk evidentohet asnjë rast i regjistruar, ku si pasojë e konstatimit të mosrakovimeve të pasqyrave të konsoliduara vjetore të pozicionit financiar (Bilanci) në nivel gupi dhe pasqyrave financiare të gjeneruara nga SIFQ , t'i jenë kthyer institucionit buxhetor (ose organit qendror të tij) me pasaktësi e parregullsi, për azhurnim në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë, referuar kërkesave të paragrafit nr. 23, të Udhëzimit të MFE nr.5, datë 21.2.2022, që përcakton se:

“Pasqyra e konsoliduar vjetore e pozicionit financiar (Bilanci) kontrollohet me pasqyrën përmbledhëse të pozicionit financiar të gjeneruar nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë dhe në rast mosrakovimi i kthehet njësisë publike qendrore (organit qendror të saj) për azhurnim në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë sipas informacionit kontabël të të drejtave të konstatuara që disponon njësi qendrore”.

dhe Paragrafit nr. 24, që përcakton se:

“Njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë pasqyrat financiare të konsoliduara në mvel njësi publike, respektivisht pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e flukseve monetare dhe shënimet shpjeguese, brenda muajit Prill të vitit pasardhës dhe e depozitojnë atë në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Pasqyra e konsoliduar vjetore e pozicionit financiar (Bilanci) kontrollohet me pasqyrën përmbledhëse të pozicionit financiar të gjeneruar nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë dhe në rast mosrakovimi i kthehet njësisë publike vendore (organit qendror të saj) për azhurnim në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë sipas informacionit kontabël të të drejtave të konstatuara që disponon njësi vendore”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.1 , faqe 16-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4. Rekomandimi:

4.1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, për diferencat e konstatuara dhe të paargumentuara, të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të manualit të klasifikimit ekonomik kontabël, me qëllim për një pasqyrim dhe paraqitje të drejtë të gjendjes së llogarive vjetore të institucionit si dhe të parandalohen gabimet materiale dhe parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare vjetore.

4.2. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit për rastet e mosrakordimeve të pasqyrave të konsoliduara vjetore të pozicionit financiar (Balanci) në nivel gupi dhe pasqyrave financiare të gjeneruara nga SIFQ , që janë me pasaktësi e parregullsi, tua kthejnë ato institucioneve buxhetore (ose organit qendror të tij) për azhornim, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për thesarin në degë.

Afati: Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi:

Nga kryerja e testimeve substanciale, për verifikimin e mbartjes së tepricave në lloagri në fund të periudhës tek ato në fillim periudhës së vitit pasardhës, (tepricat e çeljes) në pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata materiale, u konstatua se, ***ekzistojnë mospërputhje midis shumave të bilancit të mbylljes të vitit paraardhës dhe atij të çeljes në vitin pasardhës, për Pasqyrat Financiare Përmbledhëse për 5 Institucione të Qeverisjes Qendrore (ministri)***. Kjo situatë e mospërputhjes së të dhënave krijon probleme e pasaktësi të informacionit kontabël, si dhe shton vështirësitë e konsolidimit në nivel grupi dhe më tej në nivel të qeverisjes së përgjithshme, pasi efekti i përgjithshëm i mosrakordimeve vetëm për institucionet e analizuara është në shumën prej **47,891,252,473 lekë**. *Më hollësisht,*

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

Në bilancin e konsoliduar të vitit 2021, në formatin nr.1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, totali i aktiveve nuk është i barabartë me totalin e pasivit të bilancit të konsoliduar për vitin 2020 dhe 2021.

Gjithashtu, shuma totale e aktivitet të bilancit të konsoliduar (pasqyra nr .1), për datën 31.12.2021 është 503,821,359,488 lekë, kurse shuma totale e aktivitet të bilancit të dt. 31.12.2022, për ushtrimin paraardhës është 455,965,038,944 lekë, duke rezultuar me diferencë dhe mos barazim për vlerën **-47,856,320,544 lekë**.

2. Ministria e Brendshme:

Nga auditimi i PFK të Ministrisë së Brendshme, konstatohet se, egzistojnë mospërputhje të të dhënave të kolonës “ushtrimi i mbyllur” i bilancit të konsoliduar të datës 31.12.2021, (*dërguar MFE me shkresën nr. 2396/2, dt 29.4.2022 të MB*), pasqyruar totali i aktivitet dhe pasivit për 30,812,751,940 lekë, me të dhënat e kolonës “ushtrimi paraardhës”, në bilancin e datës 31.12.2022, (*dërguar në MFE me shkresën e MB nr. 3030/1, datë 28.4.2023 , protokoll i MFE nr. 9407, dt 23.5.2023*), ku totali i aktivitet dhe pasivit pasqyruar për v.2021 është: 30,817,636,787 lekë. Sa më sipër, rezulton diferencë në vlerën prej **+ 4,884,847 lekë**, për të cilën nuk kuadrojnë të dhënat dhe pasqyruar me tepër celje ushtrimi i meparshëm, në fillim të vitit 2022.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

3. Ministria e Arsimit dhe Sporteve:

Nga auditimi i PF përmbledhëse të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, konstatohet se, egzistojnë mospërputhje e të dhënave të kolonës “ushtrimi i mbyllur” i bilancit të konsoliduar të datës 31.12.2021, (dërguar MFE me shkresën nr. 2810/1, dt 29.4.2022), ku është pasqyruar totali i aktivitetit dhe pasivitetit për 30,564,666,353 lekë), me të dhënat e kolonës “ushtrimi paraardhës”, në bilancin e datës 31.12.2022, (dërguar në MFE me shkresën e MAS nr. 2802, datë 28.4.2023 (ska nr. Protokollin e MFE), pasqyruar totali i aktivitetit dhe pasivitetit për vitin e meparshëm 2021 për: 30,562,057,766 lekë, me një diferencë mosakordimi në vlerën prej - 2,608,587 lekë, sa nuk kuadrojnë të dhënat dhe pasqyruar me tepër celje ushtrimi i meparshëm, në fillim të vitit 2022.

4. Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë:

Konstatohet se, nuk përputhen të dhënat e kolonës “ushtrimi i mbyllur” (i bilancit të datës 31.12.2021, i pasqyruar për 391,217,673,910 lekë) me të dhënat e kolonës “ushtrimi paraardhës”, (në bilancin e datës 31.12.2022, i pasqyruar për 391,212,997,609), duke patur një diferencë mosakordimi në vlerën prej - 4,676,301 lekë, sa pasqyruar me pak celje ushtrimi i meparshëm, në fillim të vitit 2022.

5. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:

Nga kryerja e testeve substanciale, për verifikimin e mbartjes së tepricave në fund të periudhës tek ato në fillim të periudhës (tepricat e çeljes) në pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata, u konstatua se, ekzistojnë mospërputhje midis shumave të bilancit të mbylljes dhe atij të çeljes në vitin pasardhës, pasi: të dhënat mbi gjendjen e ushtrimit paraardhës në PFK të vitit 2022 (në formatin 1, “Totali i aktiveve”, rreshti nr.1 janë në shumën prej 45,664,255,457 lekë, kurse në pasqyrën financiare të konsoliduar të vitit 2021, totali i aktiveve gjithsej në ushtrimin e mbyllur është regjistruar për tepricën neto 45,687,017,651 lekë në pasqyrën nr. 1 “Pozicioni financiar”, grupi “Aktivi i Bilancit Kontabël”, duke rezultuar një mbartje më pak të vlerave të llogarive në bilancin e çeljes prej -22,762,194 lekë, etj.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.1 , faqe 16-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5. Rekomandimi:

5.1. MFE dhe strukturat e Degëve të Thesarit sipas juridiksionit të tyre, të mos pranojnë dhe kthejnë mbrapsh pranë institucioneve shpenzuese, ato pasqyra financiare të llogaridhënies vjetore që kanë parregullsi, ku ekzistojnë mospërputhje midis shumave të bilancit të mbylljes të vitit parardhës dhe atij të çeljes në vitin pasardhës, pasi krijojnë probleme e pasaktësi të informacionit kontabël, dhe shtojnë në këtë mënyrë vështirësitë e konsolidimit në nivel grupi dhe më tej në nivel të qeverisjes së përgjithshme.

5.2. MFE t’u kërkojë zyrtarisht Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues të këtyre institucioneve që të marrin masa për identifikimin e burimit të këtyre pasaktësive, me qëllim që të bëjnë korrigjimet dhe sistemin e domosdoshme, duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vlera e drejtë dhe kuadruar/rakorduar sipas kërkesave të teknikave kontabël.

Afati: Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2023

6. Gjetje nga auditimi:

Nga analizimi i të dhënave të pasqyrave të pozicionit financiar, gjeneruar nga sistemi për 15 njesi shpenzuese me akses të drejtëpërdrejtë në SIFQ për vitin 2022, rezulton se nga 6 subjekte të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

testuara, në 5 prej tyre, *tepricat e llogarive më 31.12.2022 janë regjistruar me të njëjtën vlerë sipas tepricës së regjistruar në datën 31.12.2021, duke evidentuar riskun e parregullsive në hedhjen/ mbartjen e të dhënave kontabile* nga ana e kontabilistëve dhe hartuesve të pasqyrave financiare në Institucionet qendrore me akses të drejtëpërdrejtë në SIFQ, ku mund të përmendim:

- **Kryeministria (aparati):** me vlerë të njëjtë për dy vitet objekt auditimi 2021 dhe 2022, janë llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, për 10,091,723 lekë; llog.31 “Materiale”, për 18,058,969 lekë; llog 467 “Kreditorë të ndryshëm”, për 1,304,380 lekë;
- **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural:** me vlerë të njëjtë për dy vitet objekt auditimi 2021 dhe 2022, janë llogaria Aktivet Financiare (nr. llog.25 dhe 26), për 2,217,739,000 lekë; lloga 210 e cila është zero për dy vitet; llog 212 për 113,131,922 lekë; llog. 215 “Mjete transporti” për 19.674.990 lekë; llog.202 “Studime e kërkime”, për 3,504,000 lekë; llog.218 “Inventar ekonomik” për 44.486.418,85 lekë; etj/llog 202
- **Bashkia e Tiranës:** me vlerë të njëjtë për dy vitet objekt auditimi 2021 dhe 2022, janë llogaria 419 “Kliente (kreditorë) për 58,702,072 lekë; Llog. 477 “Diferenca konvertimi aktive”, për 1.563.808 lekë, Llog. 464 “Detyrime për t'u paguar për blerjen e letrave vlerë” për 50.400 lekë; llog. 32 “Objekte inventari”, për 8.968.985 lekë;
- **Autoriteti Rrugor Shqiptar:** me vlerë të njëjtë për dy vitet objekt auditimi 2021 dhe 2022, janë llogaria 423 e 429 “Personeli, paradhenie, deficite e gjoba”, për 2.360.000 lekë, etj.
- **Ministria e Financave dhe Ekonomisë:** me vlerë të njëjtë për dy vitet objekt auditimi 2021 dhe 2022, janë llogaria 411-418 “Klientë e llogari të ngjashme, për 535.303.000 lekë; Llog.21,24,28 “Aktive të Qendrushme të trupëzuara” për 2.452.317.835 lekë; Llog. 419 “Klientë (Kreditorë), parapagesa pjesore” për 535.272.185 lekë; Llog. 4341”Të tjera operacione me shtetin (kreditor)” për 7.268.412 lekë, etj.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.1 , faqe 16-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, të vlerësojë dhe monitorojë në vijimësi saktësinë e informacioneve të mbartura ndër vite me qëllim shmangien e riskut të pasaktësive e gabimeve në hedhjen/ mbartjen e të dhënave kontabile të pasqyrave financiare në institucionet qendrore me akses të drejtëpërdrejtë në SIFQ, si dhe për një pasqyrim e paraqitje të drejtë të gjendjes së llogarive vjetore të institucionit.

Afati: Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi:

Nga kryqëzimet e informacionit dhe auditimi i treguesve të pasqyrave financiare të gjeneruar nga Sistemi Informativ Financiar i Qeverisë (SIFQ) rezulton se, *për vitin 2020 dhe 2021 2022, pasqyrat individuale të llogaridhënies vjetore në 10 institucione qendrore (Ministri dhe aparati i Kryeministrisë) nga 12 gjithsej të përfshira në analizë, vlerën e llogarisë 210, “Toka, troje dhe terrene”, e kanë të pasqyruar me vlerën zero lekë, në kundërshtim me parimet e përgjithshme të kontabilitetit mbi saktësinë dhe vërtetësinë e llogarive, në kundërshtim me përcaktimet e paragrafit 60 dhe 62, pika 3.3,”Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci) kreu III, të Udhëzimit Nr. 8, datë 9.3.2018 i ndryshuar, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, që përcakton shprehimisht se,*

“60.Pasqyra individuale e pozicionit financiar (bilanci kontabël) pasqyrojnë në mënyrë të klasifikuar e strukturuar aktivet, detyrimet dhe fondet neto të njësisë së qeverisjes së



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

përgjithshme në datën e përcaktuar për mbylljen e vitit ushtrimor raportues. Si rregull, periodha ushtrimore është nga data 1 Janar deri më 31 Dhjetor të vitit raportues.

62. Aktivitet paraqiten në rubrikën A të pasqyrës së pozicionit financiar. Totali i aktiveve përbëhet nga shuma e totalit të aktiveve afatshkurtra dhe totalit të aktiveve afatgjata.

Rubrika e II-të e aktiveve, që përfshin aktivet afatgjata, përbëhet nga shuma e nënrubrikave që përfaqësojnë:

-Nënrubrika e aktiveve afatgjata jomateriale, që përfshin studime dhe kërkime, koncesione, patenta, licenca e të tjera të ngjashme;

-Nënrubrika e aktiveve afatgjata materiale, që përfshin toka, pyje, ndërtesa, rezerva shtetërore, etj;

-Nënrubrika e aktiveve afatgjata financiare, që përfshin huadhënie dhe pjesëmarrje në kapitalin e vet; dhe

-Nënrubrika e investimeve, që përfshin aktivet në proces për aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale.”

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.1 , faqe 16-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandimi:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të kërkojë nga Degët e Thesarit sipas juridiksionit të tyre dhe nga Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues të njësive shpenzuese, buxhetore e ekstrabuxhetore, të marrin masa për vlerësimin, regjistrimin dhe evidentimin e saktë të gjendjes së llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” në kontabilitet, duke bërë që në këtë llogari të paraqitet, vlera e tokës truell nën objektet e ndërtesave të pasqyruara në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”, si dhe vlera e trojeve dhe tereneve, të cilat me Vendime të Këshillit të Ministrave u janë kaluar në pronësi të institucioneve shtetërore etj.

Afati: Në vijimësi

8.Gjetje nga auditimi:

Nga analiza e pasqyrave financiare të gjeneruar nga Sistemi Informativ Financiar i Qeverisë (SIFQ) rezulton se *për vitin 2020 dhe 2021, pasqyrat individuale të llogaridhënies vjetore në 10 institucione qendrore (Ministri dhe aparati i Kryeministrit) nga 12 gjithsej të përfshira në analizë, nuk kanë zbatuar përcaktimet e paragrafit 15, pika 3.1, kreu III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, të Udhëzimit Nr. 5, datë 21.2.2022 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, për kryerjen e veprimeve kontabile sistemuere në lidhje me llogarinë nr. 4864, “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, ku përcaktohet shprehimisht se:”Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, përpara mbylljes së llogarive vjetore 2021, kryejnë veprimin e mbylljes së llogarisë 4864 "Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura" në debi të llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm" për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në këto llogari në datën 31 Dhjetor 2021.*

Të gjitha detyrimet e prapambetura të regjistruara në Llogarinë 4864 deri në fund të periudhës ushtrimore 2021 konsiderohen detyrime të prapambetura të trashëguara nga vitet e kaluara” .

Më konkretisht, Institucionet që nuk kanë kryer veprimet kontabile të mbylljes së llogarisë 486 dhe rezultojnë me gjendje në PF individuale vjetore janë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

Të dhënat në lekë

Nr	Emërtimi i institucionit Qendror	31.12.2021	31.12.2020
1.	Aparati i Kryeministrisë	0	0
2.	MASH Tiranë	4,213,846	14,374,559
3.	M.Brendshme Tiranë	7,353,150	6,626,184
4.	MBZHR Tiranë	28,414,200	25,000,000
5.	MD Tiranë	101,540,505	101,540,505
6.	MFE Tiranë	3,600,000	8,794,114
7.	MIE Tiranë	1,305,132,866	993,241,300
8.	M.Kulturës Tiranë	31,674,611	31,674,611
9.	M.Mbrojtjes Tiranë	1,204,644	0
10.	MPJ Tiranë	0	0
11.	MSHMS Tiranë	33,494,422	60,363,463
12.	MTM Tiranë	1,406,020	80,623,172

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.1 , faqe 16-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Degët e Thesarit sipas juridiksionit të tyre, të marrin masa për të monitoruar zbatimin e normave teknike dhe procesin e sistemeve në kontabilitet të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në kundër partinë e saj, llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” për pasqyrat financiare të ushtrimit që mbyllet më 31.12.2023, meqënëse llogaria 486 si llogri e pozicionit financiar luan rolin e një llogarie teknike për identifikimin e detyrimeve të prapambetura.

Afati: Në vijimësi

9.Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zërave të pasqyrave financiare të depozitura në MFE, së paku në tre institucione shpenzuese buxhetore, (Bashkia Fier, Qendra Kombëtare e Kinematografisë, Agjensia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve), zëri “Aktiveve Neeto/ Fondet Neto” nuk përputhet me zërin “Fondi i Konsoliduar” në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në kundërshtim me përcaktimet e UMFE nr.8, datë 9.3.2018, ndryshuar me UMFE nr 5, datë 21.2.2022.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.1 , faqe 16-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1. Rekomandimi:

Të merren masat për sigurimin e zbatimit me korrrektesë të normave teknike të pasqyrimit në kontabilitet të zërit “Aktiveve Neto/ Fondet Neto” nga ana e Nëpunësve Zbatues, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Në këtë kuadër, NA dhe NZ sipas rastit, të marrin masa për kryerjen e kontroleve kryqëzuese për identifikimin e shkaqeve të mosrakordimeve, identifikimit të gabimeve dhe kryerjes së sistemeve të nevojshme për llogarinë “Aktivet Neeto/ Fondet Neto”. MFE dhe strukturat e Degëve të Thesarit sipas juridiksionit të tyre, të mos pranojnë dhe kthejnë mbrapsh pranë institucioneve shpenzuese, ato pasqyra financiare të llogaridhënies vjetore që kanë këtë parregullsi, të mospërputhjes midis zërave të “Aktiveve Neto/ Fondeve Neto” me shumatat e pasqyruara në grupin “Fondi i konsoliduar” të bilancit kontabël.

Afati: Në vijimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI,
NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

10.Gjetje nga auditimi:

Grupi i auditimit konstatoi se për periudhën 2021-2022 nuk janë realizuar proceset e inventarizimit të pasurisë për institucionin e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë. Gjithashtu rezultoi që, komisioni i ngritur sipas shkresës me nr.6583 prot, datë 12.04.2021 për vlerësimin e aktiveve të identifikuar për nxjerrje nga përdorimi, bazuar në relacionet dhe përfundimet e komisioneve të ngarkuara me inventarizimin e pasurisë gjatë vitit 2017 dhe 2019, nuk ka realizuar procesin e plotë vlerësues, pasi ka vlerësuar vetëm aktivet e propozuara për nxjerrje nga përdorimi për vitin 2017 dhe jo ato të propozuara për vitin 2019, në kundërshtim me kërkesat e UMFE nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.1 , faqe 16-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10. Rekomandimi:

10.1. Drejtuesit e Ministrisë të marrin masat për kryerjen e inventarizimit të plotë fizik të pasurisë së institucionit në fund të çdo viti ushtrimor, duke caktuar në përbërje të komisioneve të inventarizimit të Aktiveve Afatgjata Materiale (AAGJM), specialistë të fushës, me qëllim kryerjen e inventarizimit me cilësi, pasqyrim të drejtë të procesit të inventarizimit, dhe të kërkojë të rakordohen rezultatet e inventarizimit me llogaritë kontabël përkatëse, me qëllim që në përfundim të punës, komisionet përkatëse të hartojnë relacionet mbi rezultatet e inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve.

10.2. Institucioni të ndjekë hapat e mëtejshëm bazuar në konkluzionet e grupit të inventarizimit (nr.1996/2, datë 19.06.2019) për procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese MFE, duke bërë të mundur kështu përfundimin e procesit të inventarizimit si dhe pasqyrimin e këtyre efekteve në kontabilitet, referuar masave që do të ndërmerren për aktivet e vlerësuara për t'u nxjerrë jashtë përdorimit.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi.

11.Gjetje nga auditimi:

11.1. *Mungesa e një strukture në nivelin e Drejtorisë së Përgjithshme të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar dhe pamjaftueshmëri e kapaciteteve në DPTH* për shqyrtimin, analizimin, përpunimin dhe konsolidimin e informacionit kontabël të pasqyrave financiare të sektorit publik nga 1,046 njësitë shpenzuese të sektorit publik.

11.2. *Mungesë dhe mosplotësim kapacitetesh në Drejtorinë e Operacioneve të Thesarit (pjesë e DPTH), me specialistët e raportimit financiar dhe kontabilitetit.*

Referuar të dhënave të vëna në dispozicion të grupit të auditimit nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, rezultoi se Sektori i Raportimit Financiar dhe Kontabilitetit (në DOTH/DPTH), për periudhën e auditimit ka në strukturën e miratuar 1 Përgjegjës sektori dhe 4 Specialistë, që sipas përshkrimit të funksioneve dhe detyrave të tyre, përcaktohen në:

1. *Specialist* për monitorimin dhe kontrollin periodik të transaksioneve të të hyrave të qeverisjes së përgjithshme në sistemin informatik financiar të qeverisë (SIFQ).
2. *Specialist* për monitorimin dhe kontrollin periodik të transaksioneve të të dalave të qeverisjes së përgjithshme në sistemin informatik financiar të qeverisë (SIFQ).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

3. *Specialist* i raportimit financiar dhe kontabilitetit i cili përgjigjet për menaxhimin e informacionit për raportimin komprehensiv të pozicionit financiar të qeverisjes së përgjithshme me anë të sistemit informatik financiar të qeverisë.
4. *Specialist* i raportimit financiar dhe kontabilitetit i cili përgjigjet për menaxhimin e informacionit për raportimin komprehensiv të pozicionit financiar të qeverisjes së përgjithshme me anë të sistemit informatik financiar të qeverisë.

Evidentohet se, pozicioni i Specialistit të Raportimit Financiar dhe Kontabilitetit është vakant që prej muajit Maj të vitit 2022 dhe si rrjedhojë, prej më shumë se 1 (një) vit ky sektor ka operuar me kapacitet të reduktuar, duke patur në përbërje përgjegjës të sektorit dhe tre specialistë.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.1 , faqe 16-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandimi:

Të merren masat për një vëmendje të shtuar të drejtuesve të MFE nga njëra anë, por edhe të titullarëve të subjekteve publike nga ana tjetër, për përmirësimin e proceseve në fushat e identifikuar të kontabilitetit dhe raportimit, duke propozuar ngritjen e një drejtorie/drejtorie të përgjithshme me objekt veprimtarie kontabilitetin dhe raportimin e sektorit publik.

Gjithashtu, të instalohen mekanizma, të cilët sigurojnë zbatimin e parimeve, rregullave dhe standardeve të kontabilitetit të sektorit publik, por edhe rishikimit, plotësimit të pozicioneve në organikë dhe forcimit të strukturave ekzistuese që kanë si përgjegjësi kontabilitetin dhe raportimin financiar, zbatimin dhe forcimin e sanksioneve dhe masave ndëshkuese, pasi një numër i gjetjeve mbi parregullsitë e fushës së kontabilitetit dhe raportimit financiar, vijnë të përsëriten nga viti në vit, siç prezantohen në raportet e auditimit të KLSH në subjektet e audituara.

Afati: Në vijimësi

12.Gjetje nga auditimi:

Struktura përgjegjëse për Thesarin në qendër ka gjeneruar periodikisht raportet e të dhënave të detajuara të stokut të detyrimeve të prapambetura nga SIFQ, të analizuar sipas njësive shpenzuese të qeverisjes qendrore dhe vendore, si dhe sipas natyrës ekonomike të detyrimit të prapambetur.

Deri në fund të muajit Dhjetor 2021 nisur nga raporti mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2021 dhe raportimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit rezulton se u regjistrua një stok kumulativ prej 13,3 miliardë lekë i detyrimeve të prapambetura nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, nga të cilat:

1. *Totali detyrimeve të qeverisë qendrore rreth 6,149.8 milionë lekë;*
2. *Totali detyrimeve të qeverisë vendore rreth 6,604.174 milionë lekë;*
3. *Totali detyrimeve për Universitetet dhe Ujësjetllësat e Kanalizimet rreth 0.48 milionë lekë.*

Në bazë të të dhënave kontabël të gjeneruara nga sistemi informatik financiar i qeverisë për vitin 2021 vlera e mbetur e “arrears” është 13.334 milionë lekë, e cila në periudhën 12-2022 është 12.751 milionë lekë (saktësia e këtyre të dhënave varet nga paraqitja e plotë në degën e Thesarit apo regjistrimi i plotë në SIFQ nga njësitë shpenzuese “online” i “arrears”).

1. *Totali detyrimeve të qeverisë qendrore rreth 6,231.4 miliardë lekë*
2. *Totali detyrimeve të pa përfshira në qeverisjen qendrore dhe vendore (Ujësjetllës kanalizime dhe universitetet) 554.6 milion lekë.*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

3. Totali detyrimeve të qeverisë vendore rreth 5,965.9 miliardë lekë.

Lidhur me raportimin nga Dr. e Thesarit të të dhënave të stokut të detyrimeve të prapambetura, ky informacion gjenerohet nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë pas rakordimit të degëve të Thesarit me njesitë shpenzuese që operojnë në rrethet e tyre dhe konfirmimit të degëve të thesarit për përfundimin e procesit të regjistrimit dhe rakordimit të detyrimeve të prapambetura.

Raporti i gjeneruar nga SIFQ sipas niveleve të qeverisjes së përgjithshme dhe sipas natyrës ekonomike të detyrimit të prapambetur agregohet në skedar format excel dhe i dërgohet çdo fund muaji për muajin parardhës Drejtorisë së Buxhetit.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.1 , faqe 16-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandimi:

Të analizohet stoku dhe dinamika e detyrimeve të prapambetura për institucionet e qeverisjes së përgjithshme, në përputhje me strategjinë e miratuar nga qeveria shqiptare dhe udhëzimin e MFE nr. 37/2020 “Për monitorimin dhe publikimin e stokut të detyrimeve të prapambetura në qeverisjen e përgjithshme”.

Afati: Në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenin 59, pika i dhe 4, shkronja “a” dhe “b”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë **Ministrin të Financave dhe Ekonomisë**, që në vlerësim të shkeljeve të konstatuara nga ana e grupit të auditimit, sipas pikës 1, të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013, të vlerësojë masën e shkeljeve dhe të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore për personat përgjegjës sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkeljet e konstatuara, sipas nenit 58, shkronja “a”, “b”, “c” dhe “ç” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, nga “vërejtje”, “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”; “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”; deri në, “Largim nga shërbimi civil”.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT

1. Q. C, (përgjegjës grupi),
2. A. Z, anëtar,
3. G. G, anëtar,
4. A. M, anëtar.

DREJTORI I DEPARTAMENTIT
Q.C



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

ANEKSE

LLOJET E OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH MBI AUDITIMIN FINANCIAR¹². Auditime financiare¹³, përfshijnë:

1. dhënien e një sigurie të arsyeshme, nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi dhe gabimet dhe i mundësojnë audituesit:
 - a. dhënien e një opinionit, nëse pasqyrat janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar;
 - b. dhënien e një opinionit, se mbi pasqyrat financiare, raportohet dhe komunikohet sipas kërkesave të SNA-ve dhe bazuar në gjetjet e auditimit.
2. Dhënia e opinionit shprehet nëpërmjet njërit prej opinionëve të mëposhtme të auditimit¹⁴:
 - a. **Opinion i Pamodifikuar**¹⁵, Audituesi duhet të shprehë një opinion të pamodifikuar për besueshmërinë e llogarive kur arrin në përfundimin se llogaritë vjetore janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Në mënyrë që të formojë këtë opinion, audituesi duhet të konkludojë se ka marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Ky opinion mund të jetë pa rezervë ose me theksim çështjeje.
Një opinion “Pa rezervë”, jepet në rastet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se:
 - pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi;
 - pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse;
 - janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.*Një opinion me “Theksim Çështjeje”, jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt, për një ose më shumë çështje specifike, që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare por që nuk janë thelbësore për arsyetimin e pasqyrave.*
 - b. **Opinion i Modifikuar**¹⁶, jepet në ato raste kur Pasqyrat Financiare përmbajnë gabime materiale, të cilat çojnë në ndryshim të rezultatit financiar, ose kur nga auditimi nuk sigurohet evidencë e mjaftueshme dhe e duhur financiare për të mbështetur dhënien e opinionin, por që në gjykimin profesional të audituesit mund të ketë gabime materiale të cilat sjellin ndryshim të rezultatit financiar. Ky opinion mund të jetë i kualifikuar/me rezervë, i kundërt ose me refuzim opinionit.
Një “Opinion i kualifikuar/me rezervë”, jepet në rastet kur:
 - audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalië apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë;
 - audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

¹² -Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH, Tiran 2022.

¹³ INTOSAI, 2019

¹⁴ IFAC, “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur”

¹⁵ ISA 700-ISSAI 1700

¹⁶ ISA 705-ISSAI 1705



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR MBI BAZË SISTEMI, NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Mbi sistemin e përgjithshëm të raportimit financiar dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme

Një “Opinion të kundërt”, jepet në rastet kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mosrespektimit të cilat janë materiale individualisht ose së bashku janë përhapur në llogaritë vjetore apo transaksionet.

Një “Refuzim opinion”, jepet në rastet kur:

- kur audituesi nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi, mbi të cilat duhet të bazojë mendimin për efektet e mundshme materiale edhe të përhapura mbi llogaritë vjetore apo transaksionet.
- në raste jashtëzakonisht të rralla që përfshijnë pasiguri të shumta, ku audituesi pavarësisht se ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përshtatshme të auditimit në lidhje me secilën prej pasigurive, mund të konkludojë se nuk është e mundur për të formuar një opinion dhe në këtë mënyrë refuzon dhënien e tij.